

DITURIA ISLAME



KONFERENCË
SHKENCORE



Dr. Rexhep Boja
Prijës, vizionar
dhe burrështetas i shquar

Prishtinë, 18-19 tetor 2024

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE E KULTURORE • Nr. 408 • NËNTOR 2024

| SHENJTËRIA E FESË DHE MBROJTJA
E SAJ NË TË DREJTËN ISLAME

| RINGJALLJA E ZËRIT
PËRBASHKUES SHQIPTAR

| FAMILJA, KJO ÇERDHE
E SFIDUAR NGA MODERNITETI!

NGA KONFERENCA PËR ISH-MYFTIUN, REXHEP EF. BOJA

"Dr. Rexhep Boja në vazhdimësi punonte për fe dhe atdhe me një heshtje të një intelektualit të mirëfilltë e të një njeriu të urtë dhe të drejtë në përmasa të gjera." *Myftiu, Naim ef. Tërnava*



"Në dekadën që u përshkua nga luftërat për pavarësi në Ballkan, udhëheqja fetare e dr. Rexhep Bojes kishte një karakter të veçantë. Ai nuk ekspozohet shumë, kishte një karakter të butë, të singertë dhe të besueshëm." *Ekmeleddin Ihsanoglu*



"Rexhep Boja ishte njëri nga njerëzit më meritore që udhëhoqën Bashkësinë Islame të Kosovës, duke u rreshtuar edhe në frontin e përbashkët të rezistencës paqësore, por edhe të asaj të armatosur me qëllim të arritjes së lirisë." *Fatmir Sejdiu*



"Emri i doktor Rexhep Bojes, si myfti dhe si ambasador është në themelet e lirisë, themelet e pavarësisë dhe të shtetformimit të Kosovës."

Enver Hoxhaj



"Profesor Boja qëndroi jashtë politikës dhe mbi politikën, por nga pozicioni i tij i shërbeu kauzës kombëtare dhe proceseve politike më shumë se kushdo tjetër." *Agim Çeku*



EDITORIAL

- 4 Të denjë për mbijetesë

FETARE

- 5 "Dr. Rexhep ef. Boja – personalitet dhe shembull që duhet ndjekur"
Kumtesa e Myftiut Tërnavë
- 9 Shenjtëria e fesë dhe mbrojtja e saj në të drejtën islame
Dr. Selatin Mehani
- 13 Hytbeja e minberit (Kriteret për zgjedhjen e temës së hytbes së xhumasë)
Mr. Avdyl Rrahmani
- 16 Zanafilla e objektivave të Sheriatit dhe kontributi i dijetarëve në zhvillimin e tyre
Rrustem Rrustemi



AKTUALITET

- 20 Ringjallja e zërit përbashkues shqiptar në epokën e zhurmave përçarëse
Nuredin Nazarko
- 23 "Mikro-shteti" bektashi dhe paradokset shqiptare
Hajrudin S. Muja



EDUKIM & FAMILJË

- 28 Edukimi i gruas, kusht për avancimin e shoqërisë
Dr. Florentina Tërmkolli
- 31 Familja, kjo çerdhe e sfiduar nga moderniteti
Labinot Kunushevc



KULTURË

- 35 Lidhja dhe bashkëpunimi i ulemave shqiptarë të Kosovës me Trupin Diplomatik Shqiptar (1936-1939)
Qerim Lita



HISTORI & CIVILIZIM

- 39 Dhuna dhe terrori serb ndaj femrës shqiptare
Dr. Jusuf Osmani
- 43 Ëndrrat e Hafëz Ali Korçës për Shqipërinë
Ermal Bega
- 46 Vështrim mbi mendimin e Ukshin Hotit
MA. Blerim Halili



REPORTAZH

- 53 Konferenca shkencore: "Dr. Rexhep Boja – prijës, vizionar dhe burrështetas i shquar"

AKTIVITETE

- 56 Myftiu Tërnavë priti në takim ministrin e Haxhit dhe Umres të Arabisë Saudite, dr. Taufik bin Fauzan al Rabiah



DITURIA ISLAME

Revistë mujore fetare, shkencore e kulturore
Nr. 408 • viti 38 • Nëntor 2024
• Rebiul-Ahir / Xhumadel-Ula 1446
• Çmimi 1 €

Boton

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë

Redaksia

Kryeredaktor: Mr. Driton Arifi
Anëtarë:
Dr. Ejup Haziri, Merita Boroci,
Mr. Muharrem Tërnavë,
Mr. Vedat Shabani.
Sekretar & lektor: Bajram Zeqiri
Redaktor artistik & teknik:
Bashkim Mehani

Adresa

"Dituria Islame",
rr. "Bajram Kelmendi", nr. 182,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +384 38 224 024
E-mail: redaksia@dituriaislame.net
www.dituriaislame.net
Shtypi:
"IliriPrint", Prishtinë



“Nëse nuk shkoni në luftë, Ai (Zoti) do t’ju ndëshkojë me dënim të dhembshëm dhe do t’ju ndërrojë me një popull tjetër, Atij ju nuk do të mund t’i bëni dëm asgjë. Se Zoti është i Plotfuqishëm për çdo gjë.”

(Et Teube, 39)

Të denjë për mbijetesë

Nëse brezit të fillimshkullit të kaluar i takoi fati i finalizimit të mëvetësisë së një pjese të territorit shqiptar, atij të Shqipërisë, neve, brezit të këtij fillimshkulli na takoi nderi e fati i mëvetësisë edhe i një pjese tjetër të trungut tonë shekullor, atë të Kosovës. Brezat e tjerë që jetuan para këtyre dy ngjarjeve kulminante, përjetuan epokat e lavdishme të përpjekjes, vuajtjes e sakrificës për atdheun, por historia, thënë më drejtë, rrethanat gjeopolitike i privuan ata nga realizimi i ëndrrës së tyre shekullore.

Shqiptarët në rrugëtimin e tyre drejt mëvetësisë, triumfalisht e kaluan testin e ruajtjes së gjenit, etnisë dhe një pjesë qenësore të territorit të vet. Ofruan pa ndalë një provë fisnikërie, pjekurie, por edhe dinjiteti. Dëshmuam se mbetemi kombi më i denjë për të jetuar e mbijetuar në pellgun qytetërimor ballkanas, ngase sakrificën për këtë tokë e bëmë idealin më të lartë, e rezistencën dhe luftën për të drejtën tonë e shndërruam në strategji jetike kombëtare.

Lexuesit e historisë sonë, lehtësisht mund të kuptojnë se ne, për një kohë ishim një kafshatë e shijshme, mbase jo edhe aq e lehtë në sofrën e qelepërxhinjve. Në sofrën e atyre që ndërtonin mitet e narracionet e sajara shoviniste mbi kurrizin tonë. Megjithatë, ne fatmirësisht arritëm që ata të pangopurit t’i lejmë, përgjithmonë ashtu siç qenë, të pangopur. Kishim frikë reale se mosgatishmëria për sakrificë do ta kishte çmim të vetin ndërrimin tonë në këto troje me dikë të padenjë për të shkelur këtë dhe. Ne nuk bëmë asgjë më shumë, vetëm zmadhimet artificiale të armiqve në kurriz tonin, i përmbysem e i bëmë të mbesin projeksione të huqura.

Një ajet kuranor i zbritur tash e 14 shekuj sikur fliste edhe për ne, bijtë e këtij nënqielli dhe për rrethanat tona ekzistenciale. Aty, Zoti ynë tha: “Nëse nuk shkoni në luftë, Ai (Zoti) do t’ju ndëshkojë me dënim të dhembshëm dhe do t’ju ndërrojë me një popull tjetër, Atij ju nuk do të mund t’i bëni dëm asgjë. Se Zoti është i Plotfuqishëm për çdo gjë.” (Et Teube, 39). Pra, ne nuk e zgjodhëm luftën si mënyrë të mbijetesës kombëtare, por truallin tonë e shkelën thundrat e huaja, e të cilat nuk largoheshin dot nga këtej pa luftë. Lufta nuk ishte zgjedhja jonë, ishte e tyre. Veçse edhe një fakt duhet thënë pashmangshëm kur ne vramendemi për rolin e prijësve fetarë, veçanërisht ata myslimanë. Ata, nisur nga këto thirrje të lartcekura hyjnore, dhe ndërgjegjja e tyre e kulluar kombëtare, bashkuan forcën e tyre intelektuale dhe shkrinë sakrificën e tyre në altarin e lirisë e të atdheut bashkë me liridashësit e tjerë. Krahë më krahë me liderët politikë, ata shpallën mirëkuptimin e harmoninë fetare si një postulat të epërm rreth të cilit s’pranuan asnjë diskutim. Andaj kushdo që sot flet për të arrirat e kombit tonë, ndihet i obliguar që krahas Ismail bej Vlorës e Mithat Frashërit, të flasë edhe për hoxhë Vehbi Dibrën e Ibrahim Dalliun, e krahas Rexhep Mitrovicës e Hasan Prishtinës të rrëfejë doemos edhe për hoxhë Hasan Tahsinin e hoxhë Ferit Vokopolën.

Për të etabluar sakrificën e kontributin kombëtar dhe ta bërë rolin e një lideri fetar mysliman të paharrueshëm në historinë tonë kombëtare, hoxhë Vehbi Dibra, në Kuvendin e Vlorës, më 28 nëntor 1912, deklaroi: “Armikut të atdheut i pritët hovi e guximi në qoftë se na shef të bashkuar e të lidhur për një qëllim të naltë... Naltësimi e përparimi i një vendi varet në sigurimin e qetësisë së brendshme. Atje ku mungon qetësia, nuk mund të përparojë industria, tregtia e burimet e tjera ekonomike që e lumturojnë një popull.” Kjo vetëdije prej një intelektualit e prijësi fetar mbetet fanar i kombit dhe referencë uniteti në çdo kohë e rrethanë historike.

S’ka dilemë, që të mbajmë gjallë kauzën për atdheun që nga fillim shekulli i kaluar e gjer në këtë fillimshkull, duhej një kokëtim i çiltër mendjesh e zemrash nga ata idealistë të cilët nuk u ngopën kurrë me “kafshatën” e mëvetësisë së 28 nëntorit të 1912-tës. Megjithëse ne para një shekulli morëm “diçka” nga të drejtat tona sa për të thënë se s’mbetëm duarthatë, por mbeti ajo që lëngonte pa ndalë. Mbeti Kosova! Andaj me të drejtë vazhduan përpjekjet idealiste për një mëvetësi të dytë. E bëmë këtë ngase e kuptuam se “shqiptarët duhet të shpallim të patjetërsueshme të drejtat dhe aspiratat e tyre të pa përmbyshura kombëtare...” (A. Baleta).

Mr. Driton Arifi



Kumtesa e Myftiut, Naim ef. Tërnavë në konferencën kushtuar ish-myftiut, dr. Rexhep ef. Boja

Dr. Rexhep ef. Boja, personalitet dhe shembull që duhet ndjekur

I nderuar reis i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, hfz. Shaqir ef. Fetahu,

I nderuari nënkryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Enver Hoxhaj,

I nderuari ish-president i Kosovës, z. Fatmir Sejdiu,

I nderuari përfaqësues i presidentes znj. Vjosa Osmani, z. Bekim Kupina,

I nderuari ambasador i Turqisë z. Tunq Angili,

E nderuara përfaqësuese e Ambasadës së Amerikës, znj. Brooke Young,

I nderuari ish-sekretar i Organizatës së Konferencës Islamike, z. Ekmeludin Ihsanoglu, një prej miqve më të mëdhenj që ka Kosova dhe populli shqiptar, personalitet i cili në vazhdimësi e përkrahi Kosovën për çlirimin e saj, e më vonë edhe anëtarësimin e saj në mekanizma të ndryshëm ndërkombëtarë, por edhe në njohjen e Kosovës shtet sovran e të pavarur nga shtete të ndryshme të botës. Sot, me prezencën e tij në këtë Konferencë na ka nderuar ne si Bashkësi Islame, ka nderuar popullin dhe shtetin e Kosovës.

E nderuara familje Boja,

Të nderuar përfaqësues të institucioneve qendrore e lokale,

Të nderuar kryetar të komunave, z. Përparim Rama, z. Zenun Elezaj,

Të nderuar studiues,

Të nderuar përfaqësues të këshillave e institucioneve të Bashkësisë Islame të Kosovës,

Të nderuar bashkëpunëtorë të ish-myftiut Boja,

Vëllezër e motra,

Të nderuar të pranishëm!

S'ka pikë dyshimi se vdekja dhe jeta janë të krijuara nga Zoti i Madhërishëm. Zoti krijoi vdekjen dhe jetën për të na sprovuar se kush prej nesh është më vepërmirë gjatë jetës sonë në këtë botë. Ashtu siç janë të krijuara, ato edhe janë të përcaktuara nga Ai, dhe po të mos ishte njëra, nuk do të ekzistonte as tjetra. Nuk ka vdekje pa jetë dhe nuk ka amshueshmëri pa kalim në botën tjetër. Bazuar dhe besuar në këtë, ne, para tri vjetësh e përcollëm në përjetësi imamin, pedagogun, profesionin, kolegun, politikanin, humanistin, ambasadorin dhe udhëheqësin tonë të shquar, ish-myftiun e Kosovës, dr. Rexhep efendi Bojën, për të cilin edhe sot bashkërisht, lusim Zotin e Madhërishëm që ta shpërblejë me begatitë e Tij të pakufishme. Zoti në Kuran thotë: “Kudo që të gjendeni, do t’ju arrijë vdekja, madje qofshi edhe në kështjellat më të forta.” (En Nisa, 78).

Të nderuar të pranishëm,

Me doktor Bojën kam pasur fatin që një pjesë të gjatë të jetës ta kalojmë së bashku, duke qenë kështu së bashku në forumet dhe institucionet e Bashkësisë Islame të Kosovës, por jo vetëm. Tek ai kam njohur, ndier e përjetuar urtësinë, vizionin, përkushtimin, përgjegjësinë dhe vendosmërinë e tij, andaj edhe e kam të vështirë që të zgjedh se nga t’ia filloj të flas për kontributin e dr. Rexhep Bojës për Bashkësinë Islame të Kosovës dhe institucionet e saj, ashtu siç nuk di se nga t’ia nisi që të përmendi angazhimin e tij për çështjen





kombëtare në përgjithësi dhe çështjen e Kosovës në veçanti. Kjo sepse kontributi i dr. Bojës është i shumanshëm dhe shumëdimensional. Këtë e them me përgjegjësi të plotë, ngase isha njëri nga shokët më të afërt të dr. Rexhep Bojës, prandaj edhe kam bindjen se kjo Konferencë dhe këta shkencëtarë dhe hulumtues, do të hedhin në dritë një pjesë të punës dhe kontributit të dr. Rexhep Bojës.

Kontributi i dr. Rexhep Bojës, apo i Doktorit, siç e kemi quajtur ne kolegët e tij është i paçmuar për institucionet tona, për vendin dhe për shtetin tonë.

Çdo detyrë dhe përgjegjësi që iu besua, doktori e përmbushi me përgjegjësi dhe profesionalizëm, me qetësi dhe urtësi. Edhe si imam, edhe si profesor në Medrese dhe FSI, por edhe si dekan e myfti, ishte një model për brezin e ri se si duhej qasur xhematit dhe besimtarëve, apo edhe për atë se si duhet edukuar me përkushtim brezin e ri në rrugën e Zotit e të kombit.

Ne si Bashkësi Islame patëm fatin e mirë që në vitet e 90-ta të shekullit të shkuar kishim në udhëheqje dr. Rexhep ef. Bojën, i cili megjithëqë e mori këtë detyrë në kohë e ditë të vështira, nëpër të cilat po kalonte jo vetëm ky institucion, por edhe i gjithë populli dhe vendi ynë, ai, me vizionin dhe urtësinë që e karakterizonin gjithmonë, arriti që Bashkësinë Islame ta udhëhiqte drejt pavarësisë dhe mëvetësisë. Për më tepër ai u angazhua fort dhe pa pushim që Bashkësinë Islame të Kosovës, tashmë si etnitet i pavarur ta promovonte dhe ta bënte të njohur gjithandej, duke vënë lidhje bashkëpunimi në arenën ndërkombëtare, si në Lindje, ashtu edhe në Perëndim.

Përveçse udhëheqës shpirtëror dhe kryetar i Bashkësisë Islame të Kosovës, doktor Rexhep ef. Boja, shquhej edhe për kontributin e tij të dhënë në përparimin kombëtar të shqiptarëve në ish-Jugosllavi, me përpjekjet e tij për t'i mbrojtur të drejtat fetare e politike të shqiptarëve, si dhe për ta bërë të njohur para opinionit botëror çështjen e pazgjidhur shqiptare. Kudo që shkoi, doktor Boja, Bashkësinë Islame të Kosovës, e rrjedhimisht edhe Kosovën dhe popullin e saj e prezantoi në mënyrën më të mirë të mundshme, duke thyer stereotipat e ish-Jugosllavisë. Doktorit e njihte mirë

domosdoshmërinë e sensibilizimit të opinionit ndërkombëtar për Kosovën. Ai, kudo që u paraqit, e paraqitjet e tij ishin të shumta, dhe atë nëpër qendrat kryesore të botës, prezantoi gjendjen e vështirë në të cilën po kalonte populli ynë, duke e promovuar të drejtën e popullit tonë për të qenë i lirë dhe sovran.

Për ta kuptuar edhe më guximin intelektual që kishte dr. Rexhep Boja, po përmendi vetëm një rast në raport me çlirimin e vendit. Ishim së bashku në një vizitë zyrtare në Kuvajt, dhe ndër të tjera, para një mase afërsisht 400-500 veta, në një ambient të hapur e të qetë nate të vitit 1996, dr. Boja, mbajti ligjëratën me temën "Kasaphana e ardhshme në Kosovë pas asaj në Bosnje". Për t'u kthyer në Kosovë, u dashtë që në pikë të natës ta kalojmë kufirin me Maqedoninë nëpër male, që ishte një rrezik në vete, e kjo ka ndodhur disa herë.

Një segment tjetër i rëndësishëm i dr. Rexhep ef. Bojës, ishte edhe angazhimi i tij për kultivimin e tolerancës dhe mirëkuptimit në radhët e popullit shqiptar. Ai, në çdo paraqitje të tij gjithandej ku mori pjesë, me krenari dhe mburrje e theksonte si vlerë të veçantë të popullit tonë pikërisht virtytin e tolerancës dhe mirëkuptimit ndërfetar.

Dr. Rexhep Boja, pa humbur kohë iu përvesh punës për themelimin dhe hapjen e Fakultetit të Studimeve Islame, institucion ky që pas një angazhimi të gjithanshëm të BIK-ut, në krye me dr. Bojën, u bë realitet më 1992.

Dr. Boja, përveçqë u angazhua drejtpërdrejt në procesin mësimor, që edhe dekani i parë i këtij institucion, dhe kështu praktikisht falë angazhimit të tij, në hapësirat shqiptare nisi punën fakulteti i parë për studimet islame në gjuhën shqipe.

Nga kjo që u tha më lartë, po vërehet qartë se në nivel global, personalitetet fetare luajnë një rol kryesor në promovimin e respektit për vlerat njerëzore dhe mbrojtjen e tyre. Prestigji i një njeriu vjen nga dinjiteti i tij, i cili vjen nga sinqeriteti i të folurit e i sjelljeve, i kontributit e respektit për të tjerët, pavarësisht nga pozita, niveli arsimor dhe social i tij. Koncepti i prestigjit që e gëzon një person në mesin e njerëzve – shoqërisë, do të thotë se ky person është i nderuar dhe i respektuar, dhe se njerëzit e marrin parasysh, e respektojnë

dhe e nderojnë. Kjo sepse ai zotëron një sërë cilësish apo veçorish, të cilat e bëjnë atë shembull në mesin e popullit të tij, e i tillë ishte dr. Rexhep Boja, Zoti e pastë mëshiruar me mëshirën e Tij të pakufishme!

Gjatë veprimtarisë së tij, ishte karakteristikë e dr. Rexhep Bojës që të flasë pak e të punojë shumë. Sekretet personale që kishin të bënin me veprimtarinë për çlirimin e vendit i ndante me pak njerëz. Nuk ishte njeri ekspozues për punën e tij me të tjerët. Ai në vazhdimësi punonte për fe dhe atdhe me një heshtje të një intelektualit të mirëfilltë e të një njeriu të urtë dhe të drejtë në përmasa të gjera.

Ai ishte një personalitet unik, i cili tërhoqi vëmendjen e njerëzve brenda shoqërisë shqiptare dhe asaj islame e globale, gjë që e bëri atë të gëzojë një status të veçantë brenda shoqërisë shqiptare e më gjerë. Me një vendosmëri të prerë merrte çështjet e rëndësishme, të cilat kishin të bënin me çlirimin e vendit. Në këtë mënyrë, dr. Rexhep Boja, siç e quanim ne të gjithë, mori përgjegjësi për gjërat dhe situatat, që kishin të bënin me përmbushjen e premtimeve që një personalitet siç ishte dr. Boja ia bëri vetes. Duke u bazuar në aftësinë e tij të komunikimit, duke ditur se si të merrej me situata të reja dhe emergjente, dhe si një person me prestigj të lartë, shpesh u bënte përshtypje njerëzve me fleksibilitetin e tij të lartë në zgjidhjen e problemeve dhe përballimin me rrethanat emergjente. Ai pranonte kritikën brenda kufijve të arsyeshëm, duke mos lejuar askënd të tejkalojë kufijtë e lejuar dhe duke siguruar që e gjithë kjo të bëhet me qetësi dhe qëllim të pastër për të ardhmen e sigurt të vendit.

Për të marrë vendime apo për të zgjedhur mes opsioneve, dr. Rexhep Boja, ishte një personalitet i fortë dhe i mençur, duke mos lënë vend që të tjerët të konfirmojnë apo miratojnë vlefshmërinë e vendimeve të tij. Kjo pasi ai ishte i sigurt në vetvete dhe shokët përreth tij. Ai e dinte mirë se çfarë dëshironte, përkundër situatave tejet të vështira që krijonte atëkohë okupimi klasik serb. Dr. Boja e kuptonte rëndësinë e zgjedhjes së fjalëve në masë, për të përcjellë kështu mesazhin e tij të fortë e të qartë te masa, e cila atëherë përjetonte një aparteid të paparë nga forcat policore e ushtarake serbe dhe bandat e tyre.

Puna e Bashkësisë Islame në krye me Rexhep Bojën ishte shumë vizionare për një mbijetesë të imponuar prej okupuesve, por edhe me ndjenjën dhe motivimin e vazhdueshëm dhe përpjekjet për çlirim. Me punën tonë dhe me porositë e dr. Rexhep Bojës, puna e Bashkësisë Islame kishte përfshirë të gjitha segmentet dhe fushat e jetës. Aty ku ishte populli, aty ishte Bashkësia Islame. Aktivistë të shumtë të saj ishin shpërndarë anekënd Kosovës e vendeve të tjera shqiptare, por edhe në mërgatën e largët. Shumë nga nëpunësit e Bashkësisë Islame, imamë e administratorë u radhitën aty ku e kishin vendin, brenda UÇK-së dhe brenda thirrjes për t'i dalë në ndihmë popullatës së shpërngulur në Kosovë e vende të tjera të rajonit. Bashkësia Islame në fillim të vitit 1998, formoi edhe Këshillin e Emergjencës për t'iu dalë në ndihmë UÇK-së dhe popullatës së zhvendosur, por jo vetëm.

Prej 300 imamëve sa ishin të uniformuar me uniformën e UÇK-së, 37 prej tyre ranë dëshmorë – shehidë, për t'iu bashkëngjitur radhës së gjatë të emrave të dëshmorëve, të cilët ranë në altarën e lirisë për të mos vdekur kurrë. Kështu na mësonte dhe porosiste atëkohë i urti, hoxha, atdhetari dhe i pathyeshmi dr. Rexhep Boja, i cili thoshte: “Krahas përgjegjësisë që kemi për fenë, edhe kontributin për çlirimin e vendit e kemi farz – obligim, se punën tonë do ta shohë Zoti, Pejgamberi, por e shohin edhe të gjithë besimtarët në Ditën e Gjykimit, dhe për këtë, pa pikë dyshimi do të shpërblehemi tek Ai.”

Të nderuar të pranishëm,

Udhëheqësi fetar islam është një personalitet besnik, i ndërgjegjshëm dhe i sinqertë, i përkushtuar ndaj fesë së Zotit të tij dhe ndaj atdheut, i ekuilibruar dhe i integruar, që përpiqet për hir të Zotit dhe vatanit, të forcojë personalitetin e tij të pavarur dhe t'i shërbejë binomit Fe-Atdhe, gjë që e dallon atë nga të tjerët, e ky personalitet ishte vetë dr. Rexhep Boja.

Një nga karakteristikat më dalluese të lidershit është besnikëria ndaj parimeve të tij dhe qëndrimi në besimet e tij, duke refuzuar të devijojë qoftë edhe pak prej tyre, pavarësisht se sa është e madhe sakrifica apo rezistenca.

Dr. Rexhep Boja ishte njeriu më besnik ndaj parimeve të tij dhe një luftëtar i pashembullt për to. Ai nuk dëshironte t'i linte ato të preken e të përdhosen nga armiqtë e vatanit tonë. Besnikëria ndaj parimeve dhe qëndrueshmëria në idenë për liri, janë objekt i besimit dhe urdhër hyjnor. Kjo bindje dhe besnikëri, si dhe lidershipi i tij prej një personaliteti të urtë e vizionar, e bëri dr. Rexhep Bojën një njeri me vlerë të pavdekësisë, për kontributin e dhënë për mirëqenien fetare, çlirimin e vendit dhe njohjen e Kosovës si shtet sovran dhe i pavarur.

I ndjeri ishte një nga figurat e rëndësishme të lëvizjes së përgjithshme për çlirimin e vendit. Nga pozita që mbante si myfti i Republikës, ai kontribuoi efektivisht në aspekte të ndryshme të rizgjim të përgjithshëm të shqiptarëve, në ngritjen e idealit dhe motivimin për çlirim të vendit.

Ai, përmes aktiviteteve dhe kontributeve të shumta e të ndryshme, hapi rrugën e shumë iniciativave për të mirën e vendit, si në politikën sociale, kulturore, fetare dhe kombëtare. Ai mori pjesë aktive në hapjen e rrugës për formimin dhe motivimin e UÇK-së për çlirimin e vendit. Në vazhden e përpjekjeve për pavarësi, i ndjeri vazhdoi përpjekjet e tij në ndërtimin e themeleve të shtetit të ri të Kosovës.

Nga e gjithë kjo, mund të konkludojmë se personaliteti është shkëmbi mbi të cilin ngrihet çdo udhëheqje e fortë dhe e qëndrueshme. Si i tillë, ai duhet të jetë i palëkundur në fatkeqësi, kriza, luftëra, sprova rrethanash dhe sprova të ditëve; në vazhdimësi ngre kokën e tij duke u ngritur mbi retë e dyshimit dhe mbi retë e fiksimit dhe të hezitimit; zotëron atë fuqi që sfidon kohën, talljen dhe nënçmimin e ngjarjeve. Është ajo forcë që mposht dëshpërimin dhe ndihmon në çdo



akt të madh shoqëror dhe në çdo vepër të mirë e fisnike njerëzore.

Brenda kësaj, në vazhdimësi e gjejmë personalitetin e dr. Rexhep Bojës, i cili mësoi shumë edhe nga shkolla e jetës, të cilën më pas ai e bëri platformë, përmbajtja e së cilës duhet t'ju shërbejë studiuesve që të kërkojnë, të gjurmojnë dhe të studiojnë këtë rrugë apo platformë, e cila në vete ngërthen ende shumë gjëra të pathëna e të panjohura. Virtytet e tij në të gjitha fushat duhet të kopjohen dhe të përcillen te studiuesit dhe brezi i ri. Të gjithë ata që kanë punuar apo kanë bashkëvepruar me të e dinë këtë. S'ka dyshim se ai ishte një nga figurat e shquara në nivel kombëtar, i cili tërë jetën luftoi për vendin dhe fenë.

Ai ishte i pajisur me shumë cilësi, që rridhnin nga mësimet e Kuranit, mësimet e ligjit islam dhe nga realiteti praktik.

Përgjegjësia ndaj vatanit, drejtësia, besimi, konsultimi, devotshmëria, durimi, mbështetja në Zotin, diturinë, urtësinë, shpirtin e sakrificës, përmbushjen e besëlidhjes dhe përsosmërisë, janë elemente të rëndësishme të udhëheqjes në Islam, elemente këto, të cilat ishin të mishëruar në shpirtin dhe zemrën e dr. Rexhep Bojës.

Udhëheqja e tij e mençur, e urtë dhe e drejtë ndaj besimtarëve në përgjithësi, ishte një sukses i jashtëzakonshëm. Këto e çuan Bashkësinë Islame drejt asaj që ishte e mirë dhe e duhur për atdheun dhe fenë në këtë botë dhe në botën tjetër. Pas kësaj qëndronin cilësitë që i posedonte lidhshipi, virtytet dhe morali fisnik, që e kualifikuan atë të ishte një shembull dhe model i plotë i udhëheqjes së mençur dhe të suksesshme drejt arritjes së qëllimeve dhe objektivave, për të cilat erdhi mesazhi i Islamit dhe të cilat ishin kërkesa e kombit për vendin.

Një figurë e shquar siç ishte dr. Rexhep Boja ka një reputacion të spikatur dhe të lartë në shoqëri edhe pas vdekjes, ku respektohet dhe vlerësohet vepra e tij edhe nga brezat e rinj, por edhe nga të tjerët. Ky personalitet konsiderohet një model që duhet ndjekur. Një shembull që me punën dhe kontributin e tij fuqizon dhe motivon brezat e rinj për një edukatë dhe mirësjellje, për respekt e nder ndaj Krijuesit, fesë dhe vatanit, për një ndershmëri, dinjitet, përlusësi dhe lidhshipi të drejtë.

Të nderuar të pranishëm,

Falja dhe toleranca ishin virtyte që e shoqëronin në vazhdimësi punën e tij të suksesshme në rrethana tejet të vështira. Këtë ai e bënte gjithëherë i bazuar në atë që thotë Kurani: “Dhe sikur të ishit i vrazhdë dhe zemërgur, ata do të ishin shpërndarë nga rrethi juaj, prandaj falni ata!” (Ali Imran, 159).

Me gjithë tolerancën e tij, Allahu e bekoftë, dr. Rexhep Boja, ishte i vendosur në marrjen e çështjeve në duart e veta. Ai asnjëherë nuk u tërhoq nga marrja e vendimeve dhe zbatimin e tyre në të mirën e vendit kur çështja e kërkonte këtë. Ai gjithëherë konsultohej me shokët e tij për çështje të rëndësishme, si dhe përdorte mendime të shëndosha dhe logjike racionale në kapërcimin e problemeve të natyrave të ndryshme të asaj kohe.

Për fund:

Pa dashur të krijoj skena patetike, megjithatë para jush po e rikujtoj edhe takimin e fundit me dr. Bojën. Dhjetë ditë para vdekjes ishte tek unë në zyrë. Biseduam mundësinë që të shkojmë për disa ditë në Shqipëri, pa menduar se kjo dëshirë do të mbetet e parealizuar. Nga zyra ime e thirri djalin e tij në telefon dhe i tha: “Muhamed, shko boni përgatitjet e duhura në Shqipëri, me disa shokë do të vijmë pas pak ditësh.” Të nesërmen unë papritur u shtriva në spital ku pata një ndërhyrje kirurgjikale.

Dr. Rexhep Boja pothuajse për çdo ditë ishte aty, madje edhe vajzën e tij, doktoreshën e nderuar Safanë, e porosiste dhe i thoshte: “Shko vizitoje Myftiun dhe kur të hysh në dhomë, më thirr në telefon!” Pas një jave, unë dola nga spitali, por fatkeqësisht, të nesërmen dr. Boja u shtri në spital. Shkuam dhe e vizituam, e pash se nuk ishte mirë me shëndet. U larguam shumë të mërzhitur bashkë me shokët Elezin dhe Ahmetin, duke i dëshiruar shërim të shpejtë. Përkundër dëshirës sonë, engjëlli i vdekjes veprroi sipas porosisë së Zotit, duke marrë shpirtin e tij për ta qefinësuar me petkun e Xhenetit, e për të vazhduar në shtatë qiejt me aromën e miskut të një shpirti xhenetli e të dashur edhe për banorët e qiejve, dhe duke e vendosur në rrugën e amshueshmërisë, i shpërblyer dhe i graduar me të mirat e Zotit xh.sh..

Myftiu Naim ef. Tërnavë

Prishtinë, më 18 tetor 2024

Shenjtëria e fesë dhe mbrojtja e saj në të drejtën islame

Dr. Selatin Mehani

HYRJJE

Feja ka luajtur një rol qendror në zhvillimin e shoqërive dhe individëve gjatë gjithë historisë njerëzore. Që nga njeriu i parë, Ademi a.s., ajo ka shërbyer si një sistem besimi dhe praktike, që ka ndihmuar njerëzit të kuptojnë ekzistencën e tyre, të përballen me sfidat e jetës dhe të ndërtojnë marrëdhënie kuptimplota me të tjerët. Ajo që e karakterizon fenë është shenjtëria, gjë që e bën atë të paprekshme dhe të pacenuar. Me të drejtë, disa sociologë e kanë përkufizuar fenë si një sistem i ndërlidhur i besimeve dhe praktikave lidhur me gjërat e shenjta ose të ndaluara.

Ky punim modest, synon të sqarojë shenjtërinë e fesë nga perspektiva e të drejtës islame, lirinë dhe mbrojtjen e saj, në mënyrë që të hidhet dritë mbi vlerat më të larta të legjislacionit islam, si dhe të ekspozohet fryma e përgjithshme e tolerancës së tij.

NOCIONET “E SHENJTA” DHE “FEJA”

“E shenjta” apo “shenjtëria” arab. “قُدْسٌ” dhe “قُدْسٌ”, nënkuptojnë të pastrën dhe të ngriturën. Thuhet “قُدْسَةٌ” kur diçka është madhëruar dhe lartësuar.¹ Gjithashtu me “shenjtëri” është për qellim ajo që ka bekimin dhe vlerësimin hyjnor. Kur Musai a.s. i porositur nga Zoti arriti te vendi i caktuar, Zoti i tha: “Unë jam Zoti yt, andaj zbatih nallanet (opingat) tua, sepse ti je në luginën e shenjtë Tuva.” (Ta Ha, 12). Në kontekstin social, “e shenjta” (angl. sacred) është gjëja që zë vendin qendror në realitetin ose dukurinë shoqërore të quajtur fe.² Sipas disa sociologëve, si përmbajtja ashtu edhe forma e mendimit tonë janë shoqërore, respektivisht fetare.

Ndërsa është definuar edhe si: “Tipare kulturore dhe sociale, që nuk bazohen në sfond racional ose utilitar, që në asnjë mënyrë nuk mund të bëhen subjekt i gjykimit, karshi të cilave ndjehet një respekt i madh dhe u përshkruhet vlerë e lartë”³ Kjo nënkupton që “e shenjta” ose “shenjtëria” janë gjëra të cilat lartësohen në një shoqëri, sepse kanë një kualitet mbi punët e kësaj bote, duke qenë se janë në një rend të veçantë, pasi karakterizohen se kanë për veçori apo referencë hyjnore. Ndryshe nga kjo është “profanja”, që nënkupton gjërat që nuk kanë ndonjë kuptim simbolik jashtë praktikës së përditshme të racionalizuar.

Ndërsa “feja” arabisht «الدِّينُ – دِينًا – دِينًا», në kuptimin etimologjik nënkupton shpërblimin dhe kompensimin.⁴ Në këtë kontekst, Dita e Gjykimit është quajtur يَوْمُ الدِّينِ ‘Dita e shpërblimit’ (shih Kuranin, 1:4, 82/17-18, 83/11, 38/20,





51/12), dhe *يَوْمُ الْجَزَاءِ* 'Dita e kompensimit', pasi besohet se njerëzit do të shpërblehen dhe kompensohen për veprimet e tyre. Ashtu siç ka kuptimin e llogarisë, ligjit dhe gjykimit.⁵ Në Kuran përmendet: "...Ai, sipas ligjit të mbretit nuk mund ta merrte (për skllav) vëllain e vet..." (Jusuf, 76). Po ashtu, në kuptimin e llogarisë dhe gjykimit, esenca e fjalës "دين" (fe), është përdorur nga i Dërguari i Zotit, a.s., kur ka thënë: "I mençuri është ai që e llogarit veten dhe punon për atë që vjen pas vdekjes..."⁶

Ajetet kuranore që përmendin esencën e fjalës "دين", duke pasur për qëllim shpërblimin dhe kompensimin janë shumë, ndër to: "A pasi të jemi vdekur dhe të jemi bërë dhe e eshtra, do të jemi shpërblyer?!" (Safat, 53). Fjala "أَيْنًا لَمَدِينُونَ" (a do të shpërblehemi) derivon nga fjala "دين", që konsiderohet fjala bazë e emrit shqip "fe".

Feja në kuptimin terminologjik dhe praktikën njerëzore është përdorur për të shprehur bindjet fetare dhe ato ceremoniale të vendosura nga Zoti për lumturimin e njeriut. Me "bindje fetare" nënkuptohen ato bindje dhe përfytyrime që na njoftojnë lidhur me esencën e gjërave të shenjta, ndërsa "ceremonialet fetare" janë normat e sjelljes, të cilat na njoftojnë se si të sillemi përballë gjërave të shenjta. Domethënë feja është identiteti i besimit në të shenjtën, i organizimit të besimeve lidhur me të dhe më në fund, ritualeve dhe praktikave. Pra, feja sipas dijetarëve myslimanë definohet si "vendosje e Zotit që udhëheq në të vërtetën absolute në bindje, dhe në të mirën në sjellje dhe raporte". Në këtë kuptim, mësimet e fesë islame kanë për qëllim përmirësimin e gjendjes së njerëzve në këtë botë dhe shpëtimin e tyre në botën tjetër, duke u bazuar në burimin e saj që besimtarët e besojnë si burimin e vetëm të shenjtësisë.⁷ Për këtë Zoti i Lartësuar thotë: "Vërtet, fe e vetme e pranuar tek Allahu është Islami." (Ali

Imran, 19). Po ashtu thotë: "E kush ndjek përveç Islamit ndonjë fe tjetër, atij nuk i pranohet dhe në botën tjetër ai do të jetë prej të dëshpëruarve." (Ali Imran, 85). Ngjashëm thotë: "Dhe zgjodha për ju Islamin fe." (El Maide, 3). Pa mohuar faktin se, fe quhen edhe besimet dhe praktikat e tjera, të cilat njerëzit i pasojnë si të shenjta. Ekzistojnë gjëra që për disa njerëz ato janë profane, të cilat janë të shenjta për dikë tjetër, kurse nga ana tjetër ka gjëra që konsiderohen të shenjta që në esencë nuk kanë të bëjnë fare me të. Këtë fakt e pohon edhe Kurani kur thotë: "Ju keni fenë tuaj dhe unë fenë time." (El Kafirune, 6).

Përveç natyrshmërisë njerëzore, përshtatjes me logjikën dhe praktikën e arsyeshme, karakteristikë kryesore të fesë janë: Njëshmëria (التوحيد), natyrshmëria (الفطرة), toleranca (السماحة), barazia (المساواة), lehtësimi (التيسير), ndërnjohja mes njerëzve (التعارف) dhe kombinimi i interesave të kësaj bote me të botës tjetër (المصلحة).

ISLAMI GARANTON LIRINË E FESË

Liria dhe besimi, respektivisht feja dhe praktikimi i saj, janë të pandashme dhe lidhen ngushtë si në kuptim ashtu edhe në domethënie. Për këtë arsye, dijetarët e fikhut në librat e tyre kanë theksuar se parimi themelor i njeriut është liria.⁸ Mësimet e Islamit, me përshtatshmërinë e tyre për çdo kohë dhe vend, garantojnë lirinë e plotë të njeriut në besimin dhe praktikimin të tij në atë që beson. Liria e fesë dhe besimit, për të cilën në dekadat e fundit janë shkruar rregulla dhe norma me karakter ndërkombëtar duke e kategorizuar si një të drejtë elementare të çdo individi, është përmendur qysh herët edhe në librin e shenjtë, Kuranin. Aty thuhet: "Nuk ka imponim në fe." (El Bekare, 69). Nga ky këndvështrim, qartësohet realiteti i lirisë në kuptimin e saj më të gjerë, ku

nuk ka dhunë dhe detyrim në fe dhe në atë që njeriu zgjedh të besojë. Nëse feja është një nga përparësitë kryesore të shoqërisë, atëherë individi duhet ta praktikojë atë në një atmosferë lirie dhe pa ndonjë lloj detyrimi. Në këtë mënyrë, thellohet koncepti i lirisë dhe forcohet në mendjen e individit ideja e "lirisë së robërisë", që përfaqëson lidhjen e njeriut me Zotin në marrëdhënien e tij me Të, pa asnjë lloj robërie apo detyrimi nga çdokush tjetër. Kuptimi i kësaj lirie bëhet edhe më i qartë, kur kuptohet shkaku i zbritjes së këtij ajeti. Tefsirologët në domethënien e këtij ajeti përmendin: Nga Abdullah bin Abasi, me zinxhirë të transmetimit nga Ibën Ishaku, në lidhje me fjalën e Allahut: "Nuk ka detyrim në fe", tha se ky ajet zbriti për një burrë nga ensarët nga fisi Beni Salim bin Auf, i quajtur Husajn. Ai kishte dy djem që ishin të krishterë,

Nëse feja është një nga përparësitë kryesore të shoqërisë, atëherë individi duhet ta praktikojë atë në një atmosferë lirie dhe pa ndonjë lloj detyrimi.

ndërsa ai vetë ishte mysliman. Kështu ai i tha Profetit a.s.: “A t’i detyroj ata ta pranojnë Islamin, pasi ata kanë refuzuar përveçse krishterimin?” Dhe Allahu zbriti këtë ajet në lidhje me këtë çështje.⁹

Islami është mbrojtësi më i madh i lirisë dhe themeluesi i saj i parë përmes teksteve dhe mësimave të tij. Kjo vërehet qartë në ajetin në vijim, ku Zoti udhëzon të Dërguarin e Tij se si ai t’i trajtojë ndjekësit e tij në raport me besimin dhe fenë. Ai nuk i detyronte ata, por ua mësonte lirinë e zgjedhjes duke ua treguar atyre rrugën e drejtë. Nga perspektiva islame, liria në çështjet fetare është një parim themelor kuranor, ku besimi nën ndikimin e detyrimit konsiderohet i pavlefshëm. Kurani thekson: “*Sikur të donte Zoti yt, do të besonin krejt ata që janë në tokë. A ti do t’i imponosh njerëzit që të jenë besimtarë?!?*” (Junus, 99). Në këtë themel, shfaqet qartë vlera e lirisë si një vlerë islame që duhet të jetë në prioritet të shpjegimeve dhe analizave në përmbajtjet islame që diskutohen sot.

Mësimet islame promovojnë besimin, duke e favorizuar atë si të vërtetën dhe realitetin e vetëm. Megjithatë fryma kuranore është e tillë që për çështjet e besimit dhe fesë të diskutohet dhe debatohet lirshëm, për t’ju mundësuar njerëzve, si agentë të lirë dhe të moralshëm, që të bëjnë zgjedhje të informuara në lidhje me çështje të tilla. Kurani prerazi thekson: “*E ti thuaj: E vërteta është nga Zoti juaj, (prandaj) kush të dojë le të besojë, dhe kush të dojë le të mohojë.*” (El Kehf, 29).

Prandaj, myslimanët kanë përparësi në vendosjen e bazave për bashkëjetesën paqësore ndërmjet shoqërive me besime të ndryshme. Këto baza janë ato që i solli Islami, i promovoi dhe kërkoi nga ndjekësit e tij që t’i mishërojnë dhe t’i zbatojnë në praktikë, duke përfaqësuar kështu lirinë që sot përfshihet në ligjet ndërkombëtare. Ndërsa, sa u përket ajeteve kuranore që shpesh keqkuptohen dhe keqinterpretohen, sikur “*vrisni ata kudo që t’i gjeni*” (2:191, 4:89 & 4:91), ato i referohen situatave të caktuara gjatë luftës, tradhtive në shkëlqen e marrëveshjeve në luftë dhe idhujtarëve të kohës së të Dërguarit, të cilët luftonin të Dërguarin vazhdimisht duke i shpallur atij armiqësi të përhershme. Kjo qartë sqarohet në vargun kuranor: “*Luftoni në rrugën e Zotit ata që ju luftojnë, por mos tejkaloni kufijtë (në armiqësi), (sepse) Zoti nuk i do ata që tejkalojnë kufijtë.*” (El Bekare, 190).

MBROJTJA E FESË – OBJEKTIV I LEGJISLACIONIT ISLAM

Ligi islam erdhi për të nxjerrë nga njerëzit një popull më të mirë, që për shkak të moderimit të tij dhe mesatarisë në të gjitha çështjet, i ngritur mbi metodologjinë më të drejtë dhe më të saktë, i dalluar me veçori në konceptim, besim dhe veprim për arritjen e qëllimeve, duke e bërë të dalluar rolin civilizues të këtij populli, vlen të jetë shembull dhe model për t’u ndjekur. Ai duke pasur si qëllim lumturinë e njerëzve dhe realizimin e mirësisë dhe suksesit për krijesat, ka ardhur me rregulla që synojnë arritjen e qëllimeve të larta dhe objektivave të mëdha.¹⁰ Këto objektiva janë urtësia e përgjithshme e synuar në legjislacionin islam, për pesë qëllimet thelbësore, që përfshijnë ruajtjen e fesë, jetës, mendjes (intelektit), pasardhësve (gjenealogjisë) dhe pasurisë.

Mbrojtja e fesë konsiderohet si më e rëndësishmja nga pesë nevojat themelore, dhe nënkupton forcimin e shtyllave të fesë, zbatimin e rregullave të saj, kujdesin për kryerjen e tyre dhe shmangien e çdo lloj neglizhence në to, si dhe hedhjen poshtë të gjithçkaje, që është në kundërshtim me fenë. Për këtë arsye, janë ligjësuar shumë vepra si shqiptimi i dy dëshmimeve (shehadetit), falja, agjërimi, zekati, etj..

Mbrojtja e fesë për nga rëndësia e saj është në rangun e ruajtjes së jetës, për këtë arsye shumë nga usulistët kanë rënë në dilemë në renditjen e tyre. Ndërsa, ata që ruajtjes së fesë i dhanë prioritetin themelor, këtë e bënë për arsye se ngarkesa qendrore fetare bazuar në prioritetin temporal (kohor) është pikërisht njohja e Zotit. Prandaj, thirrja qendrore e Zotit ndaj bartësve të librave të shenjtë, qe: “*Thuaj: O ithtarët e Librit! Nuk jeni në asgjë, derisa t’i përmbaheni Tevratit e Ungjillit, dhe asaj që ju është shpallur nga Zoti juaj.*” (El Maide, 68). Ndërthyerja ekziston edhe midis pesë objektivave: Ruajtja e fesë në bazat e saj të qëndruara përfshinë ruajtjen e jetës, mendjes, pasardhësve dhe pasurisë, sepse ruajtja e tyre është nga themeloret më të mëdha të fesë. Gjithashtu, feja nuk realizohet pa ekzistencën e jetës dhe mendjes, dhe feja nuk vazhdon pa ruajtjen e pasardhësve, as nuk qëndron pa ekzistencën e pasurisë.¹¹ Mbrojtja e fesë konsiderohet një nga aspektet më të rëndësishme që e dallon sistemin islam nga sistemet e tjera. Ndërkohë që vërejmë se sistemet e tjera nuk synojnë mbrojtjen e vlerave shpirtërore, shohim se Islami synon mbrojtjen e tyre

Mbrojtja e fesë konsiderohet si më e rëndësishmja nga pesë nevojat themelore, dhe nënkupton forcimin e shtyllave të fesë, zbatimin e rregullave të saj, kujdesin për kryerjen e tyre dhe shmangien e çdo lloj neglizhence në to, si dhe hedhjen poshtë të gjithçkaje, që është në kundërshtim me fenë.

po aq sa mbrojtjen e interesave materiale. Ruajtja e këtyre domosdoshmërive (nevojave themelore) bëhet në dy mënyra: E para është ajo që forcon shtyllat e tyre dhe stabilizon bazat e tyre, që përfshinë kujdesin për to nga aspekti i ekzistencës; e dyta është ajo që i mbron nga çrregullimet që mund të ndodhin ose pritjet të ndodhin, që përfshinë kujdesin për to nga aspekti i mungesës së tyre.¹² Mbrojtja e fesë në nivelin personal arrihet përmes kryerjes së ibadeteve të caktuara nga Zoti. Ndërkaq, mbrojtja e saj në një sferë më të gjerë përfshinë mbrojtjen e saj nëse ajo sulmohet nga ndonjë armik, që kërkon përfshirjen më të gjerë se niveli personal. Për këtë arsye është bërë i ligjshëm xhihad. Kurani përmend: “Atyre që janë sulmuar, u lejohet (të mbrohen), sepse u është bërë padrejtësi...” (El Haxh, 39).

LIRIA E FESË NUK NËNKUPTON DENIGRIMIN

Në kohët e fundit, në tërë botën por edhe në vendin tonë, vërehet rritje e narratives me prapavijë fetare dhe orientime fobiste, të cilat pasohen me veprime tendencioze dhe fyese. Në mungesë të një debati konstruktiv, të informacioneve të sakta dhe qëllimeve të ndritura, shoqëritë sa vijnë e thellohen në krizën e urrejtjes ndërfaqetare. Ndërsa, në shoqëritë e pazhvilluara, në të cilat mbisundon injoranca dhe anarkia, organizohen edhe tubime dhe formohen lëvizje, të cilat përmes denigrimit të vlerave fetare, atakimit të parimeve dhe virtyeteve, synojnë destabilizimin e shoqërive duke krijuar kriza, provokime përmes mosdurimit. Qasjet e tilla nuk kanë të bëjnë me lirinë e fesë. Veprimet e tilla janë ogurzi për shoqërinë, të cilave duhet përgjigjur me urtësi dhe edukatë. Në këtë, orienton Kurani kur thotë: “Trego mëshirë, urdhëro në vepra të mira dhe shmangu nga të paditurit!” (El Araf, 199).

Provokimet e drejtpërdrejta me ndjenjat e brendshme shpirtërore të njerëzve dhe atakimin e vlerave, nuk duhen lejuar që të ndodhin askund, sikundër as në mesin tonë. Ato duhet të parandalohen nga të gjithë njerëzit qëllimshëm. Ndërsa, përgjegjësia apriori bie mbi institucionet gjegjëse dhe ato të rendit. Ata kanë përgjegjësinë kryesore që të ofrojnë siguri për bashkësitë dhe individët. Autoritetet e zbatimit të ligjit, si gjykata dhe policia, mbajnë përgjegjësinë për adresimin e manifestimeve përçarëse të intolerancës ndaj çdo individi ose bashkësie. Mosveprimi, veçanërisht mosbashkëpunimi, ndikon në kohezionin social dhe në disa raste të rralla mund të çojë në ekstremizëm të dhunshëm, dhunë dhe pikëpamje të polarizuara brenda pjesëve të ndryshme të bashkësisë së synuar. Bülent Şenay, përfaqësues personal i kryesuesit të OSBE-së për Luftimin e Intolerancës dhe Diskriminimit ndaj Myslimanëve, ngre alarmin paralajmërues kur thotë: “Tani, urrejtja antimyslimane ka pësuar një ndryshim shqetësues në nivel individual dhe institucional, nga e rrallë në të zakonshme. Ka një mungesë shqetësuese të

*guximit politik dhe lidershit për këto çështje. Së bashku, ne duhet ta trajtojmë këtë kërcënim mbi bashkëjetesën tonë paqësore.”*¹³

Debati dhe diskutimi ideal duhet të jetë i sjellshëm, i respektueshëm dhe i civilizuar. E kur ai nuk është i tillë, karakteri i myslimanit duhet t’iu përgjigjet fyerjeve dhe sjelljeve të pa civilizuar dhe dhunës me durim, me falje dhe mëshirë. Ata që udhëhiqen nga mësimet e Islamit dhe Profetit Muhamed a.s. duhet të tregojnë karakteristika të tilla dhe jo të provokohen prej akteve të dhunës dhe ofendimeve. “Robërit e të Gjithëmëshirshmit janë ata që ecin me modesti nëpër Tokë dhe, kur të paditurit i sulmojnë me fjalë, ata përgjigjen: “Paqja qoftë!” (El Furkan, 63). Përgjigja islame ndaj provokimit bazohet në dinjitet, durim dhe falje. Kjo traditë e të qenit të hapur dhe bujarë është një nevojë urgjente për t’ju përgjigjur provokimeve dhe sulmeve të vazhdueshme të atyre që synojnë destabilizimin e vendit të gjeneruara nga intoleranca fetare.

PËRFUNDIM

Feja ka luajtur një rol qendror në zhvillimin e shoqërive dhe individëve gjatë historisë njerëzore. Liria dhe besimi, respektivisht feja dhe praktikimi i saj janë të pandashme dhe lidhen ngushtë si në kuptim ashtu edhe në domethënie. Mësimet e Islamit, me përshtatshmërinë e tyre për çdo kohë dhe vend, garantojnë lirinë e plotë të njeriut në besimin dhe praktikimit të tij në atë që beson. Në anën tjetër mbrojtja e fesë konsiderohet si më e rëndësishmja nga pesë nevojat themelore. Debati për fenë dhe diskutimi ideal duhet të jenë me mirësjellje, respekt dhe civilizim, ndërsa përgjigja islame ndaj provokimit bazohet në dinjitet, durim dhe falje.

1 El Mu'xhem el Vesit, 2/719.

2 Allan G. Johnson, *The Blackwell Dictionary of Sociology*, Cambridge Massachussets, 1995, f. 232

3 Po aty, fq. 223.

4 Ibën Mendhur, *Lisan el Arab*, Dar Sadir – Bejrut, 13/169, lënda دين.

5 Po aty, 13/167.

6 Hanbeli, Ahmed bin Muhamed bin Hanbel, *El Musned*, bot. 1, vëll. 13, fq. 272, nr. 17059, Dar El Hadith, Kajro, 1995.

7 Atije, Muhjedin Muhamed Atije, *El Islam ed Din el Evhad li el Insan*, www.alukah.net, fq. 5.

8 Ibën Ashur, Muhamed bin Ashur, *Mekasid esh Sheriati el Islamiye*, rec. Muhamed Tahir Mejsavi, Dar Nefais, bot. 3, fq. 390.

9 Mevsuatu *Et Tefsir el Ma'thur*, bot. 1, 4/476.

10 Dr. Valon Myrta, *Mekasid et Teshri el Islamiy fi es Sijaseti ve el Hukm*, temë doktorate e mbrojtur më 3/8/2016, në Universitetin e Jordanit. Aman, 2016. fq. 1.

11 Po aty, fq. 308.

12 Shatibiu, Ibrahim bin Musa bin Muhamed esh Shatibi, *El Muvafekat*, vëll. 1, fq. 324-325.

13 Krimet e urrejtjes antimyslimane, Kujdesi për nevojat e sigurisë së bashkësie myslimane, Udhëzues praktik, Publikuar nga Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, 2023, fq. 3.

Hytbeja e minberit

(KRITERET PËR ZGJEDHJEN E TEMËS SË HYTBES SË XHUMASË)

Mr. Avdyl Rrahmani

Për të përgatitur një temë, ekzistojnë etapa nëpër të cilat duhet të kalojmë, derisa të arrijmë në nivelin dhe fazën e duhur të paraqitjes para audiencës. Pika e fillimit në hartimin e çdo ligjërate duhet të fillojë nga (për)zgjedhja e temës dhe identifikimi i çështjes ose problemit për të cilin folësi do të flasë. Pasi të zgjedh temën, ligjëruesi duhet të zbatojë mendimin e tij dhe të reflektojë mbi aspektet e temës së zgjedhur. Ai fillon të shkruajë veçoritë e saj, të parashtrojë skicat e saj të gjera dhe të përcaktojë idetë kryesore dhe nën-idetë që bien nën to, e kjo është faza e ndarjes së temës në elemente ose nëntema.

Pastaj ligjëruesi duhet t'u shërbejë këtyre elementeve dhe t'i mbështesë me materiale

shkencore dhe prova të përshtatshme, në mënyrë që të mos thotë fjalë mashtruese, të cilave u mungojnë provat. Prej këtu vjen faza e tretë, që është faza e përgatitjes së materialit dhe e mbledhjes së provave shkencore. Pas kësaj, ligjëruesi rishikon materialin që ka mbledhur dhe e vendos çdo provë në pozicionin e saj që ajo shërben.

Prandaj, kur zgjedh temën e predikimit të tij, ligjëruesi duhet të ketë parasysh këto çështje:

Tema duhet të jetë e përshtatshme me kushtet dhe mjedisin e të pranishmëve; të ketë parasysh problemet që i preokupojnë ata; të jetë me interes për ta; dhe të jetë e përshtatshme me nivelin akademik të tyre.

Tema duhet të jetë e përshtatshme me kushtet dhe mjedisin e të pranishmëve; të ketë parasysh problemet që i preokupojnë ata; të jetë me interes për ta; dhe të jetë e përshtatshme me nivelin akademik të tyre.



Ligjëruesi duhet të trajtojë një çështje që konsiderohet pjesë e pandarë e ligjit islam dhe se ajo vërtet do t'u sjellë dobi myslimanëve.

Kjo kërkon që predikuesi të njihet me realitetin e xhematit, në mënyrë që të zgjedhë temën që është e përshtatshme për ta dhe që lidhet me jetën dhe realitetin e tyre. Nuk mjafton që tema të tërheqë admirimin dhe interesin e folësit, duke qarë apo duke e ngritur zërin vend e pa vend. Ajo assesi nuk do ta ketë efektin e saj nëse nuk u përshtatet adresuesve.

Për shembull: Të flasësh për shpenzimin dhe dhënien e zekatit është e rëndësishme, por nuk është e përshtatshme nëse ligjëruesi e ka zgjedhur këtë temë dhe ligjëron me të para një xhema, i cili mezi e siguron kafshatën e gojës. Do të ishte më e arsyeshme që ai t'u ligjëronte atyre për shkaqet që e sigurojnë kafshatën e gojës, për angazhimin e punën, si dhe për shpresën në Zotin e Plotfuqishëm që Ai do t'u bëjë lehtësim pas vështirësisë.

Të flasësh për shpresën në faljen e Zotit të Madhëruar dhe për gjerësinë e mëshirës dhe faljes së Tij, është një çështje me rëndësi të madhe, por nuk është e përshtatshme kur u drejtohesh një grupi njerëzish të pakujdesshëm në bindje dhe adhurim, apo të devijuar tërësisht, zemrat të cilëve janë ngurtësuar dhe sytë e të cilëve janë larg nga të qarët prej frikës së Zotit. Është më e përshtatshme që predikuesi t'u flasë për fatin e atyre që janë të pakujdesshëm ndaj urdhrave të Allahut.

TEMA DUHET TË KETË KARAKTER BASHKUES DHE ASSESI PËRÇARËS E HUTUES NDËRMJET MYSLIMANËVE.

Ligjëruesi duhet të jetë shumë i kujdesshëm që ligjëratat të jetë larg nga çdo nxitje për grindje dhe përçarje mes myslimanëve, të tilla si miratimi i një mendimi të veçantë nga jurisprudenca për një çështje të diskutueshme, të qenët fanatikë ndaj saj, nënçmimi i kundërshtarëve dhe kritikimi i tyre. Këto e bëjnë situatën të ngarkuar ndërmjet grupeve mbështetëse dhe atyre kundërshtarë, dhe nga ana tjetër çon në dis-harmoni, konflikt, diskutim dhe grindje midis tyre.

Po ashtu, ligjëratat duhet të jetë larg nga provokimi i një konflikti që ka rënë në mes të dy taborëve në lagje, në fshat ose qytet, në

mënyrë që ajo më pas të shkaktojë zgjim të grindjes pasi që është qetësuar për një kohë të gjatë, Zoti e mallkoftë atë që e zgjon konfliktin.¹

Ka disa ligjërues që nuk e marrin parasysh këtë. E shohim njërin prej tyre se si ligjëron për domosdoshmërinë e respektimit të thënies: “*Dëshmoj se Muhamedi është i Dërguari i Zotit*” kur myezini e thërret ezanin. Një tjetër adopton vetëm nëntema që ngrenë mosmarrëveshje dhe ndarje, si për shembull të folurit për ndalimin e fotografimit, që ka të bëjë me kapjen e hijes së një objekti. Së treti, ai i fokuson ligjërimet e tij në dallimet juridike dhe është i ashpër ndaj atyre që nuk pajtohen me të, si të folurit me fanatizëm për detyrimin e mbulimit të fytyrës dhe të duarve për gratë, e që kjo nuk është e nevojshme të ligjërohet, sepse kjo futë te xhema ndasi e përçarje.

Ligjëruesi duhet të trajtojë një çështje që konsiderohet pjesë e pandarë e ligjit islam dhe se ajo vërtet do t'u sjellë dobi myslimanëve.

Assesi nuk bën që ligjëruesi të zgjedhë tema, që janë larg fushës së ligjit islam, dhe as të tilla që nuk janë diçka mbi të cilën mund të bazohet puna e tij. Në fakt, ato ndonjëherë mund të jenë shumë larg nga përfitimi i audiencës. Më ka ndodhur një herë që një nga ligjëruesit mbajti një hytbe dhe tema e hytbes ishte – sipas mendimit tim – befasuese, e që kishte të bënte me atë se prindërit e Profetit, *paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të*, do të jenë në Xhehenem dhe se sipas tij, kjo është e pakontestueshme. Ai filloi të sjellë argumente se ata vërtet do të jenë nga banorët e Xhehenemit! Kjo është një çështje që për mendimin tim nuk sjell dobi, dhe se mosnjohja e saj nuk sjell kurrfarë dëmi. Gjithashtu kjo temë dhe tema të tilla si kjo, as nuk janë nga bazamentet e Islamit, dhe as nuk adhurohet Zoti me to.

Për më tepër, argumentet që citojnë këta të varfër nuk janë përfundimtare, dhe të gjitha i nënshtrohen probabilitetit. Ato mund që shumë lehtë të përgënjeshtrohen dhe të hidhen poshtë. Për më tepër, kjo nuk është një çështje për të cilën ka unanimitet. Përkundër kësaj, ka prej ligjëruesve që e thotë me tërë zërin e tyre: “Ata janë në Xhehenem, edhe nëse kjo na trishton.” Nuk e di pse gjithë kjo këmbëngulje për të vendosur se ata janë në Xhehenem, dhe pse i preokupon audiencën me të?! Do të ishte më mirë që këta njerëz të

jenë të preokupuar me myslimanët që ditë e më shumë po janë më afër zjarrit dhe po shkojnë drejt tij me mëkatet e tyre dhe të ishte preokupim i tyre se si t'i shpëtojnë ata nga lufta ideologjike që dita-ditës dëshiron t'i largojë ata nga feja e tyre.

E pyesim këtë ligjërues dhe shokët e tij që ngrenë këto çështje: Na thuaj, çfarë përfitojnë myslimanët nga kjo çështje dhe të tjera si kjo në jetën dhe në të ardhmen e tyre?! Çfarë ju shërbejnë këto tematika atyre dhe myslimanëve? Ku është dobia prej tyre?

ME RASTIN E ZGJEDHJES SË TEMËS, DUHET MEDOEMOS TË MERRET PARASYSH AKTUALITETI.


Nuk është e përshtatshme që aktualitet të jetë beteja e Bedrit, dhe pastaj ligjëruesi t'u flas xhematit për natën e Israsë dhe Miraxhit. Në lidhje me këtë çështje, ligjëruesi duhet t'i vërë re ngjarjet aktuale dhe bashkëkohore, duke u përpjekur që t'i përdorë ato dhe të nxjerrë tema prej tyre, të cilat do t'u sillnin dobi dëgjuesve. Ka shumë ngjarje që ndodhin, të cilat në brendinë e tyre bartin mësim të mëdha dhe të dobishme, përmes të cilave ligjëruesi mund ta bëjë shumë atraktive temën për të cilën do të flasë.

SHKRUAJE LIGJËRATËN SA HERË QË DEL PARA MASËS.

Sa e sa ligjërues janë të famshëm në ligjërimet e tyre, por shumica prej tyre e dëshirojnë admirimin momental nga xhemati. Kjo ndodhë sepse ligjëruesi vetëpëlqehet me disa fjalë miradije dhe mendon se xhemati kanë përfituar nga ai, por si të dalin nga xhamia ose nga salla ku e kanë dëgjuar ligjëratën, ata harrojnë gjithçka. Edhe nëse ligjëratat incizohet me mjete që sot janë kulmi i teknologjisë – ato vetëm nëse ruhen me precizitet – sepse pas një kohe edhe ato humbin. E vetmja gjë, e cila i ruan ligjëratat tua është përmbledhja e tyre në një libër, i cili edhe nëse vonon e botohet pas 10 vjetëve është shumë më efikas se mijëra ligjëratat që incizohen, natyrisht duke mos ia humbur vlerën edhe teknologjisë. Pastaj, kur ti e shkruan ligjëratën dhe del me të para masës, ajo të ndihmon që të jesh më përmbajtësor dhe mos t'i harrosh gjërat elementare.

Mos e zgjatë ligjëratën, sepse xhemati kanë ardhur për të falur farzin dhe të marrin një mesazh nga xhumaja, e assesi ta mësojnë tërë fenë përmes një ligjërate të xhumasë 12 minutshe.

Ka ankesa nga xhemati që disa hoxhallarë e mbajnë vetëm ligjëratën 40 minuta. Kjo vërtet e humb efektin, dhe nëse është vapë apo ftohtë, shumica e xhematit irritohen dhe sidomos ata që kanë ardhur rastësisht, apo i ka shpie rruga. Të tillët herën e dytë kurrë nuk do të vinë te ti.



Së fundi e këshillojmë ligjëruesin që të mendojë me kujdes për përgatitjen e temës së tij dhe ta përcaktojë me kujdes të mjaftueshëm para se ta mbajë atë.

Duhet ditur se zgjedhja e temës nuk duhet shtyrë deri në fund të javës, por në fillim të javës, para të premtes për të paktën pesë ose gjashtë ditë, në mënyrë që ai të ketë mundësinë ta studiojë atë nga të gjitha aspektet e saj dhe të marrë parasysh të gjitha arsyet që e pasurojnë ligjërimin për temën e propozuar, në mënyrë që të merret me të gjatë gjithë javës deri të vije koha për ligjërim që të dalë sa më mirë para masës.

1 Dr. Muhamed Abdel Qader abu Fares, Udhëzime të përgjithshme për përmirësimin e hytbes së xhumasë, fq. 34, përshtatur, Darul Furkan, Aman, Jordani.

Zanafilla e objektivave të Sheriatit dhe kontributi i dijetarëve në zhvillimin e tyre

Rrustem Rrustemi

OBJEKTIVAT E SHERIATIT

Për ta kuptuar zanafillën dhe zhvillimin e objektivave të Sheriatit është e udhës të dimë fillimisht se çfarë janë objektivat dhe me çka merren ato. Objektivat e Sheriatit apo shkenca e *mekasidit*, merret kryesisht me studimin e argumenteve dhe normave, ashtu siç merret me urtësitë dhe qëllimet në bazë të së cilave legjitimohen detyrimet dhe ndalesat. Kjo shkencë, në shekujt e parë të Islamit nuk ka qenë e njohur si shkencë e ndarë nga shkenca e Usul el Fikhut, me të cilën gërshejnë tema të ngjashme. Dijetarët e asaj kohe nuk dhanë

përkufizime të *mekasidit*, madje as studiuesi më i famshëm i shkencës së *mekasidit*, Shatibiu r.a., nuk solli definicion që e përkufizon atë, ndonëse ishte titullar i kësaj disipline. Nga të rrallët e hershëm që ofroi definicion të objektivave është dijetari Ibrahim en Nehaiu r.a., i cili duke mbrojtur shkollën e opinionit (medresetu rreji), që e themeloi me vone nxënësi i tij Ebu Hanife r.a., thotë: “Normat e Zotit kanë qëllime, ato janë urtësi dhe interesa që janë në të mirën tonë.”¹

Me vone, studiuesit bashkëkohorë janë ata që sollën definicione, madje shumë, po

“Normat e Zotit kanë qëllime, ato janë urtësi dhe interesa që janë në të mirën tonë.”



veçojmë disa prej tyre. Dijetari bashkëkohor nga Maroku, që studion fushën e *mekasidit*, Ahmed Rrejsun, e përkufizon kështu *mekasidin*: “Objektivat që vuri Sheriati për realizimin e tyre në interes të njerëzve.”² Ibën Ashuri r.a., ka thënë: “Kuptime dhe urtësi të shënuara të Sheriatit në të gjitha rastet e legjislacionit apo në shumicën e tyre, ku shënjimi i tyre nuk kufizohet vetëm në një lloj të caktuar të normave të Sheriatit.”³

ZANAFILLA E OBJEKTIVAVE TË SHERIATIT

Objektivat datojnë që nga shekulli I, atëherë kur po shpallej Kurani fisnik. Pra, ato janë evidente në tekste kuranore. Zoti xh.sh. theksoi arsyetime të veprimeve të Tij.⁴ Ai, kur na dha indikacion të arsyes së dërgimit të pejgamberëve tha se, arsyeja ishte vënia në pah e argumenteve që njerëzit mos të thonë nesër para Zotit se nuk kemi pasur pejgamberë, dhe për rrjedhojë nuk e kemi ditur. Allahu xh.sh. thotë: “*Të dërguar që ishin lajmgëzues e kërcënues, ashtu që pas dërgimit të të dërguarve njerëzit mos të kenë fakt (arsyetim) para Allahut.*” (En Nisa, 165).

Ndërsa, sa u përket qëllimeve të normave të hollësishme që gjenden në Kuran dhe Synet janë aq shumë, sa që nuk numrohen.⁶ Ja ca shembuj: Allahu xh.sh. kur flet për mungesën e ujit dhe zëvendësimin e tij me dhe për të marrë tejumum, thotë: “*Allahu nuk dëshiron (me obligim për abdes e larje) t’iu sjellë ndonjë vështirësi, por dëshiron t’ju pastroj të mirën e Tij ndaj jush e që t’i falënderoheni.*” (El Maide, 6).

Kur Zoti i Gjithëdijshtëm urdhëroi për faljen e namazit, Ai xh.sh. tregoi qëllimin e normës: “*Fal namazin, vërtet namazi largon nga të shëmtuarat dhe te irrituarat.*” (El Ankebut, 45).

Objektivat zënë vend edhe në fjalët dhe veprat e të Dërguarit të Zotit, Muhamedit a.s.. Po kujtojmë vetëm disa shembuj:⁹ Një njëri iu ankua të dërguarit të Zotit për shkak se imami po zgjaste namazin. Muhamedi a.s. i hidhëruar kishte thënë: “O njerëz, dikush nga ju po i përzë njerëzit, prandaj kush i prin popullit në namaz le ta shkurtojë atë, se prej tyre ka të sëmure, të dobët dhe njerëz me nevojë.” (Buhariu, 7159 dhe Muslimi, 466).¹⁰

Edhe në *ibadete* madje siç është namazi po u dashka kujdes ndaj urtësisë, mesatarisë dhe lehtësimit. Pejgamberi a.s. po ia tregonte shkakun e kërkim të lejes për të hyrë në një shtëpi atij që shikoi nga vrima në dhomën e Pejgamberit a.s.. I Dërguari i Zotit po thoshte: “Kërkim leja për të hyrë në shtëpi është bërë

për shkak të shikimit (që të mos shikohet).” (Muslimi, Ebu Davud).¹¹

Kurse, kur Pejgamberi a.s. po ua tërhiqte vërejtjen njerëzve që të jenë të kujdesshëm dhe të matur edhe në dhënien e lëmoshës, tha: “Shkon ndokush prej jush dhe nxjerr tërë pasurinë, pastaj bëhet barrë e të tjerëve.” (Ibën Hazmi).¹²

Pastaj, Pejgamberi a.s. inkurajoi të fejuarin që ta shikonte të fejuarën e tij. Ai tha: “Shikoje atë sepse shikimi i saj do të zgjasë (dashurinë në mes jush).” (Buhariu dhe Muslimi).¹³

Objektivat e Sheriatit i gjejmë të theksuara edhe në jetën e sahabëve. Ibnul Kajimi r.a. ka thënë:¹⁴ “Sahabët ishin njerëzit që më së miri e kuptonin Pejgamberin a.s.. Ata ishin pasuesit më të denjët të tij, por gumëzhinin për të kuptuar se çfarë dëshironin dhe synonte ai.” Po sjellim vetëm një shembull që argumenton prezencën e mendimit objektiv në kohën e tyre. I Dërguari a.s. kishte urdhëruar sahabët që të shkonin te fisi Benu Kurejdha dhe mos të falnin namazin e ikindisë deri të arrijnë atje. Koha e namazit po mbaronte para se të arrinin në pikësynimin e tyre. Sahabët u ndan në dy qëndrime të ndryshme, njëri grup insistoi që mos të faleshin derisa të

arrinin në vend edhe nëse do të kalonte koha, ndërsa grupi tjetër u falën para se të mbërrin që të mos u kalonte koha e namazit. Grupi i parë u arsyetua me faktin se urdhri i Pejgamberit a.s. ishte “*i qartë*”, ndërsa grupi i dytë u arsyetua duke thënë se Pejgamberi a.s. nuk e kishte për qëllim lënien e namazit, por nxitimin tonë për të arritur te fisi Benu Kurejdha. Transmetuesi i hadithit, rrëfen se si i Dërguari i Zotit nuk e qortoi asnjërin nga dy grupet. (Buhariu, 4119).¹⁵

Studiuesi bashkëkohor i *mekasidit*, Ahmed Zaki Jemani,¹⁶ ka thënë: “Mund të themi se lider i *Fikhut Mekasidij* është prijësi i besimtarëve Omer ibën Hatabi r.a.. Banorët e Medinës, në çështjet e tyre u referoheshin Sunetit të Pejgamberit a.s. dhe gjykimeve të Omerit r.a.. Këtë e konfirmon Ibën Tejmije në fetvatë e tij.” Për kujdesin e Omerit ndaj objektivave dhe interesave të njerëzve tregojnë shumë gjykime rastesh nga jeta e tij. Prandaj, jurisprudenca e Omerit r.a. kaloi te shtatë juristët e Medinës. Pikërisht për këtë, medhhebi maliki u shqua me përkushtimin ndaj objektivave të Sheriatit, e që ishin zgjerim i jurisprudencës së Omerit r.a.. Është thënë se medhhebin maliki nuk e themeloi imam Maliku, ai e kishte gjetur të formuar në Medinë. Shtu edhe faktin se medhhebi maliki ishte veçuar me marrjen e interesave të

“O njerëz,
dikush nga ju
po i përzë
njerëzit,
prandaj kush i
prin popullit
në namaz le ta
shkurtojë atë,
se prej tyre ka
të sëmure, të
dobët dhe
njerëz me
nevojë.”

(Hadith)

papërcaktuara (mesalihul-mursele) si bazë të Sheriatit.

Por, kur nisën të zhvilloheshin objektivat e Sheriatit, që më vonë do të njihen si shkencë e *mekasidit*? “Teoria e *mekasidit*, zë të zhvillohej pas kohës së sahabëve, megjithëse objektivat në formën sesi i njohim sot, nuk u kristalizuan derisa erdhën teoricienët e mëvonshëm (usulijuntë), do të thotë nga shek. V gjer në shek. VIII hixhri.”¹⁷

Pra, objektivat e Sheriatit janë trajtuar edhe në shekujt e parë të Islamit por, nuk ishin të njohura me fjalën “mekasid”. Ato u shpjegonin nën emërtime të ndryshme si fjala vjen: urtësia (el hikme), motivi (sebeb), interesa (mesalih), etj.. Në brezin e ardhshëm (tabiinët) do të shihnim se dituria e sahabëve që ishte marrë nga Pejgamberi a.s. po trashëgohej. Atëherë edhe ishin hedhur themelet e dy shkollave juridike: Shkolla e opinionit (ehlul rre’ji) në Irak dhe shkolla e hadithit (ehlul ether) në Hixhaz. Të dyja shkollat merrnin parasysh objektivat e Sheriatit. Vetëm sa për ilustrim po sjellim disa shembuj të përpjekjes objektive të këtij brezi në disa nga çështjet me të cilat po ballafaqoheshin:

Lejuan përcaktimin e çmimit të produktit në qoftë se njerëzit ndiejnë nevojë për të;

Anuluan truket legjitime (hijel sher’ije), sepse ato kundërshtonin objektivat e Sheriatit.

KONTRIBUTI I DIJETARËVE NË ZHVILLIMIN E OBJEKTIVAVE SHERIATIKE

I pari që shkroi në lidhje me objektivat vëmë re se ishte Ebu Bekër el Kafal el Kebiri (v. më 976), i njohur si Esh Shashij, i cili shkroi librin “*Mehasinush Sheria*”. Ndërkaq, Urtaku Tirmidhiu (v. më 908) me librin: “*Es Salatu ve Mekasiduha*”, ishte i pari që përmendi fjalën objektiva (mekasid), ku trajton objektivat, urtësitë dhe sekretet e namazit.¹⁸ Pastaj, është Ebu Zejd el Belhi (v. më 933) që shkroi librin “*El Ibane an Illel ed Dijane*”, libri i parë i shkruar për objektivat e Sheriatit në fushën e transaksioneve, ku vë në pah objektivat që fshihen pas normave ligjore.

Nga të hershmit, po ashtu që shkroi mbi objektivat është Imamul Haramejni El Xhujeni (v. 1085) në librin “*El Burhan fi Usul el Fikh*”. Ky ishte i pari që hodhi studimin e teorisë së “niveleve të domosdoshmërisë”. Pas tij vjen nxënësi i tij Imam el Gazaliu (v. më 1111) në librat e tij “*El Mustesfa*”. Aty radhiti

Nga të hershmit,
po ashtu që
shkroi mbi
objektivat është
Imamul
Haramejni El
Xhujeni (v.
1085) në librin
“*El Burhan fi
Usul el Fikh*”. Ky
ishte i pari që
hodhi studimin e
teorisë së
“niveleve të
domos-
doshmërisë”.

domosdoshmëritë që shtroi mësuesi i tij në këtë formë: Feja, jeta, mendja, pasardhësit dhe pasuria. Gazaliu nuk konsideroi se ndonjëra nga objektivat mund të jetë argument në kuptimin bazik, madje i quajti ato “objektiva deluzive”. Ai mbajti këtë qëndrim, sepse objektivat burojnë nga qasja induktive (el istikra) e librit të Zotit, Kuranit, dhe se nuk nxirren nga ajo që përmbajnë tekstet e qarta sikur që janë tekstet sheriatike argumentuese. Megjithatë, Imam Gazaliu, siç tregojnë shumë autorë të fushës përkatëse, përdori qartazi objektivat atëherë kur shpjegonte llojet e interesit. Këtë e bëri për të ndërtuar bazë për disa nga normat.

Mandej vije Fahrudin err Rraziu me librin “*El Mahsul*”. Pas tij, është El Izz bin Abduselam, që shkroi dy libra të vegjël “*Mekasidus Sala*”, dhe “*Mekasidus Savm*”, por në librin “*Kavaidul Ahkam fi Mesalihul Enam*” bëri një gjurmim më të thellë të pikëpamjeve të interesave dhe dëmeve, si dhe ndërlidhjen në mes të normave dhe objektivate të tyre.

Imam el Karafi (v. me 1285) në “*El Furuk*” shpërfaqte kontributin në formësimin teorik të objektivate të Sheriatit siç janë sot. Ai në bazë të asaj që kishte për qëllim Pejgamberi a.s. bëri diferencimin në mes veprimeve të tij. “I Dërguari i Zotit kur fliste në emër të komunikimit të Shpalljes dallonte me komunikimin e tij si njeri i rëndomtë”, pohonte ai. Ashtu siç shkroi për “hapjen e arsyeve për të arritur qëllime”. Në “*Fet-hu Dherai li Tahkik el Mesalih*”, El Karafi ka thënë: “Mjetet që të dërgojnë te

gjërat e dëmshme duhen mbyllur, ndërsa mjetet që të dërgojnë tek interesat duhen hapur.” Ibën Kajimi (v. me 1347) është nga dijetarët që njashtu u mor me objektivat. Ai në librin “*Ilam el Muvekiin*”, thotë: “Sheriati ndërtohet dhe bazohet në urtësitë dhe interesat e njerëzve në këtë botë dhe në tjetrën. Ai është i tëri drejtësi, mëshirë, urtësi dhe interes...”¹⁹ Mandej, erdhi Imam Shatibiu (v. me 1388) themeluesi dhe teoricienti i shquar i *mekasidit* që shkroi librin e famshëm “*El Muwafekatë fi Usul esh Sheria*”. Sipas studiuesit bashkëkohor të mekasidit, Jasir Aude, imam Shatibiu transformoi objektivat në tri nivele: Nga interesat e papërcaktuara “Mesalihul Mursele” te bazat e Sheriatit “Usulu esh Sheria”, nga urtësitë pas normave “El Hikmetu min Verai el Ahkam” te bazat e normave “Kavaidul Ahkam”, nga



argumenti i hapur për interpretim “Edh dhanij” tek argumenti i prerë “El kat’ij”²⁰

Në kohën bashkëkohore u dallua Imam et Tahir Ibën Ashuri r.a., pionieri i *mekasidit*. Ai shkroi librin “Mekasidush Sheria el Islamiye”, ku shtjelloi temat si: objektivat e personit përgjegjës (El Mukelef) dhe objektivat e Ligjvënësit, si dhe raportet mes tyre, lidhshmëria e objektivave me *ixhtihadin*, rrugët e vërtetësisë së objektivave, etj.. Dhe së fundmi, në vitin 2006 në Londër, është themeluar Qendra për Studime të Objektivave të Sheriatit Islam, e lidhur me Fondacionin El Furkan. Qendra, përfshinë një grup elitare studiuesish të interesuar për objektivat e Sheriatit islam, të kryesuar nga: Dr. Jusuf el Karadavi,²¹ dr. Muhamed Salim el Ava, shejh Ahmed Zaki Jemani, dr. Muhamed Vehbi Zuheili, dr. Ahmed Jusuf Sulejman, dr. Abdullah bin Bijh, dr. Seifud Din Abdel Fetah, dr. Ahmed Rrejsuni, dr. Ahmed Hasun, shejh Feisal Mevlavi, dr. Isam el Beshir, dr. Muhamed Kemalud-Din Imam. Gjithashtu, Qendra hapi seksione të veçanta për studimin e objektivave të Sheriatit islam në Departamentin e Studimeve pasuniversitare në Kolegjet e Sheriatit, veçanërisht në Marokun Perëndimor.²²

Burimet dhe literatura:

1. Muhamed ibën Hasen el Hagjevij eth Thealebij, *El Fikru es Sami*, Bejrut, Darul Kutub el Ilmiye, 1995, vëll. I, f. 57.
2. Ahmed Rrejsun, *Nedharijetul Mekasidi inde el Imam esh Shatibij*, Virginia U.S.A, El Ma’hedu lilfikri el Islamiy, 1995, botimi i katërt, f. 7.
3. Et Tahir ibën Ashuri, *Mekasidush Sheria el Islamiye*, Jordan, Daru en Nefais, 2000, f.51.
4. Ibrahim ibën Musa esh Shatibij, *El Muvafekat*, rec. Abdulla Dirraz, Kajro, Darul Hadith, 2006, vëll. I, f. 262.

5. Ibrahim ibën Musa esh Shatibij, *El Muvafekat*, rec. Abdulla Dirraz, Kajro, Darul Hadith, 2006, vëll. II, f. 262.
6. Vehbe Zuhejli, *Usul el Fikh el Islamiy*, Damask, Darul Fikr, 2010, botimi i tetëmbëdhjetë, f. 299-302.
7. Alevij es Sekaf, *Enciklopedia online e hadithit*, Ed Duraru es Senije, në: <https://dorar.net/hadith/sharh/13456>, (parë për herë të fundit më 20.07.2024).
8. Edab Nebevije fi el Isti’dhan, në: <https://www.islamweb.net/ar/article/> (parë për herë të fundit më 20.08.2024).
9. Transmeton Ibën Hazmi, në “*Muahla*” nga Xhabir ibën Abdullahu r.a..
10. Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi nga Aisheja r.a..
11. Për ixhtihadatet e sahabëve shih: Fikret Karcic, “*Historia e së Drejtës së Sheriatit*”, Prizren, 1994, n.d përktheu: Zaim Qafleshi, f. 41.
12. Alevij es Sekaf, *Enciklopedia online e hadithit*, Ed Duraru es Senije, në: <https://dorar.net/hadith/sharh/126915> (parë për herë të fundit më 20.08.2024).
13. Ahmed Zaki Jemani, *Mekasidush Sheria el Islamiye Dirasat fi Kadaja el Menheg ve Megjelat et Tatbik*, Londër, Merkez Dirasat Mekasid Sheria Islamiye, 2006, botimi i parë, f. 20.
14. Jasir Auda, *Mekasidush Sheria Delilul Mubtediin*, Londër El Ma’hed el Alemij Lil fikri el Islamiy, botimi i parë, 2011, f.36.
15. Jasir Auda, *Mekasidush Sheria Delilul Mubtediin*, Londër, El Ma’hed el Alemij Lil fikri el Islamiy, botimi i parë, 2011, f.37.
16. Abdul Aziz Rexhep, 2015, “*Tarihu Nesh’etu Mekasidush Sheria ve Tetavuruha*”, në: <https://www.alukah.net/sharia/>, (parë për herë të fundit më 20.09.2024).
17. Jasir Auda, *Mekasidush Sheria Delilul Mubtediin*, Londër, El Ma’hed el Alemij Lilfikri elIslamiy, botimi i parë 2011, f.45-54.
18. Ndërroi jetë më 26 shtator 2022.
19. Abdul Aziz Rexhep, 2015, “*Tarihu Nesh’etu Mekasidush Sheria ve Tetavuruha*”, në: <https://www.alukah.net/sharia/>, (parë për herë të fundit më 20.08.2024).

Ringjallja e zërit përbashkues shqiptar në epokën e zhurmave përçarëse

NJË BOTË E TRAZUAR

Nuredin Nazarko

Natyrë njerëzore përmban brenda saj si farën e mirësisë ashtu edhe atë të ligësisë. Njeriu bëhet ajo çfarë mbjell familja në shpirtin e tij, ajo çfarë ai zgjedh të kultivojë në zemrën e tij kur arrin moshën për të ndarë qartë gjërat mes së mirës dhe së keqes, mes drejtësisë dhe padrejtësisë, mes së bukurës dhe së shëmtuarës. Jo të gjithë rrahin të mbjellin dhe ushqejnë farën e mirësisë. Prandaj shoqëria njerëzore historikisht ka ndërtuar historinë e saj mbi sipërfaqen e tokës mes përplasjesh e konfliktesh mes dy botëve, botës së virtyteve dhe botës së ligësisë.

Njeriu gjen një botë që në aspektin natyror nuk ka çfarë të shtojë e as çfarë të heqë, ndërsa në realitetin jetësor ku i duhet të shfaqë vetveten, ka çfarë të marrë e çfarë të japë. Nëse njeriu do të ndiqte virtytet, paqja me veten dhe paqja sociale, do të ishin lehtësisht të arritshme. Shumica jo se nuk i njohin virtytet, por duan të zbresin në mejdanin e jetës përmes rrugësh të shkurtra dhe të ngjiten në lartësitë e saj me pasurime të shpejta. Që të ndodhë kjo do të shkelen kufijtë e së drejtës pa as më të voglin dyshim. Trazimet e brendshme të njeriut, thyerja përballë ligësisë dhe mungesa e virtyteve e

Njeriu bëhet ajo çfarë mbjell familja në shpirtin e tij, ajo çfarë ai zgjedh të kultivojë në zemrën e tij kur arrin moshën për të ndarë qartë gjërat mes së mirës dhe së keqes, mes drejtësisë dhe padrejtësisë, mes së bukurës dhe së shëmtuarës.

bëjnë botën të jetë e trazuar. Dhe në një botë të trazuar, njeriu apo dhe shoqëritë njerëzore që duan virtytet, duhet të jenë në lartësinë e duhur për të sfiduar ligësinë që endet brenda tij apo dhe saj.

NDRYSHUESHMËRIA, LIGJ NATYROR I SHOQËRISË NJERËZORE

Njerëzit ëndërrojnë një shoqëri të barabartë, ku të gjithë të japin e të marrin në paqe, pa grindje, pa inate, pa mëri, pa konflikte, pa luftëra. Të ëndërrosh nuk është keq, por të realizosh ëndrrat duhet të ngrihesh e të punosh. Duhet përpjekje e vazhdueshme dhe durim për të ndërtuar një botë paqësore. Por para se kjo botë të ndërtohet së jashtmi, duhet të ndërtohet së brendshmi.

Njerëzit edhe pse ndajnë të njëjtat sfida, nuk ndajnë të njëjtin perceptim për të reaguar ndaj sfidave, nuk ndajnë të njëjtin mendim mbi mënyrën e të jetuarit, nuk ndajnë të njëjtat vlera për të vendosur në binarët e zgjidhjes problemet që shqetësojnë shoqërinë. Përtej dëshirave që ka njeriu, shoqëria e barabartë dhe paqësore në kushtet tokësore është utopi. Sistemet politike që provuan të



ndërtojnë një shoqëri të tillë përfunduan në dhunë dhe krime kundër njeriut dhe kundër njerëzimit. Ajo që mund të ekzistojë teorikisht për një shoqëri të barabartë praktikisht u pagua me çmim të rëndë për t'u vërtetuar. Ndryshueshmëria mes njerëzve dhe popujve është një realitet që nuk duhet zhbërë. Duhet pranuar ky ligj i natyrshmërisë njerëzore dhe ndryshueshmëria duhet të shërbejë për të ngritur e forcuar urat e bashkëpunimit ndërmjet njerëzve dhe popujve. Pa tolerancë dhe bashkëpunim në bindje ndaj vlerave më të larta që i duhen shoqërisë njerëzore, popujt do ta kenë të vështirë të bashkëpunojnë në të mirë të njerëzimit.

“DIVIDE ET IMPERA”

Në këtë terren të paqëndrueshëm e në trazim të vazhdueshëm gjejnë hapësirë veprimi ide, mendime, ideologji që ushqejnë ndasitë mes njerëzve, duke i dhënë krah urrejtjes, inateve dhe rivaliteteve mes njerëzve dhe popujve. Jo të gjithë njerëzit ndajnë të njëjtin raport me virtytet në jetën e tyre. Jo të gjithë ata që drejtojnë e udhëheqin popujt ndajnë të njëjtin raport me përpjekjet për të qeverisur drejt dhe në shërbim të së mirës. Shumëkujt që arrin të dalë në krye të qeverisjes së punëve të një vendi më shumë i intereson sundimi dhe kohëzgjatja e tij sesa qeverisja në shërbim të popullit.

Intrigantët, djallëzorët, manipulatorët që nuk e kanë për gjë të përdorin veshjen me virtyte, ide, mendime, teori që në dukje i japin zgjidhje të mira shoqërisë janë gjithmonë aktivë dhe nuk lënë rast pa shfrytëzuar për të dalë si heronjtë e kohës kur jetojnë. Nëse arrijnë të bindin popullin t'i votëbesojë dhe çuditërisht në shumë raste ia dalin të hipnotizojnë mendjet e njerëzve me turli lloj makinacionesh e dredhia, atëherë vënë në jetë rregullin e njohur që nga antikiteti, *divide et impera*.

Njerëzit nga vetë natyra kanë kontradikta dhe rivalitete me njëri-tjetrin. Popujt po ashtu. Ky soj udhëheqësish punojnë për të thelluar këto kontradikta. Stisin situata, nxitin debate, hedhin në qarkullim ide e mendime pa kurrfarë peshe e vlere për të devijuar vëmendjen e njerëzve drejt diskutimeve pa

vlerë, e ndërkohë nën rrogoz, vazhdojnë të punojnë për të zgjatur sundimin. Një popull i përndarë nga urrejtja mbi baza krahinore, racore, fetare, ideologjike, politike është një pre e lehtë jo vetëm për udhëheqësit manipulues, por edhe në konfliktet që mund të ndodhin me popuj të ndryshëm, pasi ka edhe shtete që duan të shtrihen e zgjerohen në kurriz të popujve të tjerë, siç e dëshmon dhe historia. Kështu thellimi i përçarjes nuk i shërben popujve, por interesave të ngushta të klikave që në emër të zbatimit të kontratës sociale uzurpojnë pushtetin dhe e përdorin për të përmbushur interesa të caktuara personale apo edhe më gjerë.

ÇFARË I NDAN SHQIPTARËT?

Ndryshimet nga një krahinë në tjetrën, nga një qytet në tjetrin, nga një fshat në tjetrin, në besimet fetare, në formimin kulturor, janë më se natyrale. Në rrjedhën e historisë janë konfiguruar tiparet specifike të tyre, është krijuar bazamenti kulturor, historik, etnografik, që ka ushtruar dhe ushtron ndikim në variacione të ndryshme në mënyrën e të jetuarit. Shumëllojshmëria është pasuri që duhet vlerësuar dhe duhet ruajtur për ta trashëguar te brezat që vijnë. Shkëputja e vijës historike të zhvillimit të shqiptarëve nuk duhet lejuar të thellohet, paçka se përgjatë periudhës së pavarësisë, e veçanërisht gjatë regjimit komunist, pati përpjekje për të thyer vijën e traditës historike të zhvillimeve ndër shqiptarë në emër të ndërtimit të botës së re komuniste.

Shqiptarët i ndau politikisht pazari mes fqinjëve ballkanikë dhe Fuqive të Mëdha më 1913, pas luftërave ballkanike. Ndarja nuk ishte vetëm politike, sepse rrugëtimi i shqiptarëve në hapësirën ballkanike do të merrte udhën e zhvillimit të shteteve, pjesë e të cilave u bënë tashmë. Vendosija e regjimit komunist në Shqipëri dhe izolimi i vazhdueshëm i saj ndërpreu kontaktet dhe shkëmbimet e shqiptarëve me njëri-tjetrit në hapësirën ballkanike për gati 47 vjet. Dallimet e shqiptarëve me njëri-tjetrit janë përpjekur t'i fryjnë, t'i zmadhojnë e t'i përdorin për interesat e tyre shtetet që nuk duan të shohin një Shqipëri të fortë, të zhvilluar në të gjitha

Ata që nuk i duan shqiptarët janë munduar e mundohen të përdorin dallimet fetare mes tyre për të sjellë përçarje e konflikte, por të urtët e të mençurit mes shqiptarëve ia kanë dalë të qëndrojnë vëllazërisht përkrah njëri-tjetrit, edhe pse njëri mysliman e tjetri i krishterë, edhe pse njëri toskë e tjetri gegë.

ÇFARË I BASHKON SHQIPTARËT?

Çfarë i bashkon shqiptarët është shumë më tepër nga ajo çfarë mendohet se i ndan. Shqiptarët i bashkon gjuha, historia, tradita, sakrifica ndër shekuj mes tri perandorive të mëdha e pushtimeve të fqinjëve, besimet fetare që i kanë dhënë kombit shqiptar emra të njohur klerikësh që kanë kontribut të paçmuar me veprimtari në dobi të çështjes kombëtare.

Ata që nuk i duan shqiptarët janë munduar e mundohen të përdorin dallimet fetare mes tyre për të sjellë përçarje e konflikte, por të urtët e të mençurit mes shqiptarëve ia kanë dalë të qëndrojnë vëllazërisht përkrah njëri-tjetrit, edhe pse njëri mysliman e tjetri i krishterë, edhe pse njëri toskë e tjetri gegë. Etërit e kombit shqiptar, rilindësit e mëdhenj e kanë trasuar rrugën e bashkimit dhe bashkëpunimit ndërmjet

drejtimet, që nuk e duan ngritjen dhe fuqizimin kulturor të elementit shqiptar në Ballkan.

Në sinkron me këta janë dhe arrivistët në mesin e vetë shqiptarëve, që për interesat e tyre personale janë gati të shtrojnë kurrizin e të shiten me gjithçka, duke u bërë prag e portë ku shkelin ata që nuk na duan të ndriçuar e të zhvilluar. Nuk duhet harruar se kemi edhe shumë syresh që me fjalë na dalin heronj, e në vetminë e tyre fërkojnë duart kur punët e shqiptarëve nuk shkojnë mbroth. Syresh të tjerë na dalin më katolikë se papa dhe mbrojnë me patos idenë se shqiptarët do jenë më mirë e më të zhvilluar vetëm duke braktisur traditat e tyre dhe duke u modernizuar gjithmonë e më tepër, duke harruar ose bërë gjoja se kemi pasur tradita shumë të mira në shumë çështje jetësore e kombëtare dhe nuk kemi pse t'i hedhim poshtë me justifikimin e modernizmit. Të ndryshojmë atë çfarë duhet ndryshuar, duke vlerësuar çdo gjë nën optikën e principeve më të larta dhe interesave kombëtare.

shqiptarëve mes shumë vështirësive. Nuk ka arsye që ajo rrugë të braktiset e as të konsiderohet e pavlerë.

Uji fle e hasmi nuk fle, na thotë proverbi. Prandaj shqiptarët nuk duhet të flenë e as të tregohen të shkujdesur paçka se në ditët e sotme gjithmonë e më shumë po vendoset theksi te mirëqenia personale, duke lënë mënjanë atë të përgjithshme. Kjo shkujdesje ndaj së mirës së përgjithshme shkon në të njëjtën linjë me interesin themelor të atyre që nuk e duan të mirën e shqiptarëve. Nuk duhet të tregohen të shkujdesur ndaj atyre që nuk lënë gur pa lëvizur që shqiptarin ta nxjerrin të pagdhundur e arrogant, pa besë e pa burrn, pa vlera e qytetari, pa dije e pa shkencë. Kundërvëniet duhet të shërbejnë si gjurmë reflektimi.

Shqiptarët nuk duhet të lënë mënjanë njohjen e historisë së tyre me të mirat dhe gabimet e saj, sepse shqiptarët nuk janë imunë ndaj gabimeve. Të njohin historinë e të nxjerrin mësim nga gabimet e së shkuarës. Të njohin dhe çmojnë veprat e figurave të mëdha të kombit. Të njohin dhe analizojnë edhe veprën e atyre që për interesa meskinë kanë çuar ujë në mullirin e atyre që nuk e duan shqiptarin të ndriçuar nga mendja e të zhvilluar nga ekonomia.

Familja shqiptare të kultivojë principet e virtytet në shpirtin e brezave të rinj, që edhe nëse këta të rinj e të reja bëhen pjesë e diasporës, të mos harrojnë t'i shërbejnë vendit të tyre. Pa bashkëpunim serioz dhe me drejtësi mes vetë shqiptarëve nuk ka se si të rregullohet e përmirësohet gjendja e tyre. Kjo nuk arrihet duke qenë secili qeveri më vete, por duke dialoguar, duke fuqizuar arsimin mbi baza të dashurisë ndaj kombit, duke investuar në zhvillimin kulturor, ruajtjen e paqes dhe bashkëpunimit mes njëri-tjetrit pavarësisht se përkatësia fetare është e ndryshme, edhe pse intrigantët duan të shprishin në dëm të interesave të shqiptarëve.

Datat përkujtimore të ngjarjeve me rëndësi kombëtare nuk duhet të jenë vetëm shkaqe festimesh e fjalimesh të lodhura ndër vite. Duhet të jenë data ku të reflektohet thellë mbi ato gjëra që na bashkojnë dhe duke menduar se sa shumë na duan të dobët e të pazhvilluar, të ngrihemi e të punojmë për të kundërtën, gjithsecili sipas mundësisë.

Koha e ka treguar se kush punon për varfërimin e shqiptarëve në aspektin politik, ekonomik e kulturor (shpirtëror) është kundra kombit shqiptar, paçka se mund të flasë shqip pastër e bukur. Kushdo që punon për ngritjen kulturore (shpirtërore), ekonomike e politike të shqiptarëve është mëmëdhjetari që i duhet jo vetëm periudhës kohore që po jetojmë.

Shqiptarët duhet të jenë syçelë e të bashkuar në këtë pikë që të dallojnë qartë se kush është për t'u vlerësuar e ngritur lart në qeverimin e punëve, e kush është për ta dërguar në koshin e historisë.

“Mikro-shteti” bektashi dhe paradokset shqiptare

Hajrudin S. Muja

Po jetojmë në një shoqëri të egër, ku secili “bluan” gjithçka nën tuelën e “shqiptarisë”, me të cilën gojën e kanë plot, por njohin vetëm një ngjyrë, atë të parasë, kur përfitimi material bëhet synim “madhor” i të gjithëve, kur renditja e atyre letrave të quajtura ‘para’ bëhet jetike, kur të gjitha veseve të këqija u japim “emra të bukur” dhe ku gjithçka shkon drejt degradimit, sa nuk ka mbetur hapësirë as për t’u çuditur. Është një skotë shqiptarësh që tregon anekdota e Konicës, se kur e pyetën një herë shqiptarin: “a do të shkosh në ferr?” ai i pyeti: “sa është rroga atje?”! Ai e kuptonte armikun e jashtëm dhe të brendshëm, por ishte i bindur se ky i dyti është shumë më i rrezikshëm dhe më i keq se i pari. Urtësia popullore na ka mësuar se “i mençuri mëson prej gabimeve të tjerëve, kurse budallai prej gabimeve të veta”. Ne e kemi provuar vetë, dje ishim më të varfër, sot kemi arritur një standard më të mirë, por jemi më të palumtur se dje. Siç

e ka thënë aktori amerikan Morgan Freeman: “Paraja në vetvete nuk është e ligë, është një letër e thjeshtë me një vlerë për ta përdorur për gjërat që na nevojiten, e ligë është dëshira e pandashme që të kemi përherë më shumë, dëshira për të vendosur një çmim për zemrën dhe shpirtin”.

Por, çfarë vlere ka jeta, nëse gjithë mundin ia drejton mbledhjes së pasurisë dhe nuk bën asnjë përpjekje për lartësimin e bukurisë, mëshirës dhe dashurisë në të?! Çfarë të duhet fama kur shpirtin e ke të ngushtë? Çfarë dobie të sjell tërë bota, nëse vetë je i shqetësuar dhe i mërzitur? Çfarë vlere ka pasuria me fytyrë të mrrolur? Ç’të duhet një grua e bukur nëse jetën ta bën ferr? Çfarë është atdhedashuria nëse e donë vetëm kur është i lirë, i begatshëm, i madh, i fuqishëm? Atdhedashuria është ndjenjë që sendërtohet në luftë për ta çliruar, në punë për ta ndërtuar dhe në krenari për ta nderuar. Atdheu kërkon prind dhe mësues, që i edukojnë fëmijët në format më të mira të mundshme, administratorë që me ndërgjegje i kryejnë shërbimet qytetare, politikanë që i shërbejnë popullit që përfaqësojnë, tregtarë e biznesmenë që synojnë zhvillimin ekonomik të vendit, gazetarë që mbrojnë vlerat e popullit që i takojnë, policë dhe ushtarë që e mbrojnë atdheun me dinjitetin më të mundshëm, teologë që punojnë për vetëdijesimin e shoqërisë, që i lidhin njerëzit me besimin dhe atdheun e tyre, që u shpjegojnë rëndësinë e atdheut e besimit, ruajtjen e tij dhe kultivimin e vlerave, sepse: “pa një atdhe të lirë feja nuk mbahet, nuk mund të ushtrohet”.

Mendimtari, filozofi, shkrimtari dhe kompozitori Gjenevan Jean-Jacques Rousseau (1712-1778), ka shprehur një mendim që i përshtatet të gjitha kohërave: “Nuk mund të ketë atdhetarizëm pa liri, liri pa virtyt, virtyt pa qytetar. Krijoni qytetarinë dhe keni çdo gjë që u nevojitet, pa atë ju nuk keni asgjë, përveçse skllëvër nga sundimtari e deri poshtë”. Nuk



Kanë harruar të shkretët se atdhedashuri nuk donë të thotë të urresh “të tjerët”, por të duash vendin tënd, dhe vendin tënd nuk mund ta duash nëse nuk i do pjesëtarët e tij. Kanë harruar se kushti i parë për të qenë “kombëtarë” dhe “atdhetarë” i mirë është të ruash gjuhën nga ofendimet ndaj pjesëtarëve të bashkëkombeve të tu, edhe në rastin kur ato janë myslimanë.

mbetet shumë për t'u diskutuar, një brez që ia kthen shpinën historisë së vet, që nuk i njeh dhe i fyen udhëzuesit shpirtërorë, që tregohet mosmirënjohës ndaj trashëgimisë së tij kulturore e historike, që i shpallë tradhtarët ‘heronj’ dhe ‘heronjtë’ tradhtarë të së kaluarës, atdhedashurinë e ka të falimentuar dhe e ardhmja e tij bëhet e errët dhe e frikshme. E frikshme është humbja e shijes kur e hidhura të duket e ëmbël, ndërsa e ëmbla e hidhur dhe kur e bukura të duket e shëmtuar dhe e shëmtuara e bukur. A nuk jemi bërë një shoqëri me vese të shthurura, të cilat po e rrokullisin njerëzimin me shpejtësi drejtë fundosjes?!

Ç’janë këta paragjykitime boshe dhe kjo mungesë intelektit që vazhdimisht përsëritin të njëjtat gënjeshtër antishqiptare me afat të skaduar, të prodhuara nga disa klerikë inkuizicionistë, se myslimanët në Shqipëri janë “turq” e “arab”, për shkak të besimit të tyre?! Çfarë guximi i marrë është të mohosh shtatëdhjetë përqindëshin e kombit tënd dhe të pretendosh sa shumë të dhemb zemra për “atdhetarizëm” e për “shqiptari”?! Për ata që e kanë tru, “Feja e shqiptarit është shqiptaria” në kohën tonë është paradoksi më i madh i shqiptarëve, e gabuar dhe e pakuptimtë në thelb, i kotë në konstatim, i kotë në përgjigje, i kotë në argument. Cili komb tjetër në botë ka një kotësi të tillë?!

Është mungesa e besimit në Zotin që ka sjellë “besimin në shqiptari”, që nënkupton se “shqiptarinë” e konsiderojnë si fe dhe ky është primitivizëm me mungesë intelektit, si ato që e mbajnë lopën për zot. Ne ende nuk po kuptojmë çfarë teorish, sistemesh, ideologjish e filozofish po na sjellin, kush po na i sjell dhe për çka. Ende nuk po kuptojmë se feja në thelb është paqe dhe nuk ka asnjë arsye të thuhet se popujt e tjerë kanë bërë luftëra fetare mes tyre, luftërat i kanë bërë njerëzit e pushtetshëm duke manipuluar turma besimtarësh të thjeshtë. Kanë harruar të shkretët se atdhedashuri nuk donë të thotë të urresh “të tjerët”, por të duash vendin tënd, dhe vendin tënd nuk mund ta duash nëse nuk i do pjesëtarët e tij. Kanë harruar se kushti i parë për të qenë “kombëtarë” dhe “atdhetarë” i mirë është të ruash gjuhën nga ofendimet ndaj pjesëtarëve të bashkëkombeve të tu, edhe në rastin kur ato janë myslimanë. Për më tepër, ata nuk kanë si ta dinë, sepse kurrë nuk e kanë mësuar që atdhedashuria dhe fitimi i lirisë, mbrojtja dhe

ruajtja e saj është një ndër parimet bazë dhe nga objektivat themelore të kësaj feje. Jemi ndoshta nga të paktat shtete në Evropë që mund të kemi probleme të vetëdijes kombëtare dhe të “kacafytjes nacionaliste” për të bindur njerëz tanë, bashkatdhetarë se na përkasin “neve” dhe jo “të tjerëve”.

Këta të “Lëvizjes së Deçanit” dhe “Lëvizjes për braktisjen e fesë islame”, të cilët po tentojnë të realizojnë në përpikëri projektin famëkeq të Vasa Çubriloviqit, duke pretenduar se janë të motivuar nga atdhedashuria, ku e kanë mësuar vallë se mund të ketë atdhedashuri me mobilizime dhe fyerje mbi baza të një feje kundër fesë tjetër? ! Janë të njohura deklaratat e Slllobodan Millosheviqit se: “Ne jemi gati të flijojmë 300.000 luftëtarë serbë për të shkukur Islamin nga Sarajeva në Mekë”. Njëjtë pretendonte edhe M. Gavriloviç: “Çdo mysliman është armik natyrorë i të krishterit”. Krimineli Radovan Karaxhiq thoshte: “Islami duhet të eliminohet nga Evropa”, natyrisht duke marrë këshillën e Dobrica Qosiqit se: “Islami është armiku më i madh...”. Ndoshta të njëjtën këshillë ka përdorur edhe Dom Anton Kçira: “Asht dashtë Millosheviçi sikurse i ka rrjepë në Srebernicë 260 mijë qej, m’i pas rrjepë edhe në Kosovë 1.900.000 qej, besoni kurgja nuk kish ba ma zi”. Ose prifti Dom Ndoc Noga, se: “Gjaku i pastër i krishterë shqiptar ka degraduar tek ata që kanë përqafuar fenë islame”. Mendësi të tilla kanë frymëzuar edhe priftin Dom Zef Mirdita të deklarojë disa vite më parë: “Islamizimi i çoi shqiptarët në udhë të gabueshme... Kombi shqiptar duhet të dëliret nga islamizmi, me qëllim të rilindjes dhe të kthimit në Evropë”. Natyrisht këta që flasin shqip do të na thonë pastaj se ne nuk duhet të ofendohemi, se ato nuk kanë asgjë kundër besimit të shqiptarëve myslimanë, ne mund të mos e dimë qëllimin e tyre, por i kuptojmë shumë mirë nga deklaratat që japin. Nuk të dhimbën hipokritët, por ata të cilët duke mos ua kuptuar qëllimet, nuk ndahen prej tyre me shpresë se një ditë do të bëhet mirë.

Ngjarja e fundit e hapjes së Xhamisë së Madhe të Tiranës dhe ideja fillestare për emërimin e një “imami turk”, tërboi islamo-fobët e rrjeteve sociale dhe debateve televizive se çfarë tragjedie po përjetojnë shqiptarët nga “këta aziatikë”. Standarde të dyfishta, nuk u dëgjua as një zë i vetëm për të gjithë këto vite që të huajt po drejtojnë kishat shqiptare, si maltezi George Frendo (ipeshkëv i Tiranës),

italiani Ottavio Vitale (ipeshkëv i Lezhës), italiani Angelo Massafra (ipeshkëv i Shkodrës), greku Anastas Jonullatos (kreu i kishës ortodokse shqiptare), greku Nathaniel Stergiu dhe Dhilitri Sinaiti (metropolit të Gjirokastrës), francezi Jean Marie Spelch (apostulli delegat i Kosovës), greku Ignati Trianti (metropolit i Beratit), etj..

Përrallat për “terrorizmat” dhe “ekstremizmat” islamikë të shqiptarët, janë përralla serbe që synojnë strategjinë e ndezjes së zjarrit dhe nxitjes të çekuilibreimeve fetare, që u shërbejnë më së miri interesave antishqiptare. Historia na mëson për plot përpjekje të tilla. Në këtë kontekst, është e natyrshme që atyre t’u pengonte “islamiku” i shqiptarëve për të gëlltitur tokat e tyre, por nuk po marr vesh çka u duhet ky “islamiku” “intelektualëve” shqiptarë, nëse nuk janë në shërbimin e këtyre të parëve?! Fatkeqësisht shqiptarët e kanë dëshmuar shpesh për “argatllëkun” që u kanë bërë të huajve, përfshirë edhe Serbisë. Nuk ka më keq se të qëndrosh i sëmure përkundër pranisë së mjekut më të mirë dhe barnave më shëruese në atë mjedis. Çdo fenomen shkak-pasojë që nuk çon në vetëdijesim është i destinuar të përfundojë në humbje. E kanë fobi Islamit për shkak se është e vetmja fe që lidhi shpirtëroren me materialen dhe që e konsideron njeriun udhëheqës në tokë, zotëri dhe jo të nënçmuar, kërkon nga njeriu të jetë njeri dhe jo kafshë.

Natyrisht, të drejtën e përzgjedhjes së besimit e kanë të lirë, por përse kërkojnë të ma ndalojnë mua atë që u lejojnë vetes së tyre? Feja e të parëve të mi nuk është krishterimi dhe as paganizmi, sepse të parët e mi janë babai, gjyshi e stërgjyshi im dhe ata për fe zgjodhën Islamit dhe unë pikërisht fenë e të parëve të mi po mbajë dhe ndihem komod me këtë, por nuk mohoj dhe nuk urrej askënd që nuk është pjesë e kësaj feje ose që është divorcuar prej kësaj, thjesht më vjen keq për të. Dhe tani, sapo u doli boja skifterëve të “Lëvizjes së Deçanit”, duket se “stafetën” ua dorëzuan “lëvizjes” për mikro-shtetin bektashian, një nivel pak më i lartë nën kreun e qeverisë, që i lë mundësi hapjes së një rruge për përpjekje të formimit të një njësie teokratike serbe, që përfshinë Patriarkanen e Pejës dhe Manastirin e Deçanit, por pse jo edhe njësitë të tjera. Çudi, një shtet laik favorizon një sekt pakicë në mesin e shumicës! Kush po i inicion dhe kush po përfiton prej tyre, natyrisht jo shqiptarët. Nuk e di nëse mund të marrim ndonjë mesazh nga takimi paraprak i Baba Mondit me presidentin izraelit, apo deklaratën e tij në faqen e parë të “The Jerusalem Post”, gazetës prestigjioze Izraelite: “Lideri fetar i Shqipërisë: ‘Unë e konsideroj veten vëlla të popullit të Izraelit’”.

Kam lexuar një shkrim të një akademiku perëndimor ku thuhej se: “Deklarata kundër Islamit dhe myslimanëve janë aparati më i përdorur i politikanëve perëndimorë për t’i mbuluar dështimet e tyre”, mos është e njëjta gjë edhe me qeverinë shqiptare?! Mos është kështu edhe me Shqipërinë?! Me mërzi më duhet të citoj fjalën e madhe të Thrang Spiros (Faik Konicës), i cili në numrin e parë të Revistës “Albania” (1898), shkruante: “Nëse ka kush do t’i bëjë keq Shqipërisë, janë vetë shqiptarët”. Njëllor si atëherë edhe sot, të ndarë e të

përçarë, të përçmuar nga njëri-tjetri, i pari s’e do të dytin, i dyti të parin e së bashku s’duan të tjerët. Edhe sot për të gjitha të këqijat që na kanë rënë për hise, askush nuk na ka fajin veç vetë veprave tona. Cila mendje e shëndoshë mund të besojë se gjendja në të cilën jemi katandisur mund të përmirësohet me konvertime fetare apo me themelimin e “mikro-shtetit” bektashian brenda shtetit!? Cila mendje e shëndoshë mund të pretendojë se të mbash anën e agresorit mund të sjellë dobi? Cila mendje e shëndoshë mund të mbrojë mendimin se marrja me këtë lloj “politike”, e cila më shumë ndanë se bashkon, mund t’i zgjojë e t’i vetëdijësojë shqiptarët?!

Në të dy rastet, kjo është një mënyrë që ne ende të ecim “mbrapa kthehu”, që të mos fillohet aty ku duhet filluar! “Lëvizja e Deçanit” dhe “Lëvizje për braktisjen e fesë islame” është gomarllëku më i madh që bëhet në emrin e “shqiptarisë” dhe “atdhetarizmit. Sipas këtyre, vetëm 5% e shqiptarëve në Kosovë janë “shqiptarë”, se myslimanët nuk qenkan. Kjo është logjika e humbur që kalon çdo kufi. Kush ua jep të drejtën të ma kontestojnë “shqiptarinë” time?! Tani dalin të kërkojnë ngritjen e një kryqi 70 metërsh të lartë në Llap dhe me një “katedrale” në Bajgorë, në zona ku ka prezencë minimale të krishterëve, projekte që janë lënë për t’u prezantuar më 28 nëntor. Nuk duhen shumë mend për të kontestuar sa të pamend dhe sa manipulatore janë. Asnjëherë sa sot nuk na ka bashkuar interesi për të fundosur njëri-tjetrin, ndërsa notojmë në llumin e paaftësisë. Kurrë nuk ka qenë më lehtë se

Cila mendje e shëndoshë mund të besojë se gjendja në të cilën jemi katandisur mund të përmirësohet me konvertime fetare apo me themelimin e “mikro-shtetit” bektashian brenda shtetit!? Cila mendje e shëndoshë mund të pretendojë se të mbash anën e agresorit mund të sjellë dobi?



sot mundësia që të manipulohet me popullin, kurrë nuk ka jetuar një shoqëri me kaq shumë shkollë e me kaq pak mend, kurrë nuk ka qenë e sigurt e ardhmja e atyre që nuk janë mbështetë në të kaluarën, kurrë nuk është shkelë dinjiteti në emrin e një populli. Vetëm një gjë dihet, ata që e kanë dinin – dinarë, nuk japin gjë pa interes të madh!

Sa zëra janë dëgjuar kundër dukurive të këqija të kësaj bote shqiptare të mbushur me mite, me korrupsion, me hajni, me shpifje, me mashtrime, me vëllavrasje, me plagjiaturë, me injorancë, me prostitucion, me drogë, me tradhti kombëtare, me elemente reaksionare mediatike, me shkelje traditash, me shkelje nderi dhe me mohime të identitetit të tjetrit. Sa zëra janë dëgjuar kundër këtyre muzikave të zhytura në tekste banale, kundër degjenerimit të “Big Brotherit” dhe këngëtarëve të mashtruar nga lakmia e famës dhe parasë, të cilat jo vetëm që kanë hedhur në muze kostumet tradicionale, por as rrobat tjera nuk i veshin si të ndershme?! Ne mburreshim sa të ashpër ishim kundrejt nderit të bijave, motrave, grave dhe nënave tona në çështjen e moralit, e sot nuk u bën përshtypje lakuriqësia e tyre. Ku është modestia, ku janë lëvizjet dhe politikat që përpiqen për ruajtjen e nderit dhe familjes së shqiptarëve, ku janë përpjekjet për të ndaluar degjenerimin e rinisë? Jeta është ta mbrosh nderin, jo ta shesësh nderin tënd rrugëve. Në cilën traditë bëjnë pjesë këta të rinj që janë bërë brez i Facebook-ut që po shkatërrojnë komunikimin e vërtetë njerëzorë; këta pantollshqyer, këta flokë të oksigjenuara, këta tatuazheve me trajta gaforresh, këto vajza që vrapojnë për t’u rritur dhe këta djem që dalldisen me çdo vajzë që mund të takojnë në rrugë?! Njeriu pa fe është i humbur dhe i devijuar, pa mendje i çorientuar, pa moral i

lajthitur, pa pasuri i mjerë, pa jetë, pra pa lirinë për të nuk mund të paramendohet.

Sa zëra janë dëgjuar për këtë çoroditje gjuhe, për këtë degjenerim të artit të mrekullueshëm dhe zëvendësimin e tij me fjalë të huaja?! A nuk është kjo shenjë e një niveli të ulët kulturor, një kthim mbrapa i të gjitha llojeve e arteve tona, të zhytura në vorbullat e “modernizmit”?! Sa zëra janë ngritur kundër “murtajës së bardhë”, kur dihet mirëfilli i katandisjes së njeriut shqiptar nga përdorimi i tij?! Sa zëra janë ngritur kundër zyrtarëve të cilët natë e ditë po e rrjepin këtë shtet, sepse jetojmë në një vend ku ndershmëria haptazi konsiderohet dobësi. Pse nuk përpiqemi ta mbajmë shoqërinë larg rrugëve që po e shpien rininë tonë deri te porti i saj pa kthim. Pse nuk ka zëra kundër kriminelëve dhe pse nuk demaskohen ata të cilët për t’i realizuar përfitimet e tyre milionëshe, po e vrasin në heshtje shoqërinë shqiptare?

Sot jetojmë në një botë “të qytetëruar” që po përjeton agoninë e vet, ku i madhi i bën padrejtësi të voglit, ku i forti e han të dobëtin, ku secili garon të zhvat sa më shumë pasuritë dhe nderin e të tjerëve, ku mashtrimi dhe padrejtësia kanë goditur keq moralin, ku për askënd nuk është e shtrenjtë jeta e tjetrit, ku më të këqijtë dhe më të poshtrit e mjedisit kanë marrë në dorë frenat e drejtimin e gjithçkaje, ku më parë pushtetarët kujdesen të zbukurojnë shtëpitë e tyre se të ushqejnë dhe të veshin qytetarët e shtetit që sundojnë, ku njerëzit garojnë në peshë dhe argëtime të shfrenuara, ku më parë u ofrohet përkujdesje qenve sesa vetë prindërve. Jemi përballë shtimit të fëmijë të porsalindur e të braktisur, rritjes së numrit të aborteve, korrupsionit brenda institucioneve, profesorëve që kushtëzojnë notën, nxënësve që nuk respektojnë mësimdhënësit, fëmijëve që nuk respektojnë prindërit, rritjes gjithnjë më të madhe të tradhtive bashkëshortore, numri gjithnjë më të madh i divorceve dhe fëmijëve “jetimë”, etj.

Vetëm në televizionet shqiptare shohim të njëjtat fytyra (mendime) “të afta” për politikën, për ekonominë, për kulturën, për fenë, për historinë, për turizmin, për modën, për shkencën, për sportin, etj.?! Vetëm në televizionet shqiptare “analistët” dhe “ekspertët” që ftohen në debate dhe tregojnë injorantin në vend të dijetarit. Vetëm në televizionet shqiptare kemi gazetarë “gjithlogë” që shpjegojnë Islamin dhe nuk turpërohen nga injoranca në të cilën janë zhytur. Debate pas debatesh pa zgjidhur asgjë. Ata nuk kanë, nuk paraqesin dhe nuk u nevojiten bazat shkencore dhe argumentet historike, sepse ata vetëm kanë mësuar të zhvlerësojnë e jo të vlerësojnë në historinë e tyre, skamje psikologjike që zvarritet në qenien e tyre. Të dalldisur pas përrallave të demokracisë perëndimore, na kanë garë veshët me predikime për integritet e për demokracira diku në stratosferë. Janë të kotë dhe të paturpshëm kur dalin haptas kundër viktimës dhe në mbrojtjen e agresorit, dalin haptas në favor të shkatërrimit të familjes, sepse u ka humbur njerëzorja. E ka shpjeguar mirë teologu i famshëm Ibën Kajjim el Xheuzije (1292–1350): “Nëse donë të dish se çfarë ka brenda zemrës së një personi, dëgjo se çka del nga goja e

tij". Nuk do ta harroj kurrë një bisedë që kam pasur me ish-profesorin e Universitetit "Columbia" Richard Knight (tani i ndjerë), kur më tha një herë se: "Injorantët më të mëdhenj sot e kanë të mbaruar së paku një fakultet"!

Kultura dhe tradita fetare, që e kanë mbajtur familjen të shëndetshme dhe e kanë mbrojtur nga ndikimi i kulturave të huaja dhe nga infektimi i dukurive negative, kanë filluar të zbehen dhe sot asaj i kanoset rreziku i shthurjes dhe zvetënimit. Pse bëjmë sikur urrejmë hipokritin kur të tillët na rrethojnë kudo të vemi, madje edhe në veten tonë. Krijuesi na ka dhuruar sy që të shohim e të dallojmë të bardhën nga e zeza, të mirën nga e keqja, të drejtën nga e padrejta, na ka dhuruar zemër të ndjejmë dhimbjen për humbjet, për disfatat, tragjeditë, por edhe ta ndjejmë peshën, ndikimin e vlerën e fjalës së mirë, të butë, lutjen, dashurinë dhe mëshirën. Mbi të gjitha na e ka dhuruar trurin (mendjen), që si krijesat më të përsosura të mund të mendojmë, të mbajmë në mend, të planifikojmë më gjatë e më mirë të gjitha ato që i duam. Ne të gjithë mund të kemi bindje krejt të ndryshme nga kjo, por e vërteta mbetet e vërtetë dhe nuk ndryshon mbi bazën e bindjeve tona. "Kush nuk e njeh historinë është i detyruar ta ribëjë atë" pati shkruar një herë filozofi spanjoll-amerikan George Santayana (1863-1952), filozofi të cilën më pas e përdori edhe shkrimtari Italian Primo Levi (1919-1987): "Të gjithë ata që harrojnë të kaluarën e tyre janë të dënuar ta rijetojnë". Historia nuk është përmbledhje ngjarjesh, por një shkencë e bekuar që na tregon truallin bazë të së vërtetës ose gënjeshtrës, të së drejtës ose të shtrembrës, në mënyrën e jetesës së popujve, të mbushur plot ngjarje të ndryshme, surpriza dhe aventura. E ka thënë latini se "Historia është pasqyra e të ardhmes".

Sot kujtohen me përbuzje kohët kur shqiptarët kanë pasur një fuqi gjigande, kohën kur ata kontribuuan në qeverisjen e një prej shteteve më të mëdhenj të historisë. Autorja amerikane e trillimeve spekulative Ursula Kroeber Le Guin (1929-2018) ka shkruar një herë se: "Nëse një brez që rritet në një mjedis ku dija dënohet dhe mësohet me faktin se injoranca është lumturi, brezi pasardhës as nuk do ta dijë se janë injorantë, sepse nuk do dinë se ç'është dija". Ata duhet të kurohen vetëm kur të kuptojnë nevojën e të kuptuarit, sepse në momentin që mendojnë se dinë, kanë edhe shumë gjëra për të mësuar, për të menduar e për të kuptuar. Ata mund të kenë ose jo një diplomë universitare, një master apo një doktoratë, por nuk kanë asnjë lidhje me "intelektualin", sepse intelektual i është një individ me një shumëllojshmëri specifike të inteligjencës, që është e lidhur në mënyrë rigoroze me arsyen dhe të menduarit.

Me sa mend mund të fajësohet shqiptari për përkatësinë e tij islame, kur ai besim i është bërë entitet jetësor, lartësi e shpirtit mbi trupin, ideal i përjetësuar që inspiron sakrificë për vepra të larta në shërbim të kombit e atdheut. Çfarë guximi i marrë është ky!? Pse nuk ja vëmë gishtin kokës për të parë atë që duket "pa syze", se rrjetet sociale, mbingarkesa informative, të jetuarit e shpejtë, konsumerizmi, paqëndrueshmëria financiare, si dhe çekuilibri i standardeve

dhe normave mund të jenë mënyra më e shpejtë e përshkrimit të realitetit që sot na rrethon. Ky kaos modern nuk rrezikon vetëm fëmijët, por edhe adoleshentët, koha kur ata duke u përgatitur për moshën e rritur përjetojnë ndryshime të mëdha emocionale dhe fizike. Këtë do ta kuptojmë kur të rritemi e kur të zgjohemi, kur ta marrim vesh se të gjithë krerët politikë, krerët fetarë, intelektualë e teologë, shkencëtarë e akademikë, pushtetarë e gazetarë, të gjithë janë në shërbim të "politikave të larta" dhe po luajnë simfoninë e orkestrës së tyre. Jemi ngatërruar keq! Mburremi me atë që do duhej turpëroheshim, turpërohemi nga ajo me të cilën do të duhej të mburreshim! Kurrë nuk ka pasur më shumë libra e kaq të pa ditur, kaq shumë ushqim e kaq të uritur, kaq dashuri e kaq ndarje, kaq dëshirë për jetë e kaq vetëvrasje, kaq lëvdata për të drejta e kaq shkelje të drejtash, kaq lëvizje të shpejta e kaq pak kohë, kaq informatikë të zhvilluar e kaq njerëz të pa informuar.

Njeriu është i krijuar që të dojë disa gjëra dhe të favorizojë më shumë se të tjerat. Ai e do pasurinë, fëmijët, familjen, të afërmit, shokët, dhe në mesin e shumë gjërave të tjera, ai e do edhe vendin e tij që e quan atdhe. Kjo e fundit është instinkt i mbjellë në shpirt, i cili e bën të qetë njeriun kur qëndron në të dhe mallëngjehet për të kur është jashtë dhe larg tij, nëse sulmohet e mbron, nëse përbuzet hidhërohet. Ne duhet shpesh të shikohemi në pasqyrë për të parë veten ku jemi. Shkrimtari, poeti e filozofi libanez, i ndjeri Khalil Gibran ka lënë një thënie shumë të bukur për ta parë imazhin tonë në këtë pasqyrë: "I mjerë është ai popull i cili nuk end atë që veshë, nuk mbjell atë që ha dhe nuk shtrydh atë që e pi. Ai popull që lufton të ligat e veta vetëm në ëndërr, por i nënshtrohet të ligës kur është esëll; Ai popull i cili pret të rebelohet vetëm kur i vije shpata nën gushë; Ai popull, politika e të cilit është dinakëri, filozofia e të cilit është vegim, industria e të cilit është arnim; Ai popull i cili fituesin e pret me fyell dhe tupanë, pastaj i fishkëllen, për ta përshëndetur fituesin tjetër me këngë e buri; Ai popull, i urti i të cilit zë nuk ka, prijësi i të cilit është i verbër, avokati i të cilit është propagator; Ai popull tek i cili çdo fis dëshiron të jetë komb".

Ne duhet të na shërojë e vërteta dhe këtë të vërtetë duhet ta gjejmë në veten tonë. Ne nuk jetojmë vetëm kur jemi gjallë e të lëvizshëm, nëse nuk e kemi botën tonë të brendshme, nëse nuk e njohim veten dhe qëllimin e ekzistencës, nëse nuk jetojmë për të ngrënë por hamë për të jetuar, nëse nuk e kuptojmë "vetë-ekzistencën" tonë si pjesë e kësaj Gjithësie, sepse ekzistenca jonë e ka një arsye, të cilën të mençurit nuk duhet ta nëpërkëmbin e ta shpërfillin. Nëse vërtet i duam të mirën shoqërisë së sotme, me urgjencë i nevojitet një rikthim i menjëhershëm në burimet origjinale shpirtërore të përfaqësuar nga besimi monoteist në një Zot, si burim mëshire dhe bamirësie.

Edukimi i gruas, kusht për avancimin e shoqërisë

Dr. Florentina Tërmkolli

“Kur flitet për gruan dhe emancipimin e saj, të gjithë njerëzit me arsye të shëndoshë pajtohen me faktin se mbi supet e gruas rëndojnë padrejtësi që shtrihen nga kohët e lashta e deri sot në ditët tona.”

Muhamed Amare

Janë shkruar shkrime, artikuj, libra prej më të ndryshmeve rreth gruas, vlerave, pozitës, obligimeve dhe detyrave të saj ndaj vetes, familjes dhe shoqërisë së saj. Po ashtu shkrime pati edhe rreth rolit, dhe pozitës së gruas në shoqëri. Disa nga to e vendosën në vendin e merituar, e disa të tjera e degraduan rolin e saj shumë. Gjithsesi jemi dëshmitarë të shumë padrejtësive dhe parregullsive që iu bën asaj dhe që i bëhen edhe sot e kësaj dite, si në familje, në arsimim, shkollim, punësim etj..

Është thënë bukur nga Muhamed Amare se: “Kur flitet për gruan dhe emancipimin e saj, të gjithë njerëzit me arsye të shëndoshë pajtohen me faktin se mbi supet e gruas rëndojnë padrejtësi që shtrihen nga kohët e lashta e deri sot në ditët tona.”

Gjithashtu, pajtohemi me faktin se tashmë gruaja është shndërruar në një kauzë dhe se emancipimi i saj, edhe pse lidhet me atë të burrit, ka nevojë për më shumë vëmendje dhe për një qasje specifike. Por ajo që ka shkaktuar mosmarrëveshje dhe debate, në nivel ndërkombëtar, është modeli ideal, i cili i mundëson gruas emancipimin e vërtetë. Sot na afrohet modeli perëndimor ekstrem, modeli i lëvizjeve feministe, të cilat duan që gruaja të fokusohet te vetja, duke u rebeluar kundër natyrës së saj femërore me të cilën e ka krijuar Zoti, kundër burrit dhe kundër

vlerave dhe feve. Ky është një model, i cili ka arritur kulmin e ekstremizmit. Ekziston dhe një model tjetër, ai tradicional, ai i izolimit dhe kufizimit, zakonet dhe traditat, e të cilat i janë veshur fesë. Ndërsa kur kthehemi te feja islame, gjejmë një trajtesë të mrekullueshme dhe të veçantë që i është gruas në të gjitha etapat që kalon ajo. Islami nxit dhe inkurajon në mënyrë sistematike leximin, nxënien e dijes dhe ngritjen intelektuale.

DITURIA E DOBISHME, KUSHT PËR ARRITJE, SUKSES DHE EMANCIPIM

Fjala e parë që zbriti nga Zoti ishte “Lexo!”, në mënyrë urdhërore, sepse leximi është një nga komponentët kryesor, që e ngritë lexuesin, e drejton në rrugën e drejtë, e emancipon dhe lartëson atë në një nivel njerëzor të duhur.

Dallimi ndërmjet të diturit dhe paditurit është si nata me ditën, qoftë burrë apo grua. Këtë e dëshmon fjala e Zotit kur thotë: “Thuaj: ‘A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?’” (Zumer, 18). Kjo dëshmon se assesi nuk janë të barabartë të diturit me të paditurit. Gjithashtu Zoti me një ajet tjetër thotë: “Allahu i lartëson ata që besuan prej jush, i lartëson në shkallë të lartë ata të cilëve u është dhënë dituri.” (Muxhadele, 11).

Zoti i ngriti aq shumë njerëzit e dijes, saqë i bëri dëshmitarë të njëshmerisë. I Plotfuqishmi

thotë: “Allahu dëshmon, e po ashtu edhe engjëjt, edhe njerëzit e dijes, se nuk ka zot tjetër që meriton të adhurohet përveç Tij, duke mbajtur drejtësinë. S’ka zot tjetër përveç Atij, të Plotfuqishmit, të Urtit.” (Ali Imran, 18).

I Dërguari i Allahut, Muhamedi a.s., diturinë e bëri farz (obligim) për çdo mysliman, mashkull apo femër qoftë. Fjala është për diturinë e dobishme, sepse dituria e padobishme nuk shpie askund, vetëm se në humbje dhe humnerë. Për këtë Profeti ynë a.s. bëri këtë dua: “O Allah, unë kërkoj mbrojtjen Tënde nga dituria prej së cilës nuk ka dobi!”¹

Allahu xh.sh. nuk i dalloi në Librin e Tij burrat nga gratë kur tha: “Frikën e Zotit e kanë të diturit.” (Fatir, 28). Frika nga Zoti është e lidhur ngushtë me diturinë, ashtu siç dijetarët janë trashëgimtarët e profetëve. Të dyja palët (burra dhe gra) në këtë çështje janë të barabartë. Pra nga kjo që u tha më lartë themi se gruaja nëse nuk është e ditur, e arsimuar dhe e edukuar, atëherë edhe frika ndaj Zotit i mungon, e në këtë rast do të ndodhë prishje, shkatërrim për veten e saj së pari, për familjen, dhe pastaj për shoqërinë ku jeton. Shkollimi i gruas është mburojë për të nga shumë dukuri

Çdo punë
çfarëdo qoftë
ajo është më e
lehtë sesa
amësia. Kur
gruaja kryen
këtë mision në
mënyrë të
përsosur, çdo
përgjegjësi dhe
punë tjetër
është më e
lehtë dhe me
më pak e
ndjeshme...

negative, si nënçmimi, padrejtësia, dhuna, frika e panevojshme.

DITURIA E DOBISHME E GRUAS, KUSHT PËR NJË FAMILJE TË SHËNDOSH DHE TË LUMTUR

Çdo punë çfarëdo qoftë ajo është më e lehtë sesa amësia. Kur gruaja kryen këtë mision në mënyrë të përsosur, çdo përgjegjësi dhe punë tjetër është më e lehtë dhe me më pak e ndjeshme sesa kjo e amësisë, kështu që nënkuptohet se punët e tjera do t’i kryejë me plotë lehtësi dhe përpikëri.

Gruaja, kjo qenie të cilën Zoti e ka krijuar për të qenë mbi të gjitha nënë. Ajo bartë në brendësinë e saj një krijesë që frymon, ushqehet me gjakun e nënës së tij, e bartë lodhje pas lodhje, mundim pas mundimi, bile edhe jetën e saj e rrezikon vetëm e vetëm që ajo të vije në këtë botë shëndosh e mirë. Kurani famëlartë bukur e përshkruan kur thotë: “Nëna e vet e bartë atë mund pas mundi.” (Llukman, 14).

Lindja e fëmijës, përkujdesja ndaj tij në shumë aspekte, si në atë shëndetësor, edukativ, moral, akademik është puna më madhore,





dhe obligimi më i rëndë, të cilin nuk mund ta kryej vetëm se një nënë e suksesshme, e edukuar e arsimuar. Nuk mund ta kryejë këtë obligim as edhe burri më perfekt mbi faqen e dheut. Edhe nëse mundohet dhe e bën të pamundurën prapëseprapë ndjesinë, mëshirën, kujdesin, dashurinë e nënës nuk mund ta dhurojë askush përveç saj.

T'i falësh fëmijës dashuri, dhembshuri, ngrohtësi dhe mëshirë gjatë gjithë këtij procesi të gjatë, të vështirë dhe sflitës, është një mrekulli që vetëm gratë nëna mund ta bëjnë. Mu për këtë gjë, Zoti i drejtohet fëmijëve se ky mund do mirënjohje dhe falënderim duke ju thënë: *"Të jesh mirënjohës ndaj Meje dhe ndaj dy prindërve tu."* (Llukman, 14). Pra Zoti e veçoi gruan me këtë pozitë dhe këtë privilegj që nuk ia dha askujt përveç saj.

Ndjesia e gruas, nënës, përcillet, ecën në jetën e pjesëtarëve të familjes. Kur gruaja është e lumtur e gjithë familja janë të lumtur, ashtu siç kur ajo është e sëmurë, e tërë familja janë të sëmurë. Vetitë, cilësitë, karakteri i saj ndikojnë në formimin e familjes, qoftë në edukatë, sjellje, arritje, sukses etj., e që i bie se bërthama kryesore e familjes dhe më rëndësishmja është gruaja.

**T'i falësh
fëmijës
dashuri,
dhembshuri,
ngrohtësi dhe
mëshirë gjatë
gjithë këtij
procesi të
gjatë, të
vështirë dhe
sflitës, është
një mrekulli që
vetëm gratë
nëna mund ta
bëjnë.**

DITURIA E DOBISHME E GRUAS, KUSHT PËR NJË SHOQËRI TË STABILIZUAR DHE EKUILIBRUAR

Edukimi i shoqërisë duhet të bëhet përmes edukimit familjar, detyrë që tradicionalisht u besohet grave, nënave. Ato (gratë) përkufizohen si një brez që transmetojnë ndryshimet më të thella shoqërore.²

Prandaj, edukimi i gruas duhej të kishte një premisë për të drejtat e grave, sepse e ardhmja e kombeve varet nga gruaja, nga emancipimi i tyre. Roli i nënës që i është caktuar gruas është themelor, sepse asaj i është besuar detyra e formimit të brezave të së ardhmes.³ Shembuj të shumtë dokumentojnë se edukimi i gruas është kushti kryesor për ngritjen dhe zhvillimin e shoqërive. Sikur mos të ishin gra të ditura dhe të fuqishme në kohën e lindjes së Islamit, do t'i duhej njerëzimit një mund shumë i madh të arrijë tek ajo pjesë, ndoshta edhe nuk do të arrinte fare.

Shembulli i nënës së besimtarëve, Hatixhes, Zoti qoftë i kënaqur me të. Sikur mos të ishte një grua e edukuar, e emancipuar dhe e ngritur, nuk do të kishte shoqëria islame burra të cilët e flijuan veten e tyre vetëm e vetëm që të ngritët lart fjala e Zotit.

Pastaj kemi Esmën, bijën e Ebu Bekrit, e cila e mbështeti një çështje shumë delikate, po ashtu tejet e rëndësishme. Asaj iu besua sekreti i migrimit të profetit Muhamed a.s. nga Meka në Medine, gjë e cila ishte një ndër ndryshimet më të rrezikshme të thirrjes islame, shtetit dhe ymetit islam. Ajo ishte pjesëmarrëse në këtë ngjarje të rëndësishme dhe e kreu këtë detyrë në mënyrë precize dhe të shkëlqyer.

Po ashtu kemi edhe një grua të veçantë, e ajo është Aisheja, vajza e Ebu Bekrit. Edhe ajo ishte fryt i modelit të këtij emancipimi islam të gruas. Paralelisht me të qenët bashkëshorte e dashur dhe e dhembshur, ajo ka transmetuar një pjesë shumë të madhe të thënieve profetike, njihte shumë mirë ligjin islam, debatonte me njerëzit më të ditur, kishte shije artistike. Kemi shembuj të mrekullueshëm të tjerë, sikurse Hafsa, bija e Omerit, së cilës iu besua Kurani, në kohën kur gjendja për ruajtjen dhe përkujdesjen ndaj Kuranit ishte jo lehtë.

Kemi edhe Umu Amaren, një grua që veten dhe djalën e saj e bëri mburojë për Profetin a.s., derisa Profeti a.s. i tha se kush mund ta bëjë këtë që e bën ti o Umu Amare?

1 Transmeton Tirmidhiu.

2 Shiko: Elena Gjika, Dora d'Istrias.

3 Shiko: Elena Gjika, Dora d'Istrias.

Familja, kjo çerdhe e sfiduar nga moderniteti

Labinot Kunushevc

Të gjitha sistemet dhe ideologjitë e kohës në një mënyrë kanë interferuar në konceptin familje. Jo çdoherë familja ka gëzuar imunitet apo autonomi përballë presioneve, veçmas kulturore, ekonomike, antropologjike, psikologjike, fetare dhe politike, në frymët autoritare. Pasi familja është grupi i parë shoqëror, ajo, nga sociologët, sot me të drejtë konsiderohet si një institucion bio-emocional dhe socio-ekonomik.

Në sociologji njihen disa teori që shpjegojnë funksionet e familjes, si teoria tradicionaliste, teoria funksionaliste, teoria interaksioniste, teoria evolucioniste etj., të cilat funksione kanë evoluuar me kohë. Ndonëse në mentalitetin primitiv, në të cilin ka munguar vetëdija shoqërore, familja është konceptuar në mënyrë dogmatike, duke u trajtuar në funksion vetëm riprodhues, si faktor nataliteti, gjë që këtë e kanë keqpërdorur demografët jugosllavë për ta ndërtuar argumentin e tyre kolonial me akuzën se “gruaja shqiptare është një lavatriçe që di të bëjë vetëm fëmijë”, sot, familja shihet dhe pranohet edhe si funksion edukativ, rekreativ, emocional, mbrojtës, ekonomik, socializues,¹ në dimensione dhe paradigma të reja komplekse.

Pra, edukimi është komponenta më e rëndësishme e familjes. Andaj, sot shumë më lehtë është të shtosh numrin e fëmijëve, të krijosh e përcjellësh gjenerata, të mburresh me natalitetin në rritje dhe me argumentin demografik, por sfida më e vështirë, testi në

të cilin bien shumë prindër, dimensionin më inteligjent i jetës – edukimi dhe pavarësimi i fëmijës – që nuk përfshihet në pyetësorët e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), është testi për krijimin e personalitetit të fëmijëve. Derisa një shoqëri fokusohet me krejt potencialet e saj vetëm në mirëqenien fizike dhe materiale të fëmijëve, duke marginalizuar mirëqenien intelektuale dhe morale, ajo shoqëri do të vuajë kronikisht nga mungesa e mirëqenies dhe stabilitetit.

Në anën tjetër, funksioni politik i familjes, një funksion i kahershëm historik, sot është zbehur pasi kemi pak ose fare martesë që krijohen me qëllime politike për krijimin e aleancave me fuqi apo familje e fise me reputacion në shoqëri. Familja sot reflekton jashtëzakonisht shumë vlera, norma, ambicie, pasione dhe qëllime të tjera fisnike, humane, sociale, ekonomike, kulturore, profesionale etj., përtej logjikës fisnore.

Madje historikisht, sidomos në 50 vjetët e fundit, familja ka gëzuar një fokus më të madh edhe në politikat publike, siç për shembull, sociologu i njohur britanik, Anthony Giddens, përmend se në Konferencën e grave konservatore më 1986, Margaret Thatcher, deklaroi se politika jonë nisë nga familja, liria dhe mirëqenia e saj.² Dhe nuk duhet çuditur, sepse çdo platformë, organizim politik, projekt nacional, që nuk e vë në prioritet institucionin familje, mund të dështojë. Ashtu siç njohim në historinë e perandorive, që edhe perandoritë kanë filluar

Derisa një shoqëri fokusohet me krejt potencialet e saj vetëm në mirëqenien fizike dhe materiale të fëmijëve, duke marginalizuar mirëqenien intelektuale dhe morale, ajo shoqëri do të vuajë kronikisht nga mungesa e mirëqenies dhe stabilitetit.



të bien kur është dridhur stabiliteti i familjes, pra kur ka filluar degjenerimi moral i saj.

Historianët e shpjegojnë evoluimin e familjes që nga fillet e njerëzimit, nëpër periudha dhe sisteme të kohës, por familja shqiptare, shekujve të fundit ka përjetuar dinamika të ndryshme nga aparatura dhe ideologji të kohës, nën ndikimin e perandorive, tradicionalizmit, Kanunit të Lekë Dukagjinit, sistemit komunist jugosllav dhe enverist, politikave koloniale, e deri në modernitetin, i cili e gjeti shoqërinë shqiptare në një tranzicion kulturor mjaft entuziast, por ende të papërfunduar dhe me një identitet ende të pa konsoliduar.

Zhvillimi i industrisë, teknologjisë dhe ekonomisë, krijimi i institucioneve dhe kultivimi i vetëdijes institucionale, rregullimi i jetës nëpërmjet aparatit të shtetit dhe vënia në ekuilibër ndërmjet të drejtave dhe përgjegjësi që garantojnë institucionet publike, heqja dorë apo çlirim nga ideologjitë monstruoze që sulmonin drejtpërdrejt familjen në histori, liria në planifikimin familjar dhe mbështetja shoqërore e mbështetja institucionale ndaj familjes, do të duhej të përdoreshin si faktorë favorizues që familja ta luajë rolin e saj edukues, duke krijuar paqe, siguri, stabilitet, harmoni dhe mirëqenie në shoqëri, pikërisht si një çerdhe edukuese.

Por në fakt, përballë mundësive të shumta, ekzistojnë edhe rreziqe apo kërcënime reale. Të drejtat e individit dhe të drejtat e familjes duhet të bashkekzistojnë në harmoni të plotë, sepse individit dhe familja thelbësisht nuk janë në konflikt, nuk janë kontradiktore. Ato

janë komplementare. Fuqizimi i familjes nuk e diskriminon apo cenon integritetin apo të drejtat e cilitdo individ. Pra, përgjegjësia apo liria familjare nuk e cenon përgjegjësinë apo lirinë individuale, sepse kështu është krijuar një perceptim i gabuar që fuqizimi apo moralizimi i familjes po e tkurrë individin në shoqëri. Asnjë institucion shoqëror nuk mund të funksionojë kur familja është në krizë të thellë strukturore, planifikuese, edukative apo kur familja është në proces të tëhuajësimit për shkak të presionit kulturor apo sfidave të adoptimit. Një shoqëri me familjen në shuarje është një shoqëri që po vetëvritet.

Sfidat me të cilat ballafaqohet sot familja në Kosovë janë të shumta, sipas sociologut Kamberi. Ndër to ai përmend: mosrespektimin e saj (familjes) nga fëmijët, mungesën e vizitave të ndërsjella familjare, problemet dhe konfliktet e ndryshme brenda familjes si rezultat i shkaqeve socio-ekonomike dhe shkaqeve të tjera, ejxhizmin (term sociologjik që ka të bëjë me diskriminimin në moshë), ku sot mund të vërejmë raste të shumta për shkak të moshës, fëmijët i dërgojnë prindërit në azil të pleqve dhe harrohet tërë kontributi i tyre, pastaj familja shqiptare, edhe pse sot ka një egalitarizëm (barazi në të gjitha sferat e jetës), për fat të keq mungon drejtësia sociale. Të dhënat flasin se familja sot ballafaqohet me shkallë të lartë të divorceve në raport me periudhën e paraluftës dhe në raport me numrin e përgjithshëm të popullsisë në Kosovë.³

Moderniteti ka sjellë sa shanse, po aq rreziqe. Por sfida kryesore mbetet mënyra se si zgjedhim ne të bashkëpunojmë, reagojmë apo t'i trajtojmë këto shanse dhe rreziqe. Duke qenë se kemi një sistem arsimor me cilësi të dobët, duke qenë se kemi media që kryesisht ndjekin logjikën e sensacionit, klikimit dhe fitimit, duke qenë se kemi institucione indiferente dhe inferiore në raport me familjen, duke qenë se kemi elita politike, kulturore, fetare dhe akademike, që nuk e prioritojnë familjen në diskursin e tyre, atëherë familja bërthamë do të mbetet e rrezikuar nga konceptet deformuese, që vijnë nga grupet e interesit, grupet e viktimizuara, agjendat reformuese dhe plot iniciativa të tjera ligjore e civile.

Nëse ka një institucion që krijon zakone, formon personalitete, transformon mentalitetin, kultivon mekanizmin e ndërgjegjes, nxitë solidaritetin shoqëror, zhvillon empatinë shoqërore, përgatitë gjenerata potenciale për sfidat e ardhshme, parandalon dhe zgjidhë probleme, ajo është familja.

Fenomeni “fejësia në djep” që studiohet veçmas nga sociologët, i takon një të kaluarë të dominuar nga e drejta zakonore, të karakterizuar me martesë të parakohshme të fëmijëve, që për ironinë dhe absurditetin e madh, fëmijët lindnin “të fejuar”.

**Një shoqëri
me familjen në
shuarje është
një shoqëri që
po vetëvritet.**

Të jetuarit në një familje moderne nuk nënkupton heqje dorë nga familja tradicionale. Një familje inteligjente, me mençuri të mprehtë, që nuk e humbë kuptimin e realitetit dhe nuk ndihet inferiore me të kaluarën e saj, por e pranon atë me krenari si pjesë të identitetit apo trashëgimisë, di të harmonizojë vlerat tradicionale me ato moderne. Sepse tradita shqiptare, tradita myslimane, ka prodhuar shumë elemente humane, fisnike dhe shoqërore në raportet familjare, të cilat mund të adoptohen edhe sot pasi janë shumë koherente, e ruajnë kohezionin dhe solidaritetin familjar. Dhe në anën tjetër, të gjitha elementet primitive, diskriminuese, shfrytëzuese apo abuzuese që kanë qenë në kontekste të caktuara të familjes, të korrigjohen dhe mënjahohen nga mënyra bashkëkohore e jetesës. Pra, një lloj filtrimi i sistemit të vlerave është i domosdoshëm, ashtu që të mos krijojmë familje me modelin e imitimit të verbër, familje dogmatike, familje të kontrollit dhe diktatit arbitrar, me elemente patriarkale.

Por edhe familja bashkëkohore që synon të adoptojë vlera moderne nuk nënkupton mishërim fanatik me të gjitha elementet moderne, sidomos kur rrezikohet orientimi i familjes. Barazia gjinore duhet të kuptohet si barazi e shanseve, jo në kuptimin literal apo natyror. Të qenët një familje moderne nuk nënkupton një familje inferiore me të kaluarën; një familje ku nuk ka principe dhe vlera; ku nuk ka “po” ose “jo”, “duhet” ose “s’duhet”; një familje kaotike pa hierarki ku ngatërrohen rolet dhe përgjegjësitë në të; një familje e shthurur moralisht që nuk respekton kodin etik të komunikimit dhe sjelljes publike; një familje egoiste, e izoluar dhe që e pranon çdo zhvillim të ri që e sjellë një kulturë e caktuar lindore apo perëndimore jashtë kontekstit. Ky me të drejtë quhet shfytyrim i konceptit “familje moderne”.

Autorët e njohur Fisher dhe Kerckhoff, na mësojnë se brenda familjes fëmijët përgatiten për jetë, për profesionin e tyre, mësohen për mënyrën e arritjes së qëllimeve në jetë, për mënyrën e menaxhimit të ekonomisë shtëpiake, për përkrahjen e shëndetit fizik dhe mental të anëtarëve të familjes, për arritjen e standardit jetësor etj.⁴

Ndërsa sot, shohim veçmas në shoqërinë kosovare, ku prindërit bashkëkohorë nuk i edukojnë fëmijët që të vlerësojnë sakrificën, përpjekjen, angazhimin, ringritjen, punën dhe disiplinën, të mësohen fëmijët si të

ballafaqohen me vrazhdësinë dhe brutalitetin, me sfidat dhe me vështirësitë, me humbjet dhe me dështimet, me përjashtimet dhe me refuzimet, me pengesat dhe me barrierat, me ngërçet dhe me nyjat, në mënyrë që me psikologjinë sociale të aftësohen se si me forcat e tyre t’i menaxhojnë konfliktet, të mbijetojnë, të kapërcejnë lumenj e dete.

Fëmijët duan sukses, fitore, trofe, çmime e medalje, statuse e privilegje, pa mund, pa konkurrencë dhe pa sakrificë. E kërkojnë gjithmonë rrugën më të shkurtër. Duan shpejt, lehtë, gatshëm, afër dhe sigurt. Duan falje dhe mëshirë, tolerancë dhe liri, fleksibilitet dhe përkëdhelje, hapësirë dhe shanse, pa kufi. Sepse ata duke u mësuar të bëjnë një jetë të lehtë e të gatshme, po bëhen gjithnjë e më shumë të paaftë, dembelë e parazitë.

Me këtë infrastrukturë që ua krijojnë fëmijëve i bëjnë të sfidohen kur të rriten dhe të ballafaqohen me tregun dhe me konkurrencën e ashpër, sepse janë tërësisht të papërgatitur. Pra, një mënyrë konsumeriste dhe hedoniste e të jetuarit, në mëshirën e fatit, në mëshirën e shtetit të dobët, në mëshirën e rrethanave të paparashikuara, në mëshirën e mjedisit të pasigurt, në mëshirën e solidaritetit shoqëror, në mëshirën e rregullave të lojës, që të fortët i përcaktojnë. Më pas zhgënjehen, përjetojnë depresion, u thyhen iluzionet, dështojnë dhe migrimin e shohin si rrugëdalje të fundit pasi kuptojnë se emri dhe prestigji nuk garantojnë sukses.

Sot i duket klishe një fëmije, që prindërit e tij ta dërgojnë në bibliotekë, në panair të librit, në teatër, në muze ose në galeri, në një objekt të trashëgimisë kulturore apo në një objekt fetar, sepse prindërit asnjëherë nuk i kanë folur për vlerat e tyre. Asnjëherë nuk i kanë ofruar ndonjë dokumentar informues dhe edukues. Asnjëherë nuk e nxitin të mësohet të përgatisë vetë ushqimin, të pastrojë shtëpinë apo mjedisin, të shkathtësojë ndonjë shprehje të punës, të blejë produkte ushqimore, të kryejë shërbime për nevojat familjare, të mirëpres edhe nderojë mysafirin.

Nuk ia mësojnë as konceptin për Zotin! Sepse nga injoranca dhe naiviteti që kanë, nuk duan që besimi në Krijuesin të shndërrohet në normë kulturore të sjelljes publike dhe nuk e dinë çfarë suksesi garanton paqja dhe besimi i thellë në Zotin, që korrespondon me një sistem human të vlerave, i cili krijon vetëdije vetëmbrojtëse

Tradita shqiptare, tradita myslimane, ka prodhuar shumë elemente humane, fisnike dhe shoqërore në raportet familjare, të cilat mund të adoptohen edhe sot pasi janë shumë koherente, e ruajnë kohezionin dhe solidaritetin familjar.



dhe rezistuese ndaj rreziqeve që ata u ekspozohen. Nuk imagjinohet formimi dhe zhvillimi i personalitetit pa besim në Zot, sepse është formim i gjymtë.

Prandaj me të drejtë shumë autorë thonë se funksioni edukativ brenda familjes së ngushtë ende mbetet më kryesori dhe i pazëvendësueshmi në krijimin e personalitetit të fëmijëve. Këtu rol të madh ka personaliteti i prindërve dhe ngritja intelektuale e tyre (përfshirë cilësitë fizike dhe shëndetësore të prindërve, niveli arsimor, profesioni, tipi i vendbanimit, numri i fëmijëve në familje, moshë e prindërve etj., veçanërisht nënës dhe babait.)⁵

Fëmijës duhet t'i jepet rasti të shprehet, të rrëfëhet, të ankohet, të kundërshtojë e të akuzojë, të pyes e të përgjigjet, të tregojë ngjarje, situata, përvoja e probleme që ai i sheh, i dëgjon, i lexon apo i përjeton, ashtu që fëmijët të edukohen të jenë të lumtur, jo të pasur, ta dinë vlerën e gjërave dhe jo çmimin e tyre.

Po jetojmë në një shoqëri, me një rrezik në rritje, ku idiotët ta rrëmbejnë në duar fatin e fëmijëve dhe fëmijët të mos mund ta gjejnë kurrë rrugën e tyre, duke mos trashëguar asgjë nga e kaluara.

Sot kemi të bëjmë me prindër që gjejnë kohë për miq e mikeshë, por jo edhe për fëmijët e tyre; gjejnë kohë për shëtitje, takime, kafe e dreka, aventura e ahengje, por fëmijët i takojnë vetëm në mëngjes ose vetëm në mbrëmje, duke lënë një boshllëk të pazëvendësueshëm me shkëputje fizike, emocionale dhe komunikuese.

Ndërsa vetë fëmijët sot komunikojnë me kulturën e sharjes dhe të bullizmit, me emra fyes e ofendues, me një fjalor rrugaçerie mjaft të varfëruar, duke mos treguar

emocion, respekt, konsideratë, empati, mirënjohje dhe keqardhje ndërmjet vete. Ata ballafaqohen me sëmundje, me infeksione dhe me mbipeshë, sepse prindërit nuk kujdesen për shëndetin e tyre, për mënyrën e të ushqyerit, nuk konsultohen me ndonjë pediatër ose nutricionist, nuk respektojnë asnjë program që do ta përmirësonte mënyrën e tyre të jetesës.

Ekzistojnë tipe apo organizime të ndryshme të familjeve, familja bërthamë dhe familja e zgjeruar, familja monogamike dhe familja poligamike, familja endogamike dhe familja eksogamike, familja patriarkale dhe familja matriarkale etj.. Në pikëpamjen time sociologjike, familja më e sigurt në rrethanat e sotshme është një familje bërthamë (familje e vogël), monogamike (martesa me vetëm një person), eksogamike (jashtë grupit apo fisit të ngushtë) dhe përtej patriarkalitetit (dominimit apo sundimit të burrit) dhe matriarkalitetit (dominimit apo sundimit të gruas). Pra, ku ekzistojnë shanset e barabarta, por duke respektuar rolet dhe kompetencat, dinjiteti dhe integriteti, të drejtat dhe liritë e secilit anëtar të familjes, në përputhje me një sistem të vlerave dhe me një hierarki që krijohet në një familje, e cila ka një udhëheqës që e ruan kohezionin dhe solidaritetin e saj. Ky model do të eliminonte rreziqet për shuarjen apo shkatërrimin e familjes, për dukuri si: dhuna, incesti, abuzimi, shfrytëzimi, diskriminimi, devijimi etj..

Por ridefinimi i familjes moderne nga qarqet perëndimore kulturore po e vë në disfatë familjen përballë modernitetit dhe neoliberalizmit, që gjithnjë e më shumë po e bluan dhe gllabëron armën më të fuqishme të saj – edukimin moral. Edukimi mbetet përgjegjësi themelore dhe primare e prindërve që kanë krijuar familje. Përmes edukimit synohet pavarësimi i fëmijëve. Dhe këtu përfundon suksesshëm një familje zhvillimin e saj, atëherë kur edukimi dhe pavarësimi i fëmijëve shkojnë paralelisht.

- 1 Mimoza Dushi, *Femra dhe evolucioni i lindshmërisë në Kosovë*, (Prishtinë, Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, 2009), 233.
- 2 Anthony Giddens, *Sociologjia*, (Tiranë, Çabej, 2002), 398.
- 3 Ferdi Kamberi, *Dilemat e Tranzicionit*, (Prishtinë, Artini, 2019), 68.
- 4 Fisher L. Barbara dhe Kerckhoff K. Richard, (Family Life Education: Generating Cohesion out of Chaos), Family Relations, 1981, Vëll. 30, Nr. 4, f. 505-509.
- 5 Afërdita Deva – Zuna, *Faktorët themelore të edukatës familjare dhe ndikimi i tyre në edukimin e fëmijëve të moshës parashkollore* (tezë e doktoratës në dorëshkrim), (Prishtinë, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Filozofik, 1996), 113-118.

Lidhja dhe bashkëpunimi i ulemave shqiptarë të Kosovës me Trupin Diplomatik Shqiptar (1936-1939)

Qerim Lita

Pas shkatërrimit të organizatës politike Xhemijet (1925),¹ shqiptarëve iu ndalua e drejta e përfaqësimit në parlament nëpërmjet ndonjë partie të tyre. Por, kjo e drejtë atyre u mundësohej vetëm nëpërmjet partive të ndryshme serbe (jugosllave), siç ishin në atë kohë “Partia Radikale” apo “Partia Demokratike”.² Në rrethanat kur shqiptarëve iu mohojë çdo e drejtë, qoftë ajo qytetare kombëtare, arsimore dhe kulturore, një pjesë e parisë si dhe të ulemave të njohur shqiptarë, si: Ferhat bej Draga, Seit Hoxha, Iljaz Haxhi Xhemail Prishtina, Ramë Bllaca, Kadri Saliu, dr. Xhafer Sulejmani, Vesel Kryeziu-Pagarusha, Akshi Sulejmani, Xhevat Begolli, Rexhep Remzi Abdullahu, Nuredin Haxhi Haliti - Mulla Nura, Shaban Efendi, Mulla Idriz Gjilani, hafëz Sherif Langu, Atullah ef. Kurtishi, hafëz Sherif Jashari, Jahja ef. Daci etj., në fillim të viteve tridhjeta të shekullit të kaluar, ndërmorën një sërë aktiviteteve politike dhe

organizative, të cilat kishin për qëllim ndërgjegjësimin e shqiptarëve. Veprimtaria e tyre u përqendrua në tri çështje thelbësore për kohën: e para, me Bashkësinë Islame, përkatësisht me Mexhlisin e Ulemasë së Shkupit të udhëheqin vendorët e jo klika boshnjake, e cila me bekimin e Beogradit e mbante në duart e veta këtë organizatë të rëndësishme fetare; e dyta, ngritja e vetëdijes kombëtare, dhe e treta, ndërprerja e tërësishme e shpërnguljes së shqiptarëve për në Turqi.

Po në atë periudhë kohore, përkatësisht me shpalljen e monarkisë, u vu re një rritje e vëmendjes së Mbretërisë Shqiptare për çështjen e Kosovës në veçanti dhe atë shqiptare në përgjithësi nën Jugosllavi. Trupi diplomatik shqiptar në Mbretërinë jugosllave u porosit që të krijonte lidhje dhe të bashkëpunonte ngushtë me parinë dhe me ulematë shqiptarë të Kosovës e të trevave të tjera shqiptare nën Jugosllavi. Këto



sinjale u qartësuan kur për ministër fuqiplotë (ambasador) të Qeverisë Mbretërore të Shqipërisë në Mbretërinë e SKS-së (nga viti 1929 të Jugosllavisë) u emërua Rauf Fico, njëri ndër diplomatët më të shquar shqiptar të kohës. Në letrën dërguar Mbretit Zog, më 2 shkurt 1929, ai shprehte pikëpamjen e tij se kishte ardhur koha që Shqipëria ta ngrejë zërin e saj në mbrojtjen e popullsisë shqiptare në Kosovë. *“...Shpirti i mjeruemë i Kosovës, shkruante Fico, po pret të shofi agimin e (Ditës së Madhe) dhe gjithë populli ka varur shpresat në veprat e Nalt Madhnis së Tij, Shpëtimtarit Kombit, Mbretit Shqiptarëve. Mua më duket se nashti është koha më e volitshme për të profituar nga rasti që është çfaqur me demarshet e bëra nga ana e Komitetit Ballkanik në Lidhjen e Kombeve. Nashti është koha që të kërkohet çelja e shkollave shqiptare në Kosovë e në Maqedoninë...”*³.

Është me rëndësi të vihet në dukje fakti se, trupi diplomatik shqiptar, me qëllim të ngritjes sa më parë të vetëdijes kombëtare, gjithnjë në bashkëpunim të ngushtë me ulematë shqiptarë, por edhe me organizatën studentore “BESA”, gjatë viteve tridhjeta të shekullit të kaluar ndërmori disa hapa konkret në përhapjen e mësimin në gjuhën shqipe, duke shpërndarë libra të shumtë në gjuhën shqipe në mbarë hapësirën shqiptare nën Jugosllavi. Në Promemorien e hartuar gjatë vitit 1937 nga Kryekonsullata Mbretërore Shqiptare në Shkup, thuhej se e tërë veprimtaria e saj, bazohej në udhëzimet dhe urdhëresat e eprorëve, në radhë të parë në “ringjalljen e forcimin e idesë kombëtare” dhe të përhapjes së mësimin të gjuhës amtare në trevat e ndryshme të Kosovës, dhe se për realizimin e këtij qëllimi, ishin “shpërndarë në shumicë libra të ndryshme, që sot me kënaqësi “shohim që një pjesë e konsiderueshme ka mësuar të këndojë e të shkruajë gjuhën amtare...”⁴.

Këta dhe shumë libra të tjerë shpërndaheshin nëpër trevat shqiptare nga njerëz të besuar të trupit diplomatik shqiptar në Shkup e Manastir, në mesin e të cilëve duhet veçuar hoxhën dhe atdhetarin e shquar nga Pagarusha e Suharekës, Vesel Kryeziun, i cili gjatë viteve tridhjeta të shekullit të kaluar shpërndau mbi 3.000 abetare të gjuhës shqipe, që kjo përbënte një kontribut të jashtëzakonshëm në zhdukjen e

Duhet veçuar hoxhën dhe atdhetarin e shquar nga Pagarusha e Suharekës, Vesel Kryeziun, i cili gjatë viteve tridhjeta të shekullit të kaluar shpërndau mbi 3.000 abetare të gjuhës shqipe, që kjo përbënte një kontribut të jashtëzakonshëm në zhdukjen e analfabetizmit të shqiptarët e Kosovës.

analfabetizmit të shqiptarët e Kosovës.⁵ Veprimtarinë e përhapjes së mësimin të gjuhës shqipe ulematë shqiptarë e zhvillonin, natyrisht në bashkëpunim të ngushtë edhe me organizatën studentore “BESA”, në krye të së cilës qëndronin trembëdhjetë studentë shqiptarë: Shaip Kamberi nga Tetova, Shaip Mustafa nga Presheva, Abdullah Saqipi nga Presheva, Sokol Dobroshti nga Gjakova, Tahir Ismaili nga Gjakova, Xhevdet Pallaska nga Gjakova, Ibrahim Lutfiu nga Prizreni, Imer Rashidi nga Struga, Ejup Abdyrrahmani nga Dibra, Nexhip Deva nga Mitrovica, Esad Doko nga Ohri, Esad Berisha nga Gjilani dhe Hasan Hakiu nga Prizreni⁶. Diplomati shqiptar, Seremet Xhaxhuli, e njoftonte MPJ-në në Tiranë, se organizata e fshehtë e rinisë studentore “BESA”, në mbështetje dhe inkurajimin e vazhdueshëm nga i nënshkruari “nuk le rast pa i treguar” pjesës intelektuale të këtushme vuajtjet e kosovarëve. “Disa kohë më parë”, shkruan më tej Xhaxhuli, “kryetari i kësaj organizate në një mbledhje të studentëve në Universitetin e Beogradit, mbajti fjalimin, me anën e të cilit i shpjegoi gjendjen gjer e gjatë mjerimit, e shkaktuar prej zbatimit në një mënyrë çnjerëzore të Reformës Agrare në viset e Kosovës.”⁷

Është për t'u theksuar fakti se, trupi diplomatik shqiptar, rëndësi të veçantë i kushtoi edhe organizimit të mirëfilltë të organizatës së atëhershme myslimane, përkatësisht të Mexhllisit të Ulemasë së Shkupit, i cili deri atëherë udhëhiqej nga klika serbo-madhe. I deleguari i plotfuqishëm shqiptar në Beograd, Rauf Fico, në një takim që e pati në Beograd me Ferhat bej Dragën, i sugjeroi atij që të merrej vesh me Mehmet Spahon për riorganizimin e Mexhllisit të Ulemasë së Shkupit, me qëllim që i njëjti të udhëhiqet nga shqiptarët e jo nga klika serbo-madhe që i printe Fejzi Haxhiamziqi, një boshnjak i serbizuar.

Rrjedhimisht, Ferhat Draga u takua me M. Spahon dhe u pajtuan që Mexhllisi i Ulemasë së Shkupit të udhëhiqet nga ulematë shqiptarë dhe njëkohësisht të bashkëveprojë me Mexhllisin e Ulemasë së Sarajevës. Dy bashkëbiseduesit u pajtuan që ky bashkëpunim midis shqiptarëve dhe boshnjakëve të shtrihet edhe në fushën politike. Lidhur me këtë, Rauf Fico, më 25 shtator 1935, i shkruante Mbretit Zog



se marrëveshja e arritur midis Dragës dhe Spahos, përbënte një rëndësi të veçantë për popullsinë shqiptare myslimane të Kosovës, dhe se shqiptarët duhet që: *“të lidhen me sho-shoqin në rreth të organizatës fetare dhe të sigurojnë zgjedhjen e disa deputetëve të pajisur me dijeni e me kurajo civile, që të mundin t’i mbrojnë të mjerët kosovarë, para terrorizmave e grabitjeve të tmerrshme që po iu bahen në mënyra zyrtare e private dhe të ndalojnë definitivisht shtrëngimet që po iu bëhen për emigrim...”*⁸.

Për rrjedhojë, më 25 mars të vitit 1936, organet supreme të BFI-së, hartuan Kushtetutën e re që hyri në fuqi më 5 nëntor të atij viti, pasi u publikua në gazetën zyrtare.⁹ Me Kushtetutën e re, në vend të komisarit politik, i cili deri atëherë emërohej nga ministri i Drejtësisë, u krijua organi ekzekutiv prej pesë anëtarësh dhe po aq zëvendësish, i cili zgjidhej nga Kuvendi mearif i vakëfit. Këshilli Ekzekutiv zgjidhte nga radhët e veta kryetarin dhe nënkryetarin e tij. Mënyra e zgjedhjeve të këtyre organeve sqarohej në nenin 115 ku thuhej: *“Mexhliet e xhematit, kuvendet mearife të vakëfeve të qarqeve dhe këshillat mearife të vakëfeve në Sarajevë e Shkup zgjidhen përmes zgjedhjeve të përgjithshme, të barabarta, të fshehta e të drejtpërdrejta. Mandati i këtyre organeve zgjat 4 vjet. Zgjedhjet duhet të mbahen detyrimisht brenda një dite”*.¹⁰

Me qëllim të një koordinimi sa më të mirë me krerët shqiptarë të Kosovës, Rauf Fico, gjatë muajit shtator 1935 vizitoi Shkupin, me ç’rast pati takime të rëndësishme me dy figurat e shquara shqiptare të kohës, Ferhad bej Dragën dhe Said Hoxhën. Me t’u kthyer në Beograd, Fico, përmes një relacioni dërguar Mbretit Zog, shprehte një optimizëm shumë të madh për zgjidhjen e çështjes shqiptare në Kosovë,

sepse siç vë në dukje, paria shqiptare, nën udhëheqjen e Ferhat bej Dragës e të Sait Hoxhës, tashmë kishte filluar t’i konsolidonin radhët e veta. Në relacion, Fico shkruante se, Ferhat bej Draga, edhe pse ishte “tepër egoist”, ai megjithatë ishte një patriot i madh shqiptar, i cili *“nuk kurcehet kurr që të çfaqet lirisht e botnisht mendimet e tija kombëtare...”*¹¹ Përveç, Dragës, Fico, në relacion lartësonte edhe figurën e Sait Hoxhës, për të cilin ai shprehet për sa më poshtë vijon:

*“...Natën me 21 Vjesht në odën e shtëpis ku banon sekretari i Kryekonsullatës Z. Sofo Çomora u poqa me Z. Sait Hoxhën dhe i komunikova përsëritetjet e Naltmadhnis s’Uej u mallëngjue për së tepërti e iu mbushën syt me lot. Ky njeri zotnon karakter të fortë, tepër i ndershëm dhe mjaft i ditun, por edhe ky si i pari mjaft egoist... Si një njeri i zgjuar gjen mënyrën e kombinimit me ndjenjat fetare me ato të kombësis. Si në fillim të jetës së tij edhe sot ka mbet plotësisht një (softa), vobeksia dhe nevojat e jetës nuk kan mujtur ta trembin as pak. Kur i thash se Madhënija e Juej ishit gati për me i ndihmue me sa qe të dëshironte, më tha: Ju falem nderit shumë, por unë shërbej për atë që besoj... Unë Madhënin e Tij e njoh që në vegjeli e nashti që esht i pari i kombit tem, e kam për detyrë t’i shërbej atdheut dhe Ati me sa fuqi që të kem deri sa të vdes. Unë nuk kam nevojë për kur gjë, janë të tjerë që do të kenë nevojë kur të vijë koha u them që t’i ndihmoni. Zotnija e tij në një mënyrë madhështore shkëlqen me sinqeritetin e thjeshtësin e tij...”*¹²

Në përputhje me Kushtetutën e re të BFI-së, më 6 mars të vitit 1937, Naib-i Fejzi Haxhiamziq, shpalli zgjedhjet e përgjithshme në hapësirën e Mexhllisit të Ulemasë në Shkup.¹³ Në garën zgjedhore u paraqitën tri lista zgjedhore: lista që i printe Ferhat bej Draga, pas së cilës qëndronin ulematë dhe atdhetarët e shquar shqiptarë si: Mulla Idriz Gjilani, Kadri Saliu, Shaban Efendi, Iljaz Agushi, Zenel Strazimiri, Abdullah Velu, Azem Latif Hoxha, Nuredin Haxhi Haliti, Hasan Shukriu, hafëz Bedri Hamidi, hafëz Sherif Langu, Remzi efendi Abdullahu etj.. Një mbështetje të fuqishme pati edhe nga udhëheqja studentore “BESA”¹⁴ Listën e dytë e kryesonte Fejzi Haxhihamziq, i cili u propozua si kandidat nga mbështetësit e regjimit të Beogradit, shumicën e të cilëve ky regjim i kishte vendosur nga Bosnja në Shkup, me detyrë speciale që të zhvillonin propagandë për turqizmin, përkatësisht serbizimin e shqiptarëve. Listën e tretë e kryesonte Atullah efendi Kurtishi, një ulema i njohur në këto treva e më gjerë, kundërshtar i rreptë i F. Haxhiamziqit, i cili, siç do të shohim më poshtë, pas zgjedhjeve do t’i bashkëngjitet grupit të Ferhat Dragës.¹⁵

Rëndësi të madhe këtyre zgjedhjeve i kushtoi trupi diplomatik shqiptar në Beograd, Shkup e Manastir, i cili mbështeti fuqishëm listën e Ferhat Dragës, si në pikëpamje politike po ashtu edhe financiare. Ministri fuqiptotë pranë Legatës Mbretërore Shqiptare në Beograd, më 6 maj 1937, i



shkruante ministrit të Jashtëm, Ekrem Libohovës, për fushatën zgjedhore në Kosovë për zgjedhjen e organeve drejtuese të Mexhllisit të Ulemasë së Shkupit, ku, ndër të tjera, në të theksonte: “... Në Kosovë nër shumë Nënprefektura janë paraqitur tri lista, por nër shumë të tjera vetëm dy lista, ajo e Z. Ferhat Dragës dhe një tjetër, ajo që përkrahet prej Qeverisë, dhe për fat të keq prej shqiptarësh vegla të Qeverisë. Ndonse Guverna me mjetet e ndryshme të saja nuk le pa ndërhyrë në këto zgjedhje dhe përdorë gjithë influencën e organeve të saja, prapë se prapë shihet këtë herë në Kosovë një gjallërië që nuk është parë gjer tani dhe që duhet të na gëzoj. Elementi intelektual i shqiptarëve të Kosovës, shtrënguer rreth Z. Ferhat Dragës po punon me gjithë fuqitë e tij, natyrisht në krye të 12 studentët e ditur, të cilët me radhë po vizitojnë qendrat e ndryshme të krahinave të tyre, me qëllim që të bëjnë propagandë për listën e Z. Dragës që përmban emrat e shqiptarëve më të kulluar të Kosovës...”¹⁶

Ashtu siç ishte parashikuar, më 30 maj 1937 u mbajtën votimet në mbarë hapësirën e Mexhllisit të Ulemasë së Shkupit.¹⁷ Këshilli Qendror Zgjedhor shpalli fituese listën qeveritare të Fejzi Haxhiamziqit, me gjithsej 15 anëtarë të fituar, kundrejt listës shqiptare, e cila kishte fituar gjithsej 11 anëtarë dhe 1 anëtar fitoi lista e Atullah Hoxhës.¹⁸ Zgjedhjet, siç njoftonte kryekonsulli shqiptar nga Shkupi, Asafa Xhaxhuli, kishin qenë të manipuluar nga ana e organeve shtetërore e policore jugosllave.¹⁹ Ndërkohë, me ndërmjetësimin e Kryekonsullatës shqiptare në Shkup,²⁰ listës së Dragës iu bashkëngjiti anëtari i listës së Atullah Hoxhës, Havzi Kapetanoviq, dhe dy anëtarë nga lista e Haxhiamziqit: Ramush Osmani nga Gjilani dhe deputeti Mustafa Dërguti

nga Rahoveci, me çka në listën e Ferhat Dragës u rreshtuan 14 nga gjithsej 27 anëtarë sa numëronte Kuvendi Mearif i Shkupit.²¹ Menjëherë pas kësaj u zgjodhën organet e përkohshme të Mexhllisit të Ulemasë së Shkupit, ku për Naib u zgjodh krah i djalhtë i Ferhat Dragës, Kadri Saliu, avokat nga Gostivari.²² Në këtë mënyrë, grupi pro qeveritar serbofil i humbi pozicionet drejtuese që i kishte mbajtur për dekada me radhë në këtë institucion të rëndësishëm jo vetëm fetar, por edhe kombëtar. Udhëheqja e re Mexhllisit të Ulemasë së Shkupit solli ndryshime radikale, si në mënyrën e organizimit fetar-arsimor, ashtu edhe në menaxhimin e pasurisë së tundshme e të patundshme vakëfnore. Në krye të saj ishin krerët dhe ulematë e shquar shqiptarë të asaj kohe: Ferhat bej Draga, Ibrahim Lutfiu, Kadri Saliu, Mulla Idriz Gjilani, Iljas Agushi, Mulla Nura, myderrizi Abdullah Efendiu nga Prizreni, Asim efendi Luzha, Sherif efendi Langu, Ataullah efendi Kurtishi, Bedri efendi Hamidi, Azem efendi Latifi, Shaban efendi Jashari e shumë të tjerë. Në krye të Kuvendit Mearif të Vakëfit u zgjodh Ferhat bej Draga, ndërsa Këshilli i Kuvendit përbëhej prej 5 anëtarësh: Kadri Saliu, kryetar, ndërsa anëtarë u zgjodhën: Qemal Osmani, Sefedin Mahmutbeu, Zenel Strazimiri dhe Xhevat Mahmutbeu.²³ Përveç kësaj, u zgjodh edhe Mexhllisi i Ulemasë, i cili përbëhej prej katër anëtarëve: hafëz Sherif Langu, kryetar, Atullah efendi Kurtshi, Idriz efendi Hajrullau dhe Bedri efendi Hamidi, anëtarë.²⁴

1 Historia e Shqiptarëve gjatë shekullit XX, Vëllimi II, Tiranë 2019, fq. 605.

2 Државен архив на Република Македонија (мë tej ДАРМ). Фонд ОЗНА. Кутија .2, документ 2/II/II, бр. 13 б.

3 AQSH.F.687.V.1929.D.97.FI.1-5.

4 Arkivi Historik i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë (më tej AHMPJ).D.126.V.1937.FI.18-19,

5 AQSH.F.152.V.1941.D.67.FI.7.

6 AHMPJ.V.1937.D.126..., po aty, FI. 125-126.

7 AHMPJSH.D.126.V.1937.FI. 125-126.

8 AQSH.F.687.V.1935.D.227.FI.32-34.

9 ДАРМ. I. 613. I. 1/1-55.

10 Po aty.

11 AQSH.F.687.V.1935.D.227.FI. 18-23.

12 Po aty.

13 Po aty, Бр. 1426/37, Скопје, 13 априла 1937 године.

14 AHMPJ.V. 1938.D.Nr.107/2.FI.788-1939.

15 Po aty.

16 AHMPJSH. D. Nr. 126.V.1937.FI. 195-196.

17 ДАРМ. I. 613. 3. 1/ 1-75.

18 AHMPJ.D.126.V.1937..., po aty, fl. 307.

19 Po aty, FI. 93.

20 Po aty, 231-239.

21 Po aty, fl.452.

22 Po aty, FI. 442.

23 Архив Југославије (АЈ). Фонд бр. 63, фасц. бр.134, Вакуфски-меаривски саборски одбор, Скопје, 10 фебруара 1938 године.

24 Po aty.

Dhuna dhe terrori serb ndaj femrës shqiptare

Dr. Jusuf Osmani

Gruaja është:

- Shpirti i shtëpisë,
- Nëna e fëmijës,
- Zonja e shtëpisë,
- Kreu (nëna) e njerëzimit.

- "Gruaja është themel i moralit shoqëror, nyje e shenjtë, e cila mbjell dashuri ndërmjet njerëzve. Kur ajo lihet pas dore, vuan tërë shoqëria njerëzore." (Haki Stermilli)

- "Nëna është e pazëvendësueshme dhe atë nuk mund të zëvendësoj askush. Ajo mund t'i zëvendësojë të gjithë." (Ismail Kadare)

Gjatë të kaluarës historike, femra shqiptare ka luajtur rol të rëndësishëm në mbijetesën e popullit shqiptar. Ajo, jo vetëm që u kujdes për familjen, rritjen dhe edukimin

e fëmijëve, por ajo ka krye edhe shumë punë të tjera. Në mungesë të bashkëshortit, i cili shpesh mungonte nga shtëpia, për shkak se ai merrte pjesë në luftëra e kryengritje të shumta, në shërbimin ushtarak që ishte shumë i gjatë dhe udhëtonte larg atdheut me qëllim të punës në kurbet etj., ajo jo vetëm që ishte besnike ndaj tij, por edhe kujdesej dhe rriste fëmijët e saj, por kujdesej edhe për mbijetesën e familjes, duke u marrë me punë të shumta, madje edhe ato fushore, punëdore etj.. Femra shqiptare në shumë raste me armë në dorë luftonte për mbrojtje të atdheut dhe të pragut të shtëpisë. Femra shqiptare ishte dhe është krenaria e popullit. Ka shumë raste kur femra shqiptare krah për krah me burrin luftonin

Gjatë të kaluarës historike, femra shqiptare ka luajtur rol të rëndësishëm në mbijetesën e popullit shqiptar. Ajo, jo vetëm që u kujdes për familjen, rritjen dhe edukimin e fëmijëve, por ajo ka krye edhe shumë punë të tjera.



për liri e pavarësi. Mirëpo, në anën tjetër ndaj femrës shqiptare është bërë dhunë e terror.

Kryengritja e Parë Serbe e ka proklamuar parimin e vrasjes së “turqve”, përkatësisht “*Asgjësimin gjeneral të turqve nga populli*” (*Generalno trebljenje Turaka iz naroda*), si dhe shkatërrimin dhe rrënimin e çdo gjëje që është myslimane e turke. Kryengritësit serbë qysh në kryengritjen e parë më 1804, të nxitur nga udhëheqësit e tyre, njëkohësisht u vërsulën egërsisht mbi ta, pa zgjedhur mjetet: bënë vrasje, dhunime, keqtrajtime, u dhanë flakë shtëpive e objekteve, sidomos xhamive etj..

Popullata myslimane, duke përfshirë edhe atë shqiptare filloi në masë të madhe të ikë nga vendbanimet e tyre të tanishme në Pashallëkun e Beogradit. Shumë gra, ushtarët serbë në mënyrë jonjerëzore dhe të pamëshirshme i kanë lënë lakuriq, ndërsa “turqit dhe çifutët e vrarë më se 250 nëpër rrugë ishin të shtrirë”. Janë zënë rob 1.200 persona.¹

Beogradi më 25 dhe 26 shkurt 1807 ishte një “skenë e tmerrshme”. Janë vrarë mbi 4.000 “turq”. Kryengritësit prinin barkun e grave shtatzëna dhe nxirrnin fëmijët nga ato.² Nga myslimanët e vrarë kanë mbetur shumë të veja dhe fëmijë jetimë, që kanë qenë të detyruar që të lypin në mënyrë që mos të vdesin nga uria. Udhëheqësit e kryengritjes Mladen Milovanoviq e Miloje Petroviq kanë grabitur shumë shtëpi të myslimanëve në Beograd dhe shumë spahillëqe në rrethinë. Shumë serb me plaçkë janë pasuruar.³

Krime ndaj popullatës myslimane shqiptare etj., janë bërë në të gjitha qytetet dhe qytezat e Pashallëkut të Beogradit, ku kanë jetuar në numër të konsideruar. Këto krime kanë vazhduar edhe në vitet 1877-1878 ndaj popullatës shqiptare të Sanxhakut të Nishit.

Në një deklaratë të përfaqësuesve të shqiptarëve nga viset e ndryshme, dt. 7 prill 1878, paraqesin aktet e dhunës të ushtruara nga rusët, që kur e kanë kaluar Danubin e deri në ditët tona, në qyteza e fshatra të pushtuara prej tyre, qoftë me fuqinë e armëve, qoftë me mjete të tjera. Së këndejmi, ne do t'i numërojmë në vijim aktet arbitrare që janë bërë në Plevne që nga pushtimi i këtij fshati e

Krime ndaj popullatës myslimane shqiptare etj., janë bërë në të gjitha qytetet dhe qytezat e Pashallëkut të Beogradit, ku kanë jetuar në numër të konsideruar. Këto krime kanë vazhduar edhe në vitet 1877-1878 ndaj popullatës shqiptare të Sanxhakut të Nishit.

deri në vendosjen e administratës ruse. Ata vranë me mijëra myslimanë të pafajshëm në fshatra e qytete, plaçkiten të gjitha pronave të tyre, dogjën shtëpitë dhe objektet e tjera, posaçërisht dogjën xhami, teqe, libra të shenjtë e të vlefshëm dhe objekte të tjera myslimane, dhunuan femrave, morën femra të reja dhe dërgua në Rusi e gjetiu, si dhe bënë shumë krime të tjera. Gjatë hyrjes së trupave ruse dhe vallake në Plevne, këto dy ushtri, përveç përdhunimeve të llojllojshme që bënë, ata hynë me forcë nëpër shtëpitë e myslimanëve për t'i rrëmbyer femrat myslimane, për t'i përdhunuar dhe pastaj për t'i dërguar në bordele të reja që i kishin hapur.⁴

Femra shqiptare u vra e u dhunua gjatë pushtimit serb të Sanxhakut të Nishit në vitin 1877-1878, sidomos gjatë pushtimit të Vranjës. Lidhur më këtë një dëshmitar okular serb kishte shkruar: “*Kemi hasur disa fshatra shqiptare ku kanë mbetur familje me disa persona të shtyrë në moshë. Kemi hasur femra shumë të bukura dhe të reja, por që nuk e dinin gjuhën tonë dhe linin përshtypje të personave që nuk janë armiqësorë. Llogaritet se nga qytetet më shumë, e nga lokalitetet fshatare më pak, janë diku mbi 3.000-4.000 femra, që janë grabitur nga oficerët dhe ushtarët tanë të rinj. Kjo “miqësi” ka ardhur si shpërblim që të kenë femra të bukura gjatë tërë jetës, tipike të racës malësore, të bardha, zeshkane, por të rritura me ushqim natyral malor.*”⁵

Publicisti serb Aleksa Gj. Bogosavljeviq në vitin 1897 për shqiptarët thotë: “Moraliteti te shqiptarët është ruajtur në atë mënyrë që do të mund të shërbente si shembull për shumë popuj.”

Menjëherë pas pushtimit të tokave shqiptare nga Serbia dhe Mali i Zi, në vitin 1912 filloi dhuna dhe terrori në popullatën shqiptare me qëllim të serbizimit të Kosovës dhe pjesëve të tjera të banuar me popullatë shqiptare, siç ishin Maqedonia Perëndimore, pjesë të Malit të Zi etj.. Ajo iu nënshtuan spastrimit etnik dhe kolonizimit. Janë bërë masakra të shumta ndaj popullatës shqiptare, saqë as mendja e njeriut nuk mund t'i imagjinoj. Oficerët serbë shpallnin se “*paqja efektive në Shqipëri mund të arrihet vetëm duke i shfarosur krejtësisht shqiptarët.*” Urdhri suprem i Beogradit ishte i prerë: “*Duhet mësuar ai popull i egër për të*



jetuar në një shtet modern.” Pastaj, në gazetën serbe shkruante: “Duhet të vdesin disa gjenerata të shqiptarëve që të harrohet çfarë bënë serbët ndaj tyre.”⁶

Leo Freundlich, shkruan: “Mijëra e mijëra burra, femra, pleq e fëmijë të vrarë e të mbytur me të therura, fshatra të djegura dhe shtëpi të plaçkitura, gratë dhe vajzat e çnjerëzuara, një vend i shkretuar, i plaçkitur, i larë me gjak i turpëruar, dëshmon se serbët në Shqipëri nuk hynë si çlirimtarë, por si vrasës të shqiptarëve... Fshatra të panumërta u rrafshuan me tokë, u masakruan njerëz të panumërt në mënyrën më shtazarake. Vendi, ku gjeneratat e zellshme të shqiptarëve të varfër, krijuan atdheun e tyre, u shndërrua në grumbuj gërmadhash. Një popull i tërë u kryqëzua me gjak dhe Evropa hesht....”⁷

Ky proces gjenocidal ndaj popullatës shqiptare u shoqërua me dëbimin e tyre në Turqi e në Shqipëri. Sipas disa vlerësimeve në periudhën ndërmjet viteve 1912-1914, në Turqi u shpërngulën rreth 500.000 njerëz. Ndërsa, vetëm nga Kosova prej vitit 1913-1915 për të shpëtuar kokën nga gjenocidi shtetëror serbomalazez u detyruan të shpërngulen më se 120.000 shqiptarë.⁸

Me ripushtimin e Kosovës, në vjeshtë të vitit 1918 dhe vendosjen e pushtetit serbo-malazez e vënien në funksion të aparatit të veçantë administrativo-politik, administrata shtetërore e ushtarake, krahas organizimit të operacioneve ndëshkimore, të dhunës, terrorit, vrasjeve, dënimeve të mëdha etj., në të njëjtën kohë filloi një presion politik për shkombëtarizimin e popullatës shqiptare me metoda të ndryshme. Qarqet drejtuese të Beogradit rifilluan politikën e vjetër shoveniste.⁹

Në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore në Kosovë është zbatuar e ashtuquajtura reformë agrare, ku toka iu merrte pronarëve shqiptarë dhe iu jepej kolonëve sllavë të sjellë nga viset e ndryshme të Mbretërisë SKS, përkatësisht

Jugosllave. Qëllimi i kësaj ishte serbizimi i Kosovës duke bërë ndërrimin e strukturës nacionale në viset e Mbretërisë jugosllave në dëm të shqiptarëve duke i detyruar që ata të shpërngulën nga atdheu i tyre në Turqi e gjetiu.

Detyra e parë e gruas ka qenë pastrimi dhe rregullimi i shtëpisë dhe rritja e fëmijëve. Ajo nuk ka ditur se çka është kujdesia për bukë dhe veshje. Burri i saj, i cili ka qenë bujk, tani nuk dinë se çka të bënë dhe çka të lëvrojë. Tokën ia kanë grabitur, kështu që gruaja është e detyruar të kërkojë mjete të tjera për të fituar kafshatën e gojës, sepse fëmijët donë bukë. Një kohë veku i gruas shërbente për të përgatitur çejzin e vajzës, motrës, por tani punon pëlhurë për të shitur. Por, edhe kjo shitje nuk i plotëson as nevojat elementare të shtëpisë.

Marrjen e tokës dhe dhënien kolonëve e dëshmojnë shumë dokumente. Në një dokument shkruan se stacioni i xhandarmërisë në Landovicë të Prizrenit me shkresën nr. 680, datë 7.VI.1936 e njofton prefektin e Rrethit të Sharrit përkitazi me këtë: “....Kolonët, të cilët e kanë marrë tokën në kompleksin “Tupec”, janë marrë në mbrojtje nga ana e këtij stacioni sa është e mundur. Mirëpo, shumica e këtyre kolonëve ia kanë dhënë tokën shqiptarëve që edhe më tutje t’ua punojnë përgjysmë me marrëveshje të ndryshme, ndërsa disa sish gjenden nëpër Serbi dhe Mal të Zi, në shtëpitë e tyre, në vend se ata vetë ta punojnë tokën që e kanë marrë. Pastaj, ka raste të tilla që disa nuk ishin personalisht të pranishëm me rastin e dhënies së tokës, kështu që madje, nuk dinë as mezhdat e vërteta të parcelave të veta...”¹⁰

Gruaja shqiptare në shumë raste konfrontohej me organet e pushtetit serb, të cilët në formë të ndryshme uzurponin jo vetëm tokën, por edhe shtëpitë e pronarëve shqiptarë. Sipas një dokumenti të provinijencës gjyqësore, datë 11 shkurt 1937, Prishtinë, nr. KK 657/35, organet policore kanë shkruar në fshatin Budrikë të Poshtme, të Moravës së Epërme me qëllim të marrjes së shtëpisë së Sadri, Beqir dhe Ramadan



Musliut dhe dorëzimit të serbit Jovan Dishlakoviqit. Pronarët e shtëpisë kundërshtojnë. Patrulla policore ata i lidhin dhe i keqtrajtojnë. Aty afër ishte Havushja, gruaja e Bajram Shabanit nga Budrika e Poshtme, e cila i sulmon policët dhe i godet me dru. Organet gjyqësore këta i padisin, duke përfshirë edhe Havushën dhe i dënojnë.

Duke parë se kolonizimi me elementin sllav dhe shpërngulja e shqiptarëve nuk po jep rezultatet e duhura, sipas dëshirës dhe mendimeve të qarqeve borgjeze sunduese, në këtë drejtim të gjitha ministratë shtetërore të Mbretërisë jugosllave dhe organet e tjera, u angazhuan edhe më tepër në intensifikimin e serbizimit dhe kolonizimit sllavë të Kosovës dhe të shpërnguljes së shqiptarëve. U hartuan shumë plane e projekte konkrete.

Një propagandë e ashpër serbe kundër nënës shqiptare u zhvillua në vitet e tetëdhjeta dhe të nëntëdhjeta të shek. XX. Pas vitit 1981 në shënjestër të propagandës nacionaliste serbe u gjet nataliteti i madh i shqiptarëve, që u manifestua përmes dhunës ndaj shqiptarëve që atëherë (policët godisnin femrat shqiptare, studentet në gjenitalet e me kërcënimin morbid: “më s’do të lindësh separatistë” (1981); pastaj serbët tentuan që “shkencërisht” ta vërtetonin këtë tezë morbide, se kinse, shqiptarët i shfrytëzojnë gratë për numër enorm lindjesh (gratë lavartiçe) për synimet e tyre separatiste pa vullnetin e tyre. Gruan shqiptare e paraqitnin si injorante që nuk di asgjë tjetër, pos të prodhojë fëmijë. Kjo i çoi serbët drejt verbërisë nacionaliste, për të arritur deri te shqyerja e barkut të nënave shqiptare, madje edhe shtatzënave dhe vrasja në fund e pjellës së tyre. Kjo urrejtje ndaj femrës shqiptare u reflektua edhe në vrasje të shumta në luftën e vitit 1998-1999. Vrasjet ndaj femrave shqiptare ishin një atak vrashtar, jo vetëm në jetën dhe në integritetin fizik të femrës shqiptare, por edhe në nderin dhe dinjitetin moral e shpirtëror të saj dhe jo vetëm të saj, por

edhe të burrit e të fëmijëve të saj, të të afërmeve dhe të të njohurve të saj.

Gratë gjatë luftës ishin të rrezikuara në një formë tjetër nga meshkujt. Ato, përveç që në shumë raste janë vrarë, ato ishin dhunuar ose seksualisht keqtrajtuar. Në gjendje më të vështirë ishin gratë shtatzëna. Ato në shumë raste lindin në kushte të pazakonshme, në pyll, në stacion të trenit, duke pritur gjatë rrugës, në kalimet kufitare, etj., kështu që shumë foshnje të porsalindura vdisnin. Në disa raste për shkak të urrejtjes së madhe, gratë shtatzëna goditeshin në bark, ose ushtarët i vritnin ose ua nxirrnin frytin. Gratë në luftë u bënë një grup potencial i madh i frikës, kërcënimit, urisë, sakrificës, vrasjeve, dhunimeve dhe spastrimit etnik.

Sipas shënimeve me të cilat posedojmë, në periudhën janar 1998 deri më 12 qershor 1999, në Kosovë janë vrarë apo zhdukur 1673 femra, të moshave të ndryshme. Disa prej tyre kanë rënë edhe dëshmore.¹¹

- 1 Život i dela Kara-Đorđa i njegovi Vojvoda i junaka, I, reprint izdanje iz 1883, Beograd 1971, 171.
- 2 S. Sidki Hadžihuseinović Muvekkit, Povijest Bosne, knj. II, Sarajevo 1999, 770; E. Imamović, Historija bosanske vojske, Sarajevo 1999, f. 112.
- 3 V. Stefanović-Karadžić, Životi srpskih vojvoda, Beograd 1963, 71; Život i dela Kara-Đorđa i njegovi Vojvoda i junaka, I, reprint izdanje iz 1883., Beograd 1971, 171.
- 4 Bejtullah Destani, Muhaxhirët, Dosja britanike. Spastrimi etnik i Toplicës, Nishit, Prokuples, Kurshumlisë, Leskovcit e Vranjës 1878-1884, Prishtinë, 2019, f. 51-64.
- 5 Prof. dr. Hakif Bajrami, Shqiptarët dhe Kosova në rrjedha tragjike të historisë (1878-1999), Prishtinë, 2019, f. 81-82, 86.
- 6 Riza Lahu, Golgota shqiptare, Tiranë, 1995, fq. 43-44.
- 7 Leo Freudlich, Vjenë, 1913.
- 8 Dr. H. Bajrami, Konventa jugosllavo-turke për shpërnguljen e shqiptarëve, “Gjurmime albanologjike”, XII/1982.
- 9 Më gjerësisht: Dr. Jusuf Osmani, Lënda arkivore për kolonizimin dhe reformën agrare në Kosovë 1918-1941, Prishtinë, 1996.
- 10 Arkivi i Kosovës, F. Gjyqi i Rrethit Prizren, k.3, KPS-303-1936.
- 11 Jusuf Osmani, Krimet e Serbisë në Kosovë 1998-1999, Lib. i Parë, Prishtinë, 2011, f. 41-42.

Ëndrrat e Hafëz Ali Korçës për Shqipërinë

Ermal Bega

Këtë nëntor mbushen 112 vjet nga themelimi i shtetit shqiptar modern, ku burra të mëdhenj nga të gjitha trojet shqiptare u mbloodhën në qytetin e Vlorës për të shpallur themelimin e shtetit të përbashkët të shqiptarëve dhe bashkimit të tyre, ashtu siç kishin qenë gjatë sundimit të Sulltanatit Osman, por që një vit më pas, më 1913, nga Konferenca e Berlinit, tokat shqiptare u ndanë dhe përmes dhunës, terrorit, masakrave dhe gjenocidit, ato u gllabëruan nga fqinjët tanë të krishterë ortodoksë, grekët dhe sllavët (serbët, malazezët dhe maqedonas-bullgarët).

Në vitin 1924, atëbotë një djalosh i ri shqiptar, por me dije dhe vizion të madh, Hafëz Ali Korça, shkroi dhe botoi për herë të parë librin e tij me titull “Shtatë ëndrrat e

Shqipërisë”¹, të cilin më pas e plotësoi me disa shtesa dhe e ribotoi sërish në vitin 1944. Ky libër u bë fanari ndriçues për gjendjen e atëhershme të Shqipërisë, ku përmes poezive, në formë ëndrrash, ai shpjegonte gjendjen në të cilët ndodhej Shqipëria, çfarë e priste dhe se si mund të shpëtonte ajo nga ndonjë fatkeqësi e madhe për vendin dhe popullin tonë.

Botimi i parë i kësaj vepre të tij u bë pak vite pas një vepre tjetër monumentale të tij, me titull “Bolshevizma á çkatërrim për njerëzimin”, duke i bërë thirrje rinisë shqiptare që të mos i afrohen bindjeve bolshevike dhe komuniste të sjella në Shqipëri nga disa shqipfolës, të cilët donin shkatërrimin e shoqërisë sonë, e cila ashtu ndodhi më vonë.

Ëndrrat dhe vizioni i vetë Hafëz Ali Korçës për një Shqipëri të begatë e të fortë ishin të

Hafëz Ali Korça, krahas asaj që ishte një hoxhë, hafëz dhe dijetar mysliman, ai ka luftuar me armë në dorë për çlirimin e Shqipërisë dhe të trojeve shqiptare.



shumta dhe të larta. Pikërisht për këtë, në këtë shkrim do të tregojmë për disa nga ato ëndrra të tij, bazuar në librin e tij “*Shtatë ëndrrat e Shqipërisë*”, në të cilin ai ka përmendur vetëm shtatë ëndrra (përmes poezive) si edhe shtatë shpjegime (çprovime) të atyre ëndrrave. Ndërkohë, ëndrrat e Hafëz Ali Korçës për përparimin e Shqipërisë dhe të shqiptarëve në atë libër kanë qenë më shumë.

Hafëz Ali Korça, krahas asaj që ishte një hoxhë, hafëz dhe dijetar mysliman, ai ka luftuar me armë në dorë për çlirimin e Shqipërisë dhe të trojeve shqiptare.

Duke parë gjendjen e atëhershme politike të shqiptarëve, ai nuk donte t’i bashkohej ndonjë partie politike të hapur rishtazi, por dëshironte të dilte si një kandidat i pavarur, e më pas të krijonte një grup bashkë me shokët e tij dhe jo për kolltuk.²

Si një shqiptar idealist, ai ëndërronte dhe i këshillonte njerëzit që të zgjedhin dhe të vendosin në krye të tyre njerëz fetarë të drejtë, atdhetarë dhe trima që s’tremben prej askujt, të mirë dhe të drejtë, duke thënë se në administratë, në ushtri, nëpër shkolla, por edhe nëpër institucione fetare, nëse do të vendosen të pazotët, atëherë priteni kiametin.³ Në këtë mënyrë, ai e dinte se nëse në pushtet do të vinin njerëz të pagdhendur dhe kundër shqiptarëve, që mendonin vetëm për një kolltuk dhe pushtet, ata do ta shkatërronin qeverinë, vendin dhe vetë popullin shqiptar.

Gjuha shqipe dhe mësimi i saj në të gjitha shkollat shqiptare ku të gjithë fëmijët shqiptarë të mësonin në atë gjuhë, si dhe përdorimi i alfabetit latin, të cilin e përdorim sot si më të përshtatshëm për gjuhën tonë, ka qenë një ëndërr e Hafëz Ali Korçës, por për të cilën ai luftoi dhe u përpoq shumë, sidomos përmes pjesëmarrjes së tij në Kongresin e Dibrës dhe kërkesave më të rëndësishme që shtroi ai, ku për shkak të kësaj kërkesë ai u përndoq nga fetarët ekstremistë, nga vetë zyrtarë të shtetit osman, por edhe nga vendasit e tij prej atyre që hiqeshin si “atdhetarë” por që nuk e kuptonin dot diturinë dhe vizionin e tij.⁴

Një ëndërr tjetër e atij dijetari për përparimin e Shqipërisë si shtet ka qenë dhe hapja e një banke kombëtare përmes të hollave të grumbulluara nga kapitalistët shqiptarë.⁵ Ideja për këtë mendojmë se ka qenë që të ardhurat e shqiptarëve të

Dashuria për vatanin që dijetari i madh Hafëz Ali Korça e shfaqte në çdo vend dhe në çdo mënyrë, madje që në moshë të re, nuk kaloi pa pasoja në gjithë jetën e tij. Ai u ndoq nga shteti osman, nga ekstremistët shqiptarë, por edhe nga komunistët gjatë diktaturës, të cilët e burgosën e më pas e internuan atë në Kavajë ku edhe ndërroi jetë.

grumbullohen e të mbesin brenda në Shqipëri për ndërtimin dhe përparimin e vendit, si dhe për edukimin e brezave me besim e dituri, në mënyrë që të mos largohen nga këtu.

Hafëz Ali Korça përmes diturisë së lartë dhe urtësisë që i kishte dhënë Allahu i Madhëruar, mund të quhet edhe si një parashikues i së ardhmes së Shqipërisë dhe shqiptarëve, duke vendosur një afat prej 15-20 vjetësh që, nëse shqiptarët nuk do t’i dëgjonin këshillat e tij të shkruara në librin “*Shtatë ëndrrat e Shqipërisë*”, atëherë pas realizimit të tyre shqiptarët do të bëhen pishman, por nuk do t’u bëjë asnjë dobi.⁶

Ai e kishte parashikuar ardhjen e diktaturës dhe sistemit komunist që më herët pasi shkroi dhe librin “*Bolshevizma...*”, dhe për këtë arsye ëndrrat e tij dolën të vërteta dhe u plotësuan, por në librin “*Shtatë ëndrrat e Shqipërisë*”, përmes poezive dhe komentimit të tyre, ai tregon qartë errësirën e atij sistemi, i cili do të shkatërronte shqiptarët, prandaj i këshillonte që mos t’i afrohen atij sistemi.

Një ëndërr tjetër e madhe e Hafëz Ali Korçës ka qenë edhe gjendja e shqiptarëve në Kosovë dhe çlirimi i trojeve shqiptare të Kosovës nga thundra dhe terrori serbo-ortodoks, pas bombardimeve dhe masakrave të mëdha që serbët bënë ndaj shqiptarëve atje ditën e Kurban Bajramit ndaj burrave në xhami, në qershor të vitit 1924. Për këtë ndodhi, si i ri ai shkroi edhe një poezi me titull “Vajtimet e atdheut”, të cilën e botoi në revistën “Zani i Naltë” në Tiranë, vëllimi i parë, nr. 11, f. 349, të cilën e përfshiu edhe në librin e tij “*Shtatë ëndrrat e Shqipërisë*”.⁷

Gazetari Ermir Hoxha, në shkrimin e tij me titull “Shtatë profecitë e një të urti”⁸, poezitë (ëndrrat) e Hafëz Ali Korçës së bashku me komentimin e tyre po me poezi, i quan si “një rast të rrallë në letrat shqipe”. Ai ka të drejtë

për këtë, pasi nuk njihet ndonjë autor apo shkrimtar tjetër shqiptar që të ketë bërë diçka të tillë në letërsinë shqipe, duke komentuar një poezi po me poezi.

Dashuria për vatanin që dijetari i madh Hafëz Ali Korça e shfaqte në çdo vend dhe në çdo mënyrë, madje që në moshë të re, nuk kaloi pa pasoja në gjithë jetën e tij. Ai u ndoq nga shteti osman, nga ekstremistët shqiptarë, por edhe nga komunistët gjatë diktaturës, të cilët e burgosën e më pas e internuan atë në Kavajë ku edhe ndërroi jetë.



Këto vuajtje, duke vënë në rrezik veten dhe familjen e tij, ai i shpreh gjithashtu përmes vargjeve poetike:

*Për atdhenë kush përpiqej,
nga shteti kësisoj ndiqej,
internohej e burgosej,
rraskapitej, handakosej.⁹*

Si edhe me këto vargje:

*Për Shqipërinë u përpoqa,
rrezikova jetën time,
nuk rrëfëhet se sa hoqa,
se shteti m'i njihte krime.¹⁰*

SA TË VLEFSHME JANË SOT “ËNDRRAT” E HAFËZ ALI KORÇËS PËR SHQIPËRINË DHE SHQIPTARËT?

Pas internimit të Hafëz Ali Korçës nga komunistët, jeta e tij ndryshoi nga sistemi diktatorial dhe kontributet e tij u zbehën, por ato vepra që ai kishte shkruar më herët bënë jehonë të madhe në popullin shqiptar, dhe ende bëjnë, duke na treguar se ëndrrat e tij për Shqipërinë, të fuqishme nga ana politike dhe ekonomike, të pavarur, me drejtues të ditur, të drejtë, besimtarë e të sinqertë, janë ende të vlefshme edhe sot, pasi Shqipëria dhe shqiptarët sundohen nga njerëz jo të drejtë dhe të sinqertë, por nga njerëz pa vlera dhe kontribute të vërteta e të dobishme për shoqërinë shqiptare.

Ndërkohë që Hafëz Ali Korça i bënte thirrje rinisë që mos t'i afrohej parimeve dhe sistemit komunist, shumë prej tyre nuk i dëgjuan këshillat e tij por u bashkuan me ta dhe më pas krijuan diktaturën politike ndaj vetë popullit të tyre. Por, pikërisht nga të tillë zyrtarë shqipfolës të edukuar ende prej

asaj fryme politike komuniste, qoftë në Shqipëri qoftë në Kosovë, shumë shqiptarë sot po detyrohen që të largohen nga vatrat tona për një jetë më të mirë jashtë vendit, duke e braktisur atdheun.

Kohët e fundit, Shqipëria zyrtare, përmes pushtetarëve të saj sot, është futur në një qorrsohak nga i cili e ka të vështirë të dalë. Ajo sot njihet si një narko-shtet, duke qenë një nga vendet më të njohura në botë për trafikimin e drogës. Gjithashtu, edhe pse zyrtarët pretendojnë se janë rritur pagat dhe mirëqenia në çdo aspekt, në të njëjtën kohë korrupsioni ka hyrë shumë thellë në çdo ambient pune, qoftë nëpër ministri, institucione të ndryshme, spitale, shkolla, etj.. Në këtë mënyrë, shqiptarët sot nuk edukohen se si të bëhen njerëz të ditur, të edukuar, të respektueshëm, të ndershëm, besimtarë, të pastër, të sinqertë dhe të dashur, por edukohen me kundërvlera të cilat janë të dëmshme për vetë ata, familjarët e tyre dhe për mbarë shoqërinë shqiptare. Prandaj edhe sot shohim nëpër televizione shumë vrasje, vjedhje dhe grabitje e mashtrime nga më të ndryshmet që as mendja nuk i pranon dot.

Do të duhej një kohë e gjatë që të vijë një brez i ri me shqiptarë të ditur e të ndershëm, të cilët do të mendojnë se sa të nevojshme kanë qenë ëndrrat e Hafëz Ali Korçës, qoftë për kohën e tij ashtu edhe për ne sot.

Vetëm Allahu i Madhëruar e drejtoftë popullin tonë dhe e mundësoftë që këshillat e dijetarit të madh Hafëz Ali Korça përmes “ëndrrave” të tij të vendosen sot në praktikë që shqiptarët të përparojnë me drejtësi.

- 1 Që nga viti ۱۹۴۴ ky libër i Hafëz Ali Korçës, ashtu si dhe shumë vepra të tjera të shkruara prej tij gjatë kohës sa ishte gjallë, nuk u lejuan të botohen sërish që nga ardhja e sistemit diktatorial komunist në Shqipëri në vitin 1945, por autori i këtij shkrimi pas disa studimeve që ka bërë pas viteve 1990, kur erdhi demokracia dhe u rikthye liria e besimit, ndër shumë botime të tij e gjeti dhe këtë dhe u mor me ribotimin e tyre, kur kjo vepër u botua sërish në Tiranë nga Ermal Bega, fillimisht në vitin 2006, pastaj në vitin 2012 (me rastin e 100-vjetorit të shtetit shqiptar), e tani sërish në vitin 2024.
- 2 Hafiz Ali Korça, *Shtatë ëndrrat e Shqipërisë*, Qendra Shqiptare për Studime Orientale, Tiranë, 2024, f. 10.
- 3 Hafiz Ali Korça, *Shtatë ëndrrat e Shqipërisë*, Qendra Shqiptare për Studime Orientale, Tiranë, 2024, f. 12.
- 4 Për këtë ju këshillojmë të lexoni librin “Kongresi i Dibrës dhe Hafiz Ali Korça” të shkruar nga Abdyl Ypi, të botuar nga Qendra Shqiptare për Studime Orientale, Tiranë 2024.
- 5 Hafiz Ali Korça, *Shtatë ëndrrat e Shqipërisë*, Qendra Shqiptare për Studime Orientale, Tiranë, 2024, f. 13.
- 6 Hafiz Ali Korça, *Shtatë ëndrrat e Shqipërisë*, Qendra Shqiptare për Studime Orientale, Tiranë, 2024, f. 13.
- 7 Hafiz Ali Korça, *Shtatë ëndrrat e Shqipërisë*, Qendra Shqiptare për Studime Orientale, Tiranë, 2024, f. 115.
- 8 Gazeta “Shqip”, Tiranë, 23 nëntor 2006.
- 9 Hafiz Ali Korça, *Shtatë ëndrrat e Shqipërisë*, Qendra Shqiptare për Studime Orientale, Tiranë, 2024, f. 43.
- 10 Hafiz Ali Korça, *Shtatë ëndrrat e Shqipërisë*, Qendra Shqiptare për Studime Orientale, Tiranë, 2024, f. 46.

Vështrim mbi mendimin e Ukshin Hotit

DISA KARAKTERISTIKA NGA PERSPEKTIVA TEORIKE E UKSHIN HOTIT
PËR ÇËSHTJEN SHQIPTARE

MA. Blerim Halili

HYRJE

Mendimet e intelektualëve shqiptarë të Kosovës në periudhën e shpërbërjes së Jugosllavisë përbëjnë një trashëgimi të vlefshme për të kuptuar jetën shoqërore dhe politike të periudhës dhe kontekstit socio-historik brenda të cilit ata kanë jetuar. Jeta brenda një realiteti të tensionuar politik dhe etnik në një shoqëri, që ka probleme themelore të mbijetesës dhe sigurisë, çfarë ishte, me rënie e ngritje, ajo e periudhës që prej Luftës së Dytë Botërore e deri në vitet '90, domosdoshmërisht do të ketë bërë që ajo të lë gjurmë të pashlyeshme, si në rrugëtimin intelektual e jetësor, ashtu edhe në fushën e interesit dhe natyrën e problemeve që ata kanë trajtuar. Këtu qëndron edhe ndërlidhja e formimit intelektual me idealet kolektive të lirisë, drejtësisë dhe barazisë, kur ata (një pjesë e tyre) identifikohen me interesin kolektiv të kosovarëve. Prandaj vepra e këtyre intelektualëve ka rëndësi të dyfishtë, nga njëra anë ajo ngre një tablo të qartë biografike dhe

intelektuale për emra të përveçëm mendimtarësh përparimtarë, e, nga ana tjetër, brenda saj portretizohet në mënyrë të thellë e dinamike thellësia dhe kompleksiteti i problemeve kolektive, socio-politike, ekonomike dhe etnike në Kosovën si pjesë e Federatës Jugosllave.

Ndonëse opusi kulturor i opinionit kosovar ka rënë shpesh pre e një game interpretimesh hiperbolizuese dhe pothuajse mitologjike e të pabazuara në idetë progresive të mendimit modern (pa dashur të zvogëlohet rëndësia e rolit të rrëfimeve kolektive në mbajtjen gjallë të frymës triumfuese) për veten dhe kombin, disa intelektualë kosovarë të kësaj periudhe marrin orientim krejt të kundërt me këtë. Me qasjen e tyre racionale dhe shkencore, ata arrijnë të artikulojnë mjeshtërisht problemin shqiptar në Kosovë nga perspektiva historike, sociologjike dhe politologjike. Një nga këta intelektualë pa dyshim është edhe Ukshin Hoti. Ani pse Hoti nuk arriti të lë trashëgimi të madhe intelektuale në sasi, ajo vepër që ka lënë përbën jo vetëm një referencë me vlerë të madhe për problemet e kohës, por edhe një identitet politik e ideor që jeton edhe sot e kësaj dite ndër shqiptarët e Kosovës.

ANALIZA DEMOGRAFIKE E POPULLIT SHQIPTAR

Ukshin Hoti ka shtjelluar dhe interpretuar realitetin politik dhe etnik në Kosovë nga perspektiva teorike moderne, duke i dhënë atij një tablo të tërë vështrimi racional e kritik. Teksa shpjegon problemet etnike në Kosovë, ai domosdoshmërisht merret me çështjet demografike, me numrin dhe karakteristikat e popullsisë që ishin subjekt i përplasjes politike dhe etnike në Ballkan. Duke shtjelluar problemin shqiptar,





vëmendje e veçantë i kushtohet strukturës demografike të shqiptarëve. Kështu teksa çështjen shqiptare e kundron nga perspektiva demografike, Hoti vë në dukje se shqiptarët janë një popull relativisht i vogël, por nga aspekti antropologjik janë një popull mesatar ose relativisht i madh.¹ Më tutje ai thekson se shqiptarët jetojnë dendur në një gjeografi kompakte në Shqipëri dhe në rajonet jugore të Jugosllavisë (në Kosovë, në Maqedoninë Perëndimore, në Serbinë Jugore - Preshevë dhe Bujanoc dhe në Mal të Zi). Sipas tij, rajonet shqiptare në Jugosllavi konsiderohen gjeografikisht kompakte. Praninë shqiptare në Ballkan ai e lexon jo vetëm nga aspekti demografik e statistikor, por edhe nga këndvështrimi historik, etnik e administrativ. Administrativisht dhe politikisht, shton ai, ata jetojnë në vendlindjen e tyre, në Shqipëri si shtet-amë, dhe në katër republika: Serbi, Maqedoni, Kosovë dhe Mal të Zi. Sipas statistikave, shqiptarët në Jugosllavi përbëjnë 40% të numrit të përgjithshëm të shqiptarëve kudo në botë. Por në fakt shumica e shqiptarëve jetojnë jashtë atdheut të tyre, Shqipërisë. Ky fakt, sipas tij, ka rëndësi politike për shqiptarët, është shumë i rëndësishëm edhe për politikën globale të fuqive evropiane.²

Por përveç analizës së popullsisë shqiptare që jeton në Ballkan dhe karakteristikave të tyre, Hoti një vëmendje të veçantë ua kushton shqiptarëve të shpërndarë nëpër vende të

Sipas tij, rajonet shqiptare në Jugosllavi konsiderohen gjeografikisht kompakte. Praninë shqiptare në Ballkan ai e lexon jo vetëm nga aspekti demografik e statistikor, por edhe nga këndvështrimi historik, etnik e administrativ.

ndryshme të botës për shkak të emigrimeve. Ai vë në pah se përveç Ballkanit, që është gjeografia e rrënjëve të tyre, shqiptarët më së shumti migruan në Turqi. Ai shton se edhe pse ka vlerësime të ndryshme për numrin e shqiptarëve në Turqi, nuk ka të dhëna të sakta statistikore. Arsyeja më e rëndësishme për këtë është se në regjistrimet e bëra në Turqi, vë në dukje ai, ata që nuk e identifikojnë veten si turq llogariten ose si të tjerë ose si ardhacakë. Pavarësisht kësaj, ai thekson se mendohet se në Turqi jetojnë më shumë se 1 milion (1.2 milion) shqiptarë që kanë ndërgjegje kombëtare, flasin shqip dhe janë të gatshëm të mbrojnë interesat e tyre kombëtare. Sipas Hotit, ekziston edhe një fakt tjetër sociologjik, që e vështirëson përcaktimin e numrit të shqiptarëve dhe kjo është feja. Prandaj, shqiptarët në Turqi nxjerrin në pah identitetin e tyre fetar kur prezantohen dhe kjo përbën një element që e vështirëson evidentimin e saktë të përkatësisë kombëtare.³

Në tablonë që ofron Hoti, vende të tjera ku shqiptarët jetojnë dendur janë Evropa Perëndimore, Amerika dhe Australia. Shqiptarët në Amerikë njihen për lobin që kanë krijuar dhe aktivitetet që kryejnë përmes këtij lobi. Duke vlerësuar rolin e botës së diasporës shqiptare në kërkimin e zgjidhjes së problemit të Kosovës, Hoti thekson rolin e shqiptarëve në Evropë, Australi dhe Turqi. Megjithatë, pavarësisht këtyre roleve dhe peshës së

shumanshme që ka kjo diasporë, Hoti mendon se diaspora shqiptare nuk mund të jetë pioniere e politikës mbarë shqiptare. Nga ana tjetër, shton ai, për shkak të sistemit juridik ndërkombëtar, rrezikut të ndërhyrjes në konstelacionin ndërkombëtar dhe cenimin e normave të vendosura, as Shqipëria nuk mund të jetë bartëse e kësaj politike.⁴

ZGJIDHJA E ÇËSHTJES SHQIPTARE BREND KONTAKSTIT EVROPIAN

Formimi i ideve politike dhe teorike të Ukshin Hotit ndodhi në kushtet komplekse politike dhe shoqërore të përjetuara në Kosovë gjatë periudhës jugosllave. Bindjet e tij politike përkritazi me zgjidhjen e çështjes shqiptare formësohen rreth orientimit euro-perëndimor. Ai nuk ndërton imazhe romantike e mitologjike për bashkimin kombëtar, por duke njohur proceset politike në kontinentin evropian dhe në bashkësinë politike evropiane, Kosovën e vë në kuadër të atyre proceseve si një ecuri e pashmangshme integrimi dhe zhvillimi. Kosova në kontekstin politik dhe ekonomik në mendimin e Hotit vendoset në kuadrin e zhvillimit rajonal dhe kontinental. Pra, pikëpamja e tij për zgjidhjen e çështjes shqiptare bazohet në një të ardhme në kontekstin evropian. “Dhe, zgjidhja e drejtë e çështjes shqiptare është bashkimi i tyre në kontekst të proceseve integrative të Evropës. Sot asnjë faktor i pjekur politikisht nuk mund ta kontestojë.”⁵

Maturia në kalkulimin e pasojave eventuale që mund të shkaktohen gjatë realizimit të vullnetit dhe kërkesave të kosovarëve ishte një karakteristikë tjetër e mendimit të Hotit. Sipas tij zgjidhja duhet të adresohet në mënyrë që të mos kërcënojë paqen, ekuilibrin dhe fokusin politik global. Sipas tij, është e mundur të krijohen dy skenarë të mundshëm për bashkimin e shqiptarëve: a) Bashkimi që do të bëhet në kuadër të procesit të integritetit evropian dhe nën drejtimin e Gjermanisë (sipas skenarit të bashkimit gjerman), b) Bashkimin nëpërmjet Shqipërisë. Megjithatë, të dy këta skenarë do të minimizonin rolin e faktorit shqiptar në Kosovë. Hoti është i vetëdijshëm se zgjidhja “Republika e Kosovës” mund të jetë vetëm një zgjidhje e pjesshme e problemit shqiptar, ngase ajo është vetëm një hap drejt realizimit të projekteve të tjera unifikuese dhe emancipuese. Duke marrë si shembull bashkimin e gjermanëve, Hoti

Na duhet bashkërisht një unitet i madh, siç jemi mësuar ta kemi në mesin e teologëve, imamëve e nëpunësve të Bashkësisë Islame, e me këtë unitet do t’ia dalim të korrim suksese të reja dhe do të punojmë për një të ardhme sa më të mirë të vendit tonë në edukimin dhe fisnikërimin e mirëfilltë të mësimeve fisnike islame.

mendon se bashkimi i tyre nuk duhet të konsiderohet me ndjenja antisovjetike, apo si një hap kundër Bashkimit Sovjetik. Në këtë kontekst, ai nuk e sheh as Republikën e Kosovës dhe as bashkimin e shqiptarëve (në kuadër të procesit të integritetit evropian) si një hap që duhet bërë kundër dikujt, por vetëm si të drejtë themelore të këtij kombi. Sipas Hotit, formimi i Republikës nuk duhet parë si fitore e një kombi ndaj një kombi tjetër, por si realizim i barazisë dhe mundësi që secili të jetë vetvetja. Sipas tij, njohja *de jure* e Republikës së Kosovës nuk do t’i bëjë serbët një shoqëri më të vogël dhe as shqiptarët një shoqëri më të madhe. Në fakt, ata do të jenë ashtu siç janë. Lidhur me bashkimin e të gjithë shqiptarëve në një shtet, Hoti thekson se ky bashkim nuk duhet të perceptohet si shfaqje pushteti, por si e drejtë e shqiptarëve.⁶

REPUBLIKA E KOSOVËS SI NEVOJË DHE DOBI E PËRBASHKËT

Hoti, i cili e sheh nevojën për të përparuar së bashku me vendet e tjera, thekson se Kosova duhet të bëhet shtet (Republikë), ngase kjo përbën interes dhe dobi edhe për palët e tjera. Sipas tij, kjo luftë politike në përmbushjen e të drejtave legjitime nisi nga kjo nevojë për zhvillim. Në të njëjtën kohë, ai nuk e mohon se edhe serbët kanë nevojë për një zhvillim të tillë. Përkundrazi, bërja e Kosovës shtet (Republikë) nënkupton përfundimin e marrëdhënieve të bazuara në dëshirën për dominim ndërmjet këtyre dy kombeve, të cilat janë pothuajse të njëjta për nga numri i popullsisë, niveli i zhvillimit, vendndodhja historike dhe gjeografike dhe duke mos lejuar që ato të instrumentalizohen

më tej, duke krijuar kështu një marrëdhënie cilësore mes tyre. Madje ai tërheq vërejtjen se nëse Republika e Kosovës nuk perceptohet si një mundësi kundër instrumentalizimit dhe në të mirë të shqiptarëve dhe serbëve, do të ketë kthim në mesjetë dhe në faqet e përgjakshme të historisë.⁷

MBI NGJARJET E VITIT 1981

Një vëmendje të veçantë në mendimin politik të Hotit zënë edhe ngjarjet e vitit 1981 në Kosovë, të cilat ai i interpreton si zgjim të kosovarëve dhe marrje e fatit në duart e tyre. Sipas tij, Shqipëria dhe Jugosllavia ishin të paafta ta zgjidhnin dhe ta merrnin parasysh vullnetin e kosovarëve, prandaj kosovarët vendosën ta merrnin në dorë fatin e vet.⁸ Bindjet e



tij dhe përkrahjen për demonstratat e vitit 1981 Hoti do t'i paguante rëndë me ndëshkime të ashpra nga aparati shtetëror serb. Duke e cilësuar politikën si veprimtari të rregullimit dhe përmirësimit të gjendjes shoqërore, Hoti thotë se për ngjarjet e vitit 1981, kërkesat e shqiptarëve në Kosovë kanë shkuar përtej autonomisë. Pozicioni politik i Kosovës nuk është më vetëm në nivelin e një krahine autonome, por në nivelin e dëshirës për një republikë të barabartë me republikat e tjera në Jugosllavi. Por ajo që i bën të veçanta këto ngjarje dhe këtë pikë thyerjeje është zgjimi i shqiptarëve në Kosovë. Shqiptarët e Kosovës, të cilët kanë hequr dorë nga shpresa për Shqipërinë dhe Jugosllavinë, të cilat ishin të paafta për ta zgjidhur problemin e Kosovës, tani kanë filluar të lëvizin vetëm, por me këmbëngulje, drejt Evropës.

Përveç situatës politike në Kosovë, Hoti vlerëson edhe gjendjen morale dhe shpirtërore të popullit. Duke u identifikuar tërësisht me aspiratat politike të kosovarëve, ai shndërrohet në zëdhënës shkencor dhe interpretues sistematik i nevojave dhe gjendjes së tyre. Madje situatën e përshkruan si të rëndë, duke theksuar se Kosova zyrtarisht nuk është në luftë, është nën okupim, dhe se ajo u deklarua si shtet, por ende nuk është organizuar (edhe pse do të organizohet në të ardhmen). "Situata morale e njerëzve është shumë e rëndë".⁹

PËRFUNDIMI

Mendimi i Hotit për ngjarjet politike në Kosovë dhe zgjidhjet e problemeve etnike në rajon ka një rëndësi jetike për të kuptuar kompleksitetin e proceseve në rajon. Mbështetja e kërkesave dhe aspiratave të kosovarëve për Kosovën Republikë përmes argumenteve teorike shkencore përbën karakteristikën kryesore të mendimit të tij. Leximi i problemit shqiptar nga perspektiva historike përbën një element tjetër karakteristik për argumentin e tij teorik e politik. Nga ana tjetër, zgjidhjet që rekomandon ai shtresohen

rreth kontekstit rajonal e kontinental, duke bërë kështu kontekstualizimin e çështjes shqiptare brenda proceseve integruese rajonale dhe kontinentale. Qasja e bazuar në premisa universale të lirisë dhe barazisë po ashtu e shquan mendimin e Ukshin Hotit. Kështu edhe vetë vullnetin e kosovarëve për Republikë ai e interpreton si nevojë të pashmangshme për vendosjen e barazisë, duke shtuar se ajo nuk do të shkaktonte konflikte të thella etnike, do të ishte zgjidhja më e përshtatshme për të gjitha palët, dhe do të shpëtonte si shqiptarët ashtu edhe serbët nga instrumentalizimi për interesat e fuqive të huaja. Në këtë kuadër, pika e kthesës sipas tij ndodhi në vitin 1981, i cili e ndryshoi historinë.

Përmes qasjes së tij Hoti shpesh arrin t'i paraprijë dhe t'i parashikojë shumë zhvillime të cilat ndodhën në vitet e dekadat vijuese. Kjo dëshmon për thellësinë e mendimit të tij, njohjen sistematike të teorive bashkëkohore dhe kontekstit kosovar, por edhe forcën e idealit me të cilin identifikohet dhe për hir të të cilit u sakrifiku. Si përfundim mendimi i Ukshin Hotit përbën një trashëgimi të vlefshme teorike dhe politike për studiuesit dhe për idetë e konceptet e veprimit politik në Kosovë, trashëgimi e cila përveç ideve shkencore përbrendëson edhe principet e vlerat më të larta morale e civilizuese.

1 Shih: Ukshin Hoti, *Filozofia politike e çështjes shqiptare*, Unikomb, Prishtinë, 1997, f. 73.

2 Shih: Ibid, f. 74.

3 Shih: Ibid, f. 75.

4 Shih: Ibid, f. 77.

5 Ibid, f. 87.

6 Shih: Ibid, f. 90-91.

7 Shih: Ibid, f. 91.

8 Shih: Ibid, f. 25.

9 Ibid, f. 44.

“Dr. Rexhep Boja – prijës, vizionar dhe burrështetas i shquar”

Të premten dhe të shtunën e datës 18, respektivisht 19 tetor, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës mbajti Konferencën shkencore kushtuar ish-myftiut, prijësit, pedagogut e ambasadorit tonë të shquar, dr. Rexhep Bojës, të titulluar “Dr. Rexhep Boja – prijës, vizionar dhe burrështetas i shquar”.

Kësaj Konference i parapriu mbledhja e Këshillit organizativ, e cila u mbajt më 7 tetor 2024, nën kryesimin e Myftiut Naim ef. Tërnavë. Aty u shqyrtuan përgatitjet përkitazi me organizimin e kësaj Konference.

Konferenca mbledhi rreth vetes akademikë, studiues, personalitete fetare dhe politike nga vendi dhe rajoni, të cilët nderuan dhe shpalosën veprën dhe trashëgiminë e pasur të ish-myftiut dr. Rexhep Boja.

Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, reisul ulema i BFI-së së RMV-së, Shaqir ef. Fetahu, ish-sekretari i OBI-së, Ekmeleddin Ihsanoglu, ish-presidenti i Kosovës, Fatmir Sejdiu, ish-kryeministri Agim Çeku, ish-ministri i Punëve të Jashtme, Enver Hoxhaj, ishin vetëm disa prej të pranishmëve, të cilët vlerësuan lart kontributin dhe angazhimin e dr. Rexhep Bojës në fusha dhe dikastere të ndryshme, në të cilat ai qe udhëheqës. Ndërkaq, me prezencën e tyre këtë Konferencë e nderuan edhe kryetari i Komunës së Prishtinës, z. Përparim Rama, kryetari i Komunës së Klinës, z. Zenun Elezaj, ambasadori i Turqisë, z. Tunç Angili, përfaqësuesja

e Ambasadës së Amerikës, znj. Brooke Young, si dhe personalitete të tjera.

Në fjalën e tij hapëse, Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, theksoi se veprimtaritë e dr. Bojës janë gjurmë të pashlyera në historinë e Islamit, duke potencuar kështu edhe përgjegjësinë dhe profesionalizmin që e shoqëronin dr. Bojën. “Veprat e Myftiut Boja janë gjurmë të pashlyera në historinë e Islamit dhe të Kosovës. Çdo detyrë dhe përgjegjësi që iu besua, doktori e përmbushi me përgjegjësi dhe profesionalizëm, me qetësi dhe urtësi. Edhe si imam, edhe si profesor në Medrese dhe FSI, por edhe si dekan e myfti, ishte një model për brezin e ri.”



Ai gjithashtu shtoi se: “Në vitet e 90-ta, dr. Rexhep ef. Boja, me vizionin dhe urtësinë e tij, e udhëhoqi Bashkësinë Islame drejt pavarësisë dhe mëvetësisë në një periudhë të vështirë për vendin. Puna e Bashkësisë Islame në krye me Rexhep Bojën ishte shumë vizionare për një mbijetesë të imponuar prej okupuesve, por edhe me ndjenjën dhe motivimin e vazhdueshëm dhe përpjekjet për çlirim. Me punën tonë dhe me porositë e dr. Rexhep Bojës, puna e Bashkësisë Islame kishte përfshirë të gjitha segmentet dhe fushat e jetës. Aty ku ishte populli, aty ishte Bashkësia Islame.”

Reis ulema i Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë së Veriut, hfz. Shaqir ef. Fetahu, në fjalën e tij tha: “Sot është një ditë e madhe, sepse jemi tubuar nga të gjitha anët për ta përkujtuar personalitetin e madh të kombit, imamin, profesorin, dekanin, myftiun, diplomatit dhe shkencëtarin, prof. dr. Rexhep Boja. Ta përkujtosh këtë personalitet me një Konferencë kaq të madhe do të thotë t’i qasemi nga të gjitha aspektet, atë moral, shkencor, patriotik, kombëtar dhe diplomatik.”



Përfaqësuesi i presidentes së Kosovës, znj. Vjosa Osmani, z. Bekim Kupina, vlerësoi lart angazhimin përtej sferës fetare të dr. Rexhep Bojës. “Puna e dr. Rexhep Bojës shtrihej edhe përtej sferës fetare. Ai ishte një njeri thellësisht i përkushtuar ndaj çështjes kombëtare dhe vlerave kombëtare, andaj pati rol aktiv në lëvizjen e pajtimit të gjaqeve në fillim të viteve 1990. Në kohën kur nevoja për unitet ishte e jashtëzakonshme dhe gjakmarrja po rrezikonte pëmbushjen e kauzës sonë për liri dhe shtet, ai, me një grup patriotësh, u shfaqën me lëvizjen e pajtimit. Ai ishte, krahas udhëheqësve të tjerë fetarë myslimanë e katolikë, por edhe intelektual të të gjitha profileve, studentë të rinj, të cilët kontribuan për pajtim ndërmjet familjeve në gjak, duke ringjallur shpresën dhe duke shëruar plagët” – tha ndër të tjera z. Kupina.

Ai gjithashtu njoftoi të pranishmit, se presidentja e Kosovës, znj. Vjosa Osmani, do ta dekorojë Myftiun Boja

për kontributin e tij të jashtëzakonshëm me medalje presidenciale.

Këtë Konferencë, me prezencën e tij e nderoi edhe ish-sekretari i OBI-së, z. Ekmeleddin Ihsanoglu, i cili e kujtoi dr. Bojën si një fytyrë të buzëqeshur të Kosovës në botën myslimane, një njeri të moderuar dhe gojëmbël.

“Ishin ditë të vështira kur federata jugosllave po shpërbëhej dhe shtete të pavarura po dilnin nga konfliktet dhe luftërat etnike dhe fetare që filluan në vitin 1991. Ishte fati i Kosovës që në të njëjtin vit dr. Boja u zgjodh kryetar i Bashkësisë Islame të Kosovës, apo thënë më mirë myfti i Kosovës. Në këto vite të trazuar, ai ishte fytyra e buzëqeshur e Kosovës në botën myslimane, një njeri i moderuar, gojëmbël. Njohja e mirë e gjuhës arabe, përveç talenteve të tjera, e bëri atë një folës elokuent që ishte një vizitor i mirëpritur në shumë vende arabe. Në Turqi dhe veçanërisht në Stamboll ai nuk ishte një i huaj, ai ishte një prej nesh.”

Ish-presidenti i Kosovës, dr. Fatmir Sejdiu, vlerësoi dhe çmoi lart figurën e dr. Rexhep Bojës, duke e cilësuar atë si një njeri që e ndiente peshën e kohës dhe përgjegjësisë, të cilën duhet ta barte. “Ky ishte një tipar i jashtëzakonshëm i dr. Bojës. Me të njëjtin përkushtim e gjeja çdoherë edhe në takimet e shpeshta me të. Ai fokusohej sidomos në shfrytëzimin e botës islame për njohjen e Kosovës. Me këto përpjekje që i kishim, pas njohjes së sovranitetit dhe integritetit të Kosovës së pavarur, në cilësinë e presidentit, e pata caktuar të ngarkuar me punë në Riad, e më vonë ai do të dekretohej ambasador fuqiplotë i Republikës së Kosovës në Riad. Ishte një ambasador i mirë dhe shumë i përgjegjshëm, e njëjti mirë botën arabe, ndërsa këshillat e tij ishin të pjekura dhe me shumë peshë” – vlerësoi dr. Sejdiu.

Për diplomacinë e dr. Rexhep Bojës në arenën ndër-kombëtare, foli edhe ish-ministri i Jashtëm, z. Enver Hoxhaj, i cili tha se dr. Boja i plotësonte disa parakushte për të qenë i suksesshëm në mandatin e tij shoqëror, por edhe shtetëror.

“Së pari ishte një intelektual i përgatitur dhe njëjti mirëfilli mënyrën e të menduarit në Lindje të Mesme. Ai arriti që botës arabe t’ia shpjegojë drejt dhe në thelb çështjen e Kosovës qoftë si çështje për liri, por edhe si shtet i pavarur. Së dyti, jo vetëm karriera e tij, por edhe karakteri i tij dhe besimi i tij politik në kauzën e drejtë të Kosovës për liri dhe pavarësi, së bashku me sjelljet që i ka pasur dhe me gjykimet shumë të qarta, e bënë atë të jetë në qendër të vëmendjes. Dhe së treti, rrallëherë kam takuar një njeri me aq vullnet të pathyeshëm dhe me plot iniciativë, dhe përtej asaj që ka qenë një intelektual i madh, ka qenë edhe një njeri i madh i veprimit” – tha ndër të tjera z. Hoxhaj.

Një fjalë rasti në hapje të kësaj Konference mbajti edhe nënkryetari i Komunës së Obiliqit, z. Arben Berisha, i cili njoftoi të pranishmit se për nder të kontributit të tij të çmuar



dhe ndikimit të madh që ka pasur në komunitetin tonë, Kuvendi Komunal i Obiliqit, ka vendosur që të nderojë figurën patriotike të dr. Bojës, duke emëruar një rrugë në qytetin e Obiliqit, afër Xhamisë së Madhe në qytet, me emër të Rexhep Bojës. “Ky akt simbolik, krahas veprave, është një shprehje mirënjohjes dhe nderimesh të përhershme për rolin dhe veprën e tij të pazëvendësueshme kombëtare” – tha nënkryetari Berisha.

Në emër të familjes Boja, këtë Konferencë e përshëndeti djali i dr. Rexhep Bojës, z. Muhamed Boja, i cili shprehu krenarinë e tyre për dr. Bojën, duke veçuar atë si një model për jetë: “Myftiu Boja sot bënë krenarë familjen e tij, të cilët kanë shembullin më të mirë të një diplomati, besimtari dhe atdhetari.”

Konferenca vazhdoi punimet të shtunën, më 19 tetor, ndërsa temat të cilat u trajtuan ishin:

Ramadan Shkodra, “*Rrugëtimi jetësor i Myftiut Rexhep Boja (prijës shpirtëror, vizionar e diplomat)*”; Sabri Bajgora, “*Angazhimi i dr. Rexhep Bojës në avancimin e jetës fetare në Kosovë gjatë viteve të '90-ta*”; Dr. Hysen Matoshi, “*Simbioza fetare-atdhetare e dr. Rexhep Bojës*”; Dr. Agim Zogaj, “*Vizioni politik dhe kombëtar i dr. Rexhep Bojës*”; Dr. Enver Hoxhaj, “*Dr. Rexhep Boja – një shembull historik diplomatik në përfaqësimin e Kosovës në Lindje të Mesme*”; Dr. Sylë Ukshini, “*Dr. Rexhep Boja – një model i liderizimit*”; Agim Çeku, “*Profesor Rexhep Boja, dijetar, burrështetas, diplomat dhe personalitet me vetëdije të lartë kombëtare e fetare*”; Rexhep Elezaj, “*Kontributi i dr. Rexhep Bojës në diplomacinë e Kosovës*”; Resul Rexhepi, “*Kujtime për dr. Rexhep Bojën*”; Hfz. Arif ef. Emini, “*Si e njoha dr. Rexhep Bojën*”; Ahmet Sadriu, “*Dr. Rexhep Boja, model i prijësit shpirtëror*”; Dr. Ferid Agani, “*Dr. Rexhep Boja – prijës fetar dhe burrështetas*”; Dr. Fahrush Rexhepi, “*Marrëdhëniet e Bashkësisë Islame të Kosovës me institucionet shtetërore në kohën e dr. Rexhep Bojës*”; Zymer Salihu, “*Roli i Myftiut të Kosovës, dr. Rexhep Boja në ngritjen e çështjes kombëtare në arenën ndërkombëtare*”; Elez Osmani, “*Koegzistenca*

ndërfetare në mendimin dhe praktikën e dr. Rexhep Bojës”; Besa Ismaili, “*Kontributi i dr. Rexhep Bojës për harmoninë dhe bashkëjetesën ndërfetare*”; Dr. Sadik Mehmeti, “*Veprimtaria arsimore-pedagogjike e dr. Rexhep Bojës*”; Dr. Islam Hasani, “*Dr. Rexhep Boja, iniciues e (dekan) udhëheqës i parë i FSI-së*”; Dr. Selim Bezera, “*Bashkëpunimi i dr. Rexhep Bojës me Universitetin e Prishtinës*”; Selatin Novosella, “*Intervista e veçantë e Adem Demaçit me Myftiun dr. Rexhep Boja*”; Blerim Musliu, “*Dr. Rexhep Boja si imam në “Xhaminë e Kuqe” të Pejës*”; Dr. Rexhep Suma, “*Qasja e dr. Rexhep Bojës gjatë ligjërimit në raport me masën*”; Muzaqete Kosumi, “*Dr. Rexhep Boja dhe diskursi i tij fetar*”; Dr. Valmira Batatina, “*Trashëgimia shkrimore e dr. Rexhep Bojës dhe ndikimi i saj në edukimin islam*”; Nexhmedin Ademi, “*Kujdesi i dr. Rexhep Bojës për Luginën e Preshevës*”; Dr. Shkodran Imeraj, “*Dr. Rexhep Boja në shtypin e viteve 90-ta në Kosovë*”; Besim Mehmeti, “*Dr. Boja në mediat në gjuhën arabe dhe kontributi i tij për Kosovën*”; Dr. Besir Neziri, “*Kontributi i dr. Rexhep Bojës në sensibilizimin e opinionit turk për Kosovën gjatë viteve të '90-ta, në shtypin turk*”; Dr. Selim Selimi, “*Publikimet (shkrimet) në gazetatat online (portalet) të Kosovës për dr. Rexhep Bojën*”; Dr. Azmir Jusufi, “*Prania e Myftiut dr. Rexhep Boja në shtypin boshnjak*”; Dr. Hatixhe Ahmed, “*Mediat në gjuhën shqipe për kalimin e dr. Rexhep Bojës në botën tjetër*”.

Në fund, fjalën përmbyllëse e mbajti drejtori për Kulturë dhe Veprimtari Botuese, Ramadan ef. Shkodra, i cili falënderoi Këshillin Organizativ për organizimin e kësaj Konferencë, si dhe të gjithë pjesëmarrësit, të cilët, me kumtesat e tyre shpalosën dhe hodhën në dritë jetën, veprimtarinë dhe kontributin e dr. Rexhep Bojës në fusha të ndryshme. Ai më pas njoftoi të pranishmit se kumtesat do të botohen në një libër të veçantë, të shoqëruara me fotografi, faksimile dokumentare, si dhe me fotografi nga mbajtja e Konferencës.

Përgatiti: **Bajram Zeqiri**

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM MINISTRIN E HAXHIT DHE UMRES TË ARABISË SAUDITE, DR. TAUFIK BIN FAUZAN AL RABIAH



Më 29 tetor 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur sot në takim një delegacion nga Arabia Saudite, i udhëhequr nga ministri i Haxhit dhe Umres, dr. Taufik bin Fauzan al Rabiah, i cili qëndroi për vizitë zyrtare në Kosovë me ftesë të Myftiut Naim ef. Tërnavë.

Gjatë këtij takimi, Myftiu Tërnavë dhe ministri Al Rabiah diskutuan për bashkëpunimin ndërmjet dy institucioneve, si dhe për format dhe mundësitë e thellimit dhe të intensifikimit të këtij bashkëpunimi.

Myftiu Tërnavë shprehu vlerësimet më të larta për bashkëpunimin ndërmjet Bashkësisë Islame dhe shtetit të Arabisë Saudite. Ai më pas gjatë këtij takimi e njohu mysafirin me të kaluarën e Kosovës, si dhe me sfidat me të cilat përballen myslimanët e këtij vendi.

“Jeni sot këtu në vendin e shqiptarëve myslimanë, jeni këtu në vendin ku vëllezërit tuaj luftuan fort për fe dhe atdhe, deri në çlirimin e vendit. Na sulmuan, keqtrajtuan dhe na vranë vetëm për faktin se jemi myslimanë dhe shqiptarë, por falë Zotit sot jemi të lirë. Andaj, unë e kam për obligim të falënderojë Arabinë Saudite për lidhjen e

saj të ngushtë si gjatë kohës së luftës ashtu edhe pas saj” – tha ndër të tjera Myftiu Tërnavë.

Nga ana tjetër, ministri i Haxhit, dr. Al Rabiah, u shpreh tejet i lumtur që për herë të parë po viziton Kosovën, duke potencuar faktin se Bashkësia Islame e Kosovës është e dalluar te Qeveria e Saudisë për përkushtimin e saj ndaj besimtarëve, si gjatë haxhit, njashu edhe gjatë umres.

“Ne si Ministri, së bashku me Bashkësinë Islame të Kosovës kemi një bashkëpunim të shkëlqyer, për çka është si rrjedhojë edhe ky takim i sotëm.

BIK-u është i dalluar edhe gjatë kohës së haxhit dhe umreve të ndryshme me përkushtimin e tij ndaj haxhilerëve, për çka e bënë të dalluar nga të tjerët. Bashkëpunimi ynë me Bashkësinë Islame është i rëndësishëm në shumë sfera, dhe si për t’u dëshmuar është marrëveshja jonë e arritur sot me Qeverinë e Kosovës për Aviacionin Civil me kontribut të BIK-ut” – tha ndër të tjera ministri Al Rabiah.

Bashkësia Islame e Kosovës dhe Ministria e Haxhit dhe Umres e Arabisë Saudite kanë një bashkëpunim të shkëlqyer në të gjitha sferat.



MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM SHEFEN E UNMIK-UT, ZNJ. CAROLINA ZIADEH

Më 9 tetor 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim shefen e UNMIK-ut, znj. Caroline Ziadeh.

Gjatë këtij takimi u diskutua për format dhe mundësitë e intensifikimit të bashkëpunimit ndërmjet Bashkësisë Islame të Kosovës dhe UNMIK-ut në fushën e tolerancës dhe harmonisë ndërfetare në vend. Myftiu Tërnavë me këtë rast tha se ndonëse Kosova është një vend i vogël, për botën mbetet një shembull i harmonisë dhe bashkëjetesës ndërmjet komuniteteve të ndryshme fetare. Ai tha se si institucion mbesim të përkushtuar për zhvillimin dhe kultivimin edhe të mëtutjeshëm të këtyre vlerave, të cilat e karakterizojnë popullin tonë.

Nga ana e saj, znj. Ziadeh, vlerësoi lart rolin dhe kontributin e Bashkësisë



Islame të Kosovës për kultivimin e dialogut ndërfetar e ndëretnik, si dhe për promovimin e vlerave të tolerancës dhe të bashkëjetesës në

Kosovë. Ajo tha se këto vlera duhen ruajtur dhe duhen përcjellë edhe te gjenerata e reja.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM ISH-SEKRETARIN E OBI-SË, Z. EKMELEDIN IHSANOGLU

Më 17 tetor 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim ish-sekretarin e Organizatës për Bashkëpunim Islamik, z. Ekmeledin Ihsanoglu, i cili qëndroi në Kosovë me ftesë të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës për të marrë pjesë në Konferencën shkencore kushtuar ish-myftiut dr. Rexhep Boja.

Myftiu Tërnavë e njohu mysafirin me angazhimet dhe jetën fetare në Kosovë, duke shprehur kështu falënderimet e tij dhe të institucionit që ai drejton për ndihmën dhe përkrahjen e vazhdueshme të z. Ihsanoglu dhënë për shtetin Kosovës sa ka qenë në krye të detyrës si sekretar i Organizatës për Bashkëpunim Islamik.



MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM AMBASADORIN E TURQISË, Z. TUNÇ ANGILI

Më 30 tetor 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim ambasadorin e Turqisë në Kosovë, z. Tunç Angili, i cili shoqërohej edhe nga atasheu për Çështje Fetare, z. Bunjamin Albayrak.

Myftiu Tërnavë shfrytëzoi rastin që të uroi ambasadorin për përvjetorin e Pavarësisë së Turqisë, e njëkohësisht shprehu edhe ngushëllimet e tij dhe të institucionit që ai drejton për sulmin terrorist që ndodhi para disa ditësh në



Ankara, ku mbetën të vdekur disa persona dhe dhjetëra të tjerë të lënduar.

Gjatë këtij takimi u diskutua edhe për format dhe mundësitë e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve në sfera të ndryshme.

FILLOI VITI I RI AKADEMIK NË FAKULTETIN E STUDIMEVE ISLAME NË PRISHTINË



Më 2 tetor 2024, në një ceremoni solemne nisi viti i ri akademik në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë. Dekani dr. Islam Hasani mirëpriti studentët e rinj, duke u uruar suksese dhe mbështetje për arritjen në rrugën e dijes.

I pranishëm ishte edhe kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i cili i përgëzoi studentët dhe i kujtoi përgjegjësinë e tyre për trasimin e rrugës së drejtë dhe kultivimin e Islamit.

“Studentët janë e ardhmja dhe kontribuues kryesorë në kultivimin e Islamit në shoqërinë tonë,” tha Myftiu Tërnavë, duke vlerësuar rëndësinë e mësimit dhe shkollimit në fenë islame për gjeneratat e reja.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM NJË DELEGACION NGAMINISTRIA E ÇËSHTJEVE FETARE TË ARABISË SAUDITE

Më 11 tetor 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim një delegacion nga Ministria e Çështjeve Fetare të Arabisë Saudite, i cili përbëhej nga dr. Muhamed al Shihri, zyrtari Ahmed al Shumeri dhe përfaqësuesi i Ambasadës Saudite në Tiranë, Najef al Humejdi.

Fillimisht Myftiu Tërnavë iu uroi mirëseardhje në institucionin e Bashkësisë Islame të Kosovës, e më pas shprehu mirënjohjen e thellë të tij dhe të institucionit që ai drejton për Ministrinë e Çështjeve Fetare të Arabisë Saudite, si dhe për shtetin e



Arabisë Saudite për përkrahjen e vazhdueshme dhënë për Bashkësinë Islame të Kosovës.

Gjatë këtij takimi u diskutua edhe për vazhdimin e trajnimeve me imamët e

Kosovës, që vije si marrëveshje e përbashkët ndërmjet Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Ministrisë së Çështjeve Fetare të Arabisë Saudite. Si rezultat i kësaj marrëveshje në tetor të vitit 2022 është mbajtur cikli i parë i trajnimeve,

ndërsa më 12 dhe 13 tetor, në Medresenë “Alauddin” në Prishtinë, u mbajt cikli i dytë i këtyre trajnimeve, ku dr. Muhamed al Shihri, ligjëroi nga libri “Perla koncize të virtyteve të fesë islame”.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM NJË DELEGACION NGA ORGANIZATA HUMANITARE “DENIZ FENERI” NGA TURQIA



Më 11 tetor 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka prituri në takim një delegacion nga organizata humanitare “Deniz Feneri” nga Turqia, në krye me z. Ismail Selimin.

Myftiu Tërnavë fillimisht iu uroi mirëseardhje mysafirëve, e më pas i njohu ata me funksionimin e jetës fetare në Kosovë, me theks të veçantë për aktivitetet humanitare që i zhvillon

Bashkësia Islame e Kosovës përmes shoqatës së saj humanitare “Bereqeti”. Ai tha se “Bereqeti” në vazhdimësi, falë edhe ndihmës së bamirësve, po qëndron pranë familjeve nevojtare anekënd Kosovës.

Myftiu Tërnavë me këtë rast falënderoi organizatën “Deniz Feneri” për ndihmat e vazhdueshme dhënë për shoqatën “Bereqeti”, duke shprehur kështu mirënjohjen e tij të thellë për

këtë bashkëpunim të mirë që kanë ndërmjet vete dy shoqatat.

Vlen të përmendet se organizata “Deniz Feneri” është një ndër organizatat më kontributdhënëse dhe ndihmuese të Shoqatës “Bereqeti”. Ata sollën në Kosovë edhe dy kontingjente me ndihma për “Bereqetin”.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM SHEFIN E SEKTORIT EVROPIAN TË SHOQATËS “RAHMA INTERNATIONAL” TË KUVAJTIT

Më 21 tetor 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka prituri në takim shefin e sektorit evropian të shoqatës “Rahma International” të Kuvajtit, z. Valid al Jassini.

Myftiu Tërnavë fillimisht i shprehu mirëseardhje mysafirit, e më pas e uroi atë për marrjen e detyrës së re, duke i dëshiruar punë të mbarë dhe të suksesshme. Ai më pas e njohu atë me punët dhe angazhimet e institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës, me theks të veçantë për angazhimet humanitare që zhvillon ky institucion përmes shoqatës së saj “Bereqeti”. Myftiu më pas shprehu edhe gatishmërinë që të



intensifikohet bashkëpunimi ndërmjet Bashkësisë Islame të Kosovës dhe “Rahma International”.

Nga ana e tij, z. Jassini, falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen dhe për gatishmërinë e tij dhe të Bashkësisë Islame të

Kosovës për një bashkëpunim të mirëfilltë ndërmjet dy institucioneve, gjithnjë për të mirën e qytetarëve dhe të besimtarëve në Kosovë.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM NËNKRYETARIN E TIKA-S, DR. MAHMUT ÇEVİK

Më 23 tetor 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim nënkryetarin e TIKA-s, dr. Mahmut Çevik.

Myftiu Tërnavë fillimisht i uroi mirëseardhje mysafirit, e më pas e falënderoi atë dhe TIKA-n për bashkëpunimin e deritanishëm që kanë pasur me Bashkësinë Islame të Kosovës. Ai tha se TIKA në Kosovë ka restauruar shumë objekte të trashëgimisë kulturore e fetare islame në Kosovë, restaurimi i të cilave ka mundësuar ruajtjen e kësaj trashëgimie të çmuar për Kosovë. Myftiu gjithashtu tha se si institucion mbesim të përkushtuar që të vazhdojmë bashkëpunimin me TIKA-n në projekte të ndryshme.



Nga ana e tij, z. Çevik, falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen dhe për bashkëpunimin e tij me TIKA-n. Ai tha se projektet e përbashkëta ndërmjet

Bashkësisë Islame të Kosovës dhe TIKA-s do të vazhdojnë edhe në të ardhmen.

U PËRURUA XHAMIA E RE NË FSHATIN GAÇKË TË FERIZAJT

Më 23 tetor 2024, me këndim të Kuranit dhe të tekbiereve, në fshatin Gaçkë të Ferizajt, u përurua xhamia e re. Mysafirë dhe besimtarë të shumtë iu bashkuan përurimit të kësaj xhamie.

Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, u shpreh tejet i lumtur për faktin se ndërtimi i kësaj xhamie u bë nga vetë besimtarët: “Është një lutje që buron nga thellësia e shpirti dhe e zemrës që Zoti t’i shpërblejë me të mirat e tij të gjitha ata që kontribuan në ndërtimin e kësaj xhamie. Andaj, sigurisht se edhe Bashkësia Islame e Kosovës ka dhënë kontributin e saj, por më meritoret janë ata që iniciuan dhe punuan për ndërtimin e kësaj xhamie”, tha Myftiu Tërnavë.

Mysafir special në përurimin e kësaj xhamisë ishte edhe zëvendësministri i Haxhit dhe Umres nga Arabia Saudite, Hasan Menakhire, i cili ndër të tjera tha: “Është një prej ngjarjeve që do të jetë e ngulitur thellë në zemrën time gjatë gjithë jetës, sepse është diçka shumë e bukur të shohësh një



organizim të tillë. Ajo çfarë e bënë më domethënëse këtë përurim është ky tubim kaq i mrekullueshëm me kaq shumë njerëz”, tha ai.

“Kjo faltore përfaqëson përpjekjet e sinqerta me shumë përkushtim për të ndërtuar këtë xhami që të adhurojmë Zotin tonë bashkërisht”, tha kryetari i KBI-së në Ferizaj, Nexhmedin ef. Bajrami.

“Sot është një ditë e jashtëzakonshme, që do të mbetet çdoherë në zemrat tona, kjo vepër është nga njerëzit e mirë dhe për njerëzit e mirë, ku edhe po i gëzohen njerëzit e mirë”, tha imami Ardian ef. Sejdiu.

Ndërtimi i kësaj xhamie është shembull i mirë i bashkëpunimit ndërfaqësor, ku disa punë të bukura të xhamisë janë punuar nga pjesëtarë të feve të tjera.

U MBAJT EKSPOZITA ME FOTOGRAFI “BOTA KUJTON SREBRENICËN”

Më 24 tetor 2024, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, në bashkëpunim me Rijasetin e Bashkësisë Islame të Bosnjës dhe Hercegovinës, organizuan ekspozitën fotografike me titullin “Bota kujton Srebrenicën”, kushtuar masakrës dhe gjenocidit që ndodhi në korrik të vitit 1995 në Srebrenicë.

Ekspozita u mbajt në Prishtinë dhe përmes fotografive autentike shpalosi historinë tragjike të kësaj ngjarjeje, duke ilustruar dhimbjet dhe vuajtjet e viktimave dhe të mbijetuarve. Pjesëmarrësit theksuan rëndësinë e ngjarjeve të tilla për të na mësuar mbi paqen dhe respektin ndaj njëri-tjetrit.

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, tha se feja islame na mëson dhe na urdhëron që të jemi paqësorë, të jemi pranë njëri-tjetrit dhe në veçanti të jemi pranë njerëzve që kanë nevojë. Myftiu tha se Islami ka ardhur si shpëtim për njerëzimin në mënyrë që ndalen padrejtësitë, shtypjet dhe mizoritë.

“Islami fe qiellore, nuk e do gjakderdhjen dhe nuk thërret për luftë dhe nuk synon të luftojë e të shkatërrojë bukuritë e krijimit të Zotit në këtë gjithësi dhe as të asgjësojë njerëzimin. Përkundrazi është një mesazh për paqe dhe është një mesazh shpëtimi për njerëzimin.”

Azra Efdic Eminovic, përfaqësuese e Rijasetit të Bosnjës dhe Hercegovinës,



u shpreh se ky organizim është një mënyrë për të mbajtur gjallë kujtimin për Srebrenicën: “Organizimi i sotëm na tregon se kujtimi për Srebrenicën duhet të mbetet i gjallë, jo vetëm për familjet e viktimave, por për të gjithë ne. Këto ngjarje na mësojnë mbi përgjegjësinë dhe respektimin e njëri-tjetrit pa dallim,” tha ajo.

Ndërsa zëvendëskryeministrja e Kosovës, Emilija Rexhepi, theksoi se: “Kur përmendim Srebrenicën, ndjejmë një dhimbje të thellë që na kujton gjenocidin e papërbalueshëm që iu shkaktua atij populli në shtëpinë e tyre.”

Ekspozita përfshinte 11 segmente që përshkruanin fazat e gjenocidit, nga ngjarjet paraprake, tek ekzekutimi i krimeve dhe deri te përpjekjet për

fshehjen e tyre. Kjo ekspozitë synon të rrisë ndërgjegjësimin mbi gjenocidin dhe të nderojë viktimat e tij.

Fatmir Sejdiu, ish-president i Kosovës dhe Enver Hoxhaj, ish-ministër i Jashtëm, ishin gjithashtu ndër të pranishmit që nënvizuan rëndësinë e kësaj ngjarjeje për ndërgjegjen kolektive. Ndërkohë, rrëfimi i dëshmitarit dhe imamit, Mevludin ef. Hrnjiq, si dhe i hulumtueses Ziha Mastaliq Koshuta, përjetuan emocion të veçantë te të pranishmit.

Në korrik të vitit 1995, mbi tetë mijë myslimanë nga Bosnja u masakruan brenda pak ditësh nga forcat serbe, duke shënuar njërin prej kapitujve më të errët të historisë bashkëkohore.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM KRYETARIN E KOMUNËS SË GJILANIT, Z. ALBAN HYSENI

Më 24 tetor 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka prituri në takim kryetarin e Komunës së Gjilanit, z. Alban Hyseni.

Gjatë këtij takimi u diskutua për format dhe mundësitë e intensifikimit të bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve, Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Komunës së Gjilanit. Myftiu Tërnavë me këtë rast shprehu mirënjohjen e tij për gatishmërinë e kryetarit Hyseni për një bashkëpunim të mirëfilltë me Këshillin e Bİ-së së Gjilanit. Ai tha se vetëm duke punuar së



bashku mund t'ia arrijmë t'i realizojmë projektet që janë për të mirën e besimtarëve dhe qytetarëve në përgjithësi.

Nga ana e tij, kryetari Hyseni, falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen, duke vlerësuar kështu angazhimin e tij dhe të

institucionit që ai drejton për të bashkëpunuar dhe bashkëvepruar me Komunën e Gjilanit.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM NJË DELEGACION NGA RIJASET-I I BOSNJE DHE HERCEGOVINËS

Më 24 tetor 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim një delegacion nga RIJASET-i i Bosnje dhe Hercegovinës, i përbërë nga Muhamed Jugo, Azra Efendic-Eminovic, dr. Zilha Mastalic-Koshuta dhe imami Mevludin Hrnjica, të cilët po qëndruan për vizitë në Kosovë, me rastin e organizimit të ekspozitës me fotografi për gjenocidin në Srebrenicë të Bosnje dhe Hercegovinës.

Myftiu Tërnavë fillimisht iu dëshiroi mirëseardhje mysafirëve, e më pas diskutoi për punët dhe angazhimet e Bashkësisë Islame të Kosovës. Ai tha se për ne si Bashkësi Islame ka qenë një emocion i veçantë



që ta organizojmë një ekspozitë të tillë, ngase përjetime të tilla kemi përjetuar edhe ne si popull gjatë luftës së fundit në Kosovë.

Delegacioni boshnjak falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen dhe për organizimin e ekspozitës me fotografi për gjenocidin në Srebrenicë, në vitin 1995.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM NJË DELEGACION TË QENDRËS PËR STUDIME TË LARTA TË ISLAMIT, SHKENCËS DHE QYTETËRIMIT TË MALAJZISË

Më 28 tetor 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim një delegacion të Qendrës për Studime të Larta të Islamit, Shkencës dhe Qytetërimit të Malajzisë, i përbërë nga drejtori i kësaj Qendre, dr. Mohd Hilmi Bin Ramil dhe ish-drejtori, tanimë profesor i kësaj Qendre, dr. Khalif Muammar A. Harris.

Myftiu Tërnavë fillimisht iu uroi mirëseardhje në institucionin e Bashkësisë Islame të Kosovës, e më pas i njohu ata me punët dhe aktivitetet që zhvillon Kryesia e Bashkësisë Islame, sidomos në fushën akademike. Ai nëpërmes tyre falënderoi shtetin e Malajzisë për përkrahjen e vazhdueshme dhënë për Kosovën në fusha të ndryshme.

Myftiu gjithashtu falënderoi mysafirët edhe për angazhimin e tyre për ta thelluar bashkëpunimin në fushën

akademike ndërmjet Qendrës së tyre dhe Fakultetit të Studimeve Islame në Prishtinë.

Myftiu falënderoi gjithashtu mysafirët për përkushtimin e tyre për të thelluar bashkëpunimin akademik midis Qendrës dhe Fakultetit të Stu-

dimeve Islame në Prishtinë, duke propozuar mundësi për programe shkëmbimi, trajnime dhe projekte kërkimore të përbashkëta që do të kontribuojnë në zhvillimin e mëtejshëm të studimeve islame në Kosovë.



U VU GURTHEMELI I XHAMISË SË RE NË GJILAN

Më 31 tetor 2024, me një ceremoni solemne është vënë gurthemeli i xhamisë re në Lagjen e Spitalit në qytetin e Gjilanit. Me ndërtimin e kësaj xhamie, e cila pritet të jetë më e madhja në Gjilan, do të plotësohen kërkesat e shumë banorëve për ndërtimin e një xhamie në këtë pjesë.

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, tha se ndërtimi i kësaj xhamie do të mundësojë adhurimin e Krijuesit dhe në veçanti do të shërbejë në edukimin e brezave të rinj në frymën islame e kombëtare.

Ndërkaq kryetari i Këshillit të BI-së së Gjilanit, Naim ef. Aliu, tha se kjo xhami do të shërbejë për gjithë qytetarët e Gjilanit, dhe si e tillë do të jetë qendër e bashkimit dhe e unitetit.

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, u shpreh i gëzuar me këtë



projekt, duke potencuar se kjo xhami, përveçse që do ta zbkurojë Gjilanin, kjo do të ndikojë në edukimin e brezave të rinj.

Ndërtimi i një xhamie në këtë pjesë ishte kërkesë e kahershme e banorëve të kësaj pjese, por që do të mundësohet falë donatorëve.

U MBAJT TRAJNIMI PROFESIONAL ME IMAMË DHE HATIBË

Më 12 dhe 13 tetor 2024, në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Ministrisë për Çështje Fetare të Arabisë Saudite, u mbajt trajnimi i dytë me radhë për imamë dhe hatibë.

Në hapje të këtij trajnimi, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, falënderoi Ministrinë për Çështje Fetare të Arabisë Saudite për bashkëpunimin në fushën e trajnimeve, duke thënë se ky ka për qëllim ngritjen e kapaciteteve dhe avancimin profesional të imamëve dhe hatibëve.

“Bashkësia Islame e Kosovës krenohet me imamët e saj që historikisht kanë bartur mbi supet e tyre amanetin e Resulullahut a.s. me sinqeritet dhe korrektësi”, tha ndër të tjera kryeimami Sahiti.

Përfaqësuesi i Ministrisë së Çështjeve të Arabisë Saudite, dr. Muhamed bin Hasen al Shihri, fillimisht përshëndeti imamët e pranishëm, e më pas theksoi



interesimin dhe përkushtimin e ministrit të Çështjeve Fetare të Arabisë Saudite, dr. Abdulatif al Sheikh, për thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Çështjeve Fetare të Arabisë Saudite dhe Bashkësisë Islame të Kosovës.

Muhamed al Shihri para imamëve të pranishëm ligjëroi mbi mirësitë e

Islamit, më konkretisht nga libri “Perla koncize të virtyeteve të fesë islame”.

Ai tha se Islami është një fe e mëshirës, tolerancës, bashkëpunimit dhe unitetit. Ai konsiderohet si mëshirë për të gjithë pa dallim. Në fund të trajnimit, pjesëmarrësit u pajisen me certifikata.

KRYEIMAMI SAHITI MORI PJESË NË MANIFESTIMIN E MEVLUDIT NË FERIZAJ

Më 5 tetor 2024, organizuar nga Këshilli i Bashkësisë Islame të Ferizajt, në Xhaminë e Madhe në Ferizaj, u mbajt manifestim për Muajin e Mevludit. Një fjalë përshëndetëse e mbajti kryetari i Këshillit të BI-së së Ferizajt, Nexhmedin ef. Bajrami, duke falënderuar të pranishmit. Ligjëratën kryesore për Pejgamberin a.s. e mbajti kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, duke thënë se Pejgamberi Muhamed a.s. erdhi si dritë shpëtimi që ndriçoi zemrat e besimtarëve me besimin e pastër islam.

Sahiti theksoi se kjo dritë, e përqaftuar nga populli ynë, është kujtuar brez pas brezi përmes



organizimeve të ndryshme. Ai përmendi ajetin kuranor ku Zoti dhe melaqet e Tij bëjnë salavate për Pejgamberin a.s., duke porositur myslimanët të bëjnë të njëjtën gjë.

Manifestimi vazhdoi me lexim Kurani, ilahi dhe pjesë nga Mevludi, të kënduara nga hoxhallarët e Këshillit të BI-së së Ferizajt.

KRYEIMAMI SAHITI MORI PJESË NË KONFERENCËN “MASKUNILITETI TOKSIK, FEMINIZMI DHE FEMICIDI”

Më 4 tetor 2024, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, mori pjesë në Konferencën “Maskuniliteti toksik, Feminizmi dhe Femicidi,” organizuar nga Qendra për Këshillim, Shërbime Sociale dhe Hulumtime për Ditën Ndërkombëtare Kundër Dhunës.

Kryeimami Sahiti prezantoi kumtesën “Qëndrimi islam ndaj dhunës dhe roli i liderëve fetarë në parandalimin e dhunës,” duke theksuar përkushtimin e Bashkësisë Islame të Kosovës për parandalimin e dhunës dhe rolin e imamëve në mbështetjen e viktimave. Ai vuri në



dukje se janë mbajtur hytbe në të gjithë Kosovën me tema kundër dhunës.

Në Konferencë u prezantua gjithashtu raporti i hulumtimit “Dhuna me bazë gjinore përmes këndvështrimit të gjeneratës Z.”

KRYEIMAMI SAHITI MORI PJESË NË PANAIRIN “MIRË SE ERDHE NË JANJEVË”

Më 7 tetor 2024, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, mori pjesë në panairin “Mirë se erdhe në Janjevë”, i cili u mbajt në oborrin e xhamisë “Murat Beu”. Pas ceremonisë së hapjes së panairit, kryeimami Sahiti e shoqëroi krye-

ministrin e Kosovës, z. Albin Kurti dhe ministrin e MKRS-së, z. Hajrulla Çeku në vizitën që i bënë xhamisë historike “Murat Beu” në Janjevë, në të cilën edhe u mirëpritën nga imami i kësaj xhamie, Beqir ef. Krasniqi.

Ky panair mbahet në kuadër të projektit “Trashëgimia Kulturore si Nxitëse e Ringjalljes Ekonomike të Janjevës” dhe financohet nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe nga

Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).

Organizimi i këtij aktiviteti në Janjevë paraqet një mundësi të shkëlqyer për promovimin e trashëgimisë së pasur kulturore të Janjevës, e cila shërben për rritjen e kohezionit ndërmjet komuniteteve dhe nxitjen e një ndjenje të thellë të krenarisë kulturore të banorëve.

Vlen të përmendet se xhamia “Murat Beu” në Janjevë është monument i trashëgimisë kulturore islame i shekullit XVII, e cila është restauruar në vitin 2016 në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet Bashkësisë Islame të Kosovës dhe organizatës qeveritare turke TIKa.



KRYEIMAMI SAHITI PRITI NË TAKIM NJË DELEGACION NGAZRYA E OSBE-SË

Më 30 tetor 2024, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, ka pritur në takim një delegacion nga Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR), në krye me znj. Delia Nita dhe Dagmara Pilaszek Zitko, të shoqëruara nga stafi i misionit të OSBE-së, zyra në Kosovë, në krye me znj. Valbona Dërmaku, këshilltare për të drejtat e njeriut, të cilët planifikojnë të zbatojnë një projekt në Kosovë, të titulluar “E drejta për lirinë dhe besimin fetar për të gjithë, komunikim pa dhunë, ndërmjetësim dhe dialog”.



Gjatë këtij takimi u diskutua për format dhe mundësitë e intensifikimit të bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve, si dhe për kontributin që mund të japë Bashkësia Islame e Kosovës në zhvillimin e materialeve të trajnimit për të rinjtë.

Diskutimet rezultuan me rekomandime konkrete për krijimin e një hapësire të sigurt për dialog dhe komunikim jo të dhunshëm në Kosovë.

Bashkësia Islame e Kosovës falënderoi përfaqësuesit e ODIHR-it, si dhe inkurajoi bashkëpunimin e mëtejshëm në të mirë të vendit.

DREJTORI SIMNICA MORI PJESË NË HAPJEN E XHAMISË “DARUL ERKAM” NË ZVICËR

Më 26 tetor 2024, me këndim të tekbireve dhe salvateve, në qytetin e Herzogenbuchsee të Zvicrës, me pjesëmarrjen e një numri të madh besimtarësh dhe anëtarëve të komunitetit, u përurua me madhështi xhamia e re “Darul Erkam”. Ky përurim i rëndësishëm shënoi një moment të veçantë për të gjithë të pranishmit dhe për komunitetin islam në Zvicër.

Në këtë ceremoni të shenjtë dhe të ngrohtë, prezent ishte edhe drejtori i

Drejtorisë së Diasporës në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica, i cili përmes një fjalimi të përzemërt përcolli përshëndetjet e Myftiut Naim ef. Tërnavë dhe të Kryesisë së BIK-ut. Ai i përgëzoi dhe i uroi të gjithë për hapjen e kësaj xhamie, duke theksuar vlerën e saj për komunitetin.

Më pas drejtori Simnica u ndal në rolin që ka xhamia për forcimin e lidhjeve shpirtërore të besimtarëve me

Zotin, si dhe për zhvillimin e marrëdhënieve të ndërsjella ndërmjet anëtarëve të komunitetit.

“Kjo xhami nuk është thjesht një ndërtesë me mure e kube, por një vend i shenjtë, ku do të bashkohemi për namaz, si dhe për të ndarë mësimet e fesë dhe për të forcuar vlerat e moralit dhe të drejtësisë. Xhamia gjithashtu përfaqëson përkushtimin dhe sakrificën e komunitetit tonë, e cila dëshmon forcën, unitetin dhe për-



kushtimin tonë për të ndërtuar një të ardhme më të mirë për brezat që do të vijnë” - tha ndër të tjera drejtori Simnica.

Në përfundim të ceremonisë, drejtori Simnica, në emër të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, ndau një mirënjohje për xhaminë “Darul Erkam” në shenjë vlerësimi për përkushtimin e komunitetit në ndërtimin e këtij vendi të shenjtë, që do të shërbejë për të gjithë besimtarët e zonës dhe përtej.

U MBAJT TURNIRI HUMANITAR KUSHTUAR MEDRESESË “ALAUDDIN”

Më 27 tetor 2024, në Karlsruhe të Gjermanisë, nën organizimin e Qendrës Islame Shqiptare të Karlsruhes, të udhëhequr nga kryetari z. Muhamet Havolli, u mbajt turniri humanitar në futboll kushtuar medresesë së mesme “Alauddin” të Prishtinës.

Drejtori i Drejtorisë së Diasporës në Kryesinë e BIK-ut, Ekrem ef. Simnica, në fjalën e tij përshëndetëse, falënderoi organizatorët për organizimin e këtij turniri, duke shprehur mirënjohjen e tij për ndihmat e ofruar për Medresenë “Alauddin”. Ai me këtë rast, në emër të Kryesisë ndau edhe një mirënjohje për Qendrën Islame Shqiptare.

Ndërkaq drejtori i Medresesë, Fadil ef. Hasani, pas falënderimeve për organizatorët, në pika të shkurta foli



rreth historikut, aktiviteteve dhe sukseseve të Medresesë “Alauddin”.

Në këtë turnir morën pjesë 16 ekipe nga qendra dhe xhami të ndryshme nga

Gjermania, Zvicra dhe Austria, ndërsa në fund, u zhvillua edhe një ndeshje futbollit ndërmjet ekipit të hoxhallarëve nga vendlindja dhe atyre nga diaspora.

DREJTORI SIMNICA VIZITOI XHAMINË “TRADITA” NË STRASBOURG TË FRANCËS

Më 29 tetor 2024, drejtori i Drejtorisë së Diasporës në Kryesinë e Bashkësisë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica, vizitoi xhaminë shqiptare “Tradita” në Strasbourg të Francës, në të cilën u mirëprit nga imami Gazmend ef. Bajraktari dhe nga anëtarë i Kryesisë së Xhamisë, Arbër Ismajli.

Drejtori Simnica uroi për hapjen e kësaj xhamie, e cila ka një vit që është themeluar, duke lutur Zotin që t'i shpërblejë të gjithë ata që janë bërë shkaktarë dhe që kanë kontribuar që të themelohet kjo xhami. Ai më pas shprehu gatishmërinë e Drejtorisë së Diasporës që të fillojnë bashkëpunimin me këtë xhami, gjithnjë në të mirë të besimtarëve që jetojnë në diasporë.

Nga ana e tij, imami Bajraktari, e njohu drejtorin Simnica me punët dhe aktivitetet e kësaj xhamie, duke potencuar



kështu edhe gatishmërinë e tyre që të fillojnë bashkëpunimin me Drejtorinë e Diasporës së BIK-ut.

**BOTIME
TË REJA**

Dr. Necdet YILMAZ



**ALIMI SHQIPTAR, ALI EFENDI JAKUPI
(1913-1988)**

Dr. Fahrush REXHEPI

**KONTRIBUTI I HOXHOLLARËVE NË
PËRPJEKJE PËR ZGJIDHJEN E ÇËSHTJES
SHQIPTARE GJATË SHEKULLIT XX**

Anwar El-Sadat

**NË KËRKIM TË IDENTITETIT
-RRËFIMI I JETËS SIME-**



DITURIA ISLAME • Nr. 408 NËNTOR 2024